

**RAMIZ
LIKA**

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-31

L 80

TRASEJA

ROMAN

89/1.P85-31

280


RAMIZ LIKA

S

TRASEJA

ROMAN

~~56634~~



8394

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KAPITULLI I PARË

Kur vuri kokën në jastëk, Hana mendoi se do të flinte menjëherë, sepse kishte disa net që nuk kish bërë gjumë të rregullt. Ajo mbylli sytë që ta detyronte veten të flinte. Pas pak erdhi edhe nënë Dila për të fjetur. Ashtu siç e priste Hana, nënë Dila rifilloi t'i numëronte ato gjëra, qa ja kishte thënë me dhjetëra e qindra herë. Ajo i foli vajzës edhe një herë për tmerret e zakonit të egër malor, për vrasjet e shumta që kish parë e dëgjuar në rininë e saj, i foli në mes të tjerash edhe për ndarjen e shoqes së saj, Sanijes, që kishte bërë bujë në fshat.

Kështu ndodhte, kur ishte fjala për «sherr femrash».

Megjithëse këto gjëra Hana i kishte dëgjuar sa e sa herë, tani si asnjëherë tjetër, po rrëqethej. Ndoshta edhe për shkakun e saj do të ndodhnin vrasje të tilla. Ndoshta... Po a do të bëhej vallë tërë ai gjak, ashtu si ishte bërë dikur, siç tregonte nënë Dila? Hana e dinte se nuk do të ndodhte ashtu, siç kish ndodhur atëhere, po, sidoqoftë, Hana mund të vritej dhe kjo do të ishte mjaft. . .

Po a nuk ishte e vrarë edhe ashtu si ishte tani?

— U mundue boll nusja e Myftar Alisë, po ja banë vorrin. Çka i duhet jeta asaj, nanë dy fëmijësh, e ndame prej burrit! Ma mirë vdekun. Asht i qametshëm zakoni ynë, bijo! Edhe ty, në bafsh gja, të pret plumbi. Ose edhe në mos të vrafshin me plumb, të vrasin me thikë a me sëpatë. . .

Nënë Dila fliste e fliste, po Hana tani e kishte vendosur. Le të bëhej ç'të bëhej. Eh, sikur ta dinte Dila se ç'mendime i vlonin në kokë Hanës!

Atë natë ajo do të ngrihej pa gdhirë dhe do të shkonte te shtëpia e Nikë Shkrelit ose do të shkonte fill e në qytet dhe do t'u thoshte atyre të rrethit se ishte në rrezik. Ndoshta ata edhe nuk do ta besonin hëpërhë, por Hana do t'u tregonte se si babai i saj në të kaluarën kishte vrarë me dorën e tij mbi shtatë veta. Njërën e kish vrarë për një kufi are, njërën se e kishte fyer, dy të tjerë për hakmarrje gjaku të vjetër dhe të tjerët i kish vrarë në raste grindjesh.

Megjithëse ishte tepër e shqetësuar atë natë (ashtu si shumë net më parë), nënë Dila papritmas filloi të gërhiste. Kurse Hana largoi ca jorganin dhe u ngrit nga dysheku fare pak, por u ul menjëherë, se ju duk që po e dëgjonte e ëma. Më pastaj u ngrit edhe një herë dhe u vesh ngadalë. Zemra i rrihte aq rrëmbyeshëm, sa nuk e linte as të vepronte me shkathtësinë e zakonshme. Edhe kur i kishte shfaqur dashurinë Sokoli për të parën herë, i kish rrahur zemra shumë, po këto rrahje nuk u përngjanin atyre. Ajo mendoi të ngrihej, të hapte lehtë derën e shtëpisë, pastaj atë të oborrit dhe të vraponte te shtëpia e Nikë Shkrelit. Ata do të ishin në gjumë, po, kur t'u thërriste ajo, me kënaqësi do t'ja hapnin derën. Gruaja e Nikës do të shqetësohej dhe do të qante, se ishte shumë e ndjeshme, po ç't'i bënte Hana? S'kishte rrugë tjetër. Nikë Shkreli do t'i thoshte: «Ta lumsha, Hanë! Kam thanë unë ç'i ti je e bija e trimit! Hajde e mos e çaj kryet hiç!»

Po ndërkaq ajo shtangu në vend. Ju fanitën parasysh të gjitha tmerret e gjaqeve, për të cilat kishte dëgjuar deri atëhere. Ju duk sikur po dëgjonte babain e saj duke treguar ashtu siç u kishte treguar shpesh njerëzve kur i vinin mysafirë në shtëpi. . .

«...Vëllaut tem i kishte sha nanën një i thethjan dhe vëllau i kish vra të thethjanin dekun në tokë. Mirëpo atij na i kishin dalë zot të tjerët e kështu vëllau em kishte metë i dekun prej dorës tyne. Kështu pra mue po më binte në hise me e marrë edhe atë gjak. Ku ka gjak ma të shtretjtë se gjaku i vëllaut, o burra? **Veç** një zot e din sa kam vuejtë me e marrë atë gjak! **Shpia e gjakësve ishte tepër**

e fortë. Kaloi besa një kohë e gjatë ç' unë nuk po mujshe me e marrë gjakun. Njerëzit po më thojshin se isha i koritur dhe arriti puna deri atje, sa në një dasëm nuk më lanë me e varë pushkën në një gozhdë me shokët. Arma eme u var në një faqe muri tjetër. Po nuk e laçë shumë të varun aty. Sa çilë e myllë sytë, jam çue në kambë si i tërbuem dhe kam marrë pushkën e kam dalë jashtë. Çava nëpër terrin e natës dhe, mas tetë sahatësh, shkova në katinin e gjaksit. Ju afrova shtëpisë së tij dhe ndenja në pritje. Ishte një shpi e madhe fort, o burra. Thojshin se kishte tetëmdhetë mashkuj. Unë mujshe me e vra njerin prej tyre, po nuk më bahej qejfi. Dojshe atë ma të madhin, të zotin e shpisë, se kështu pushka eme kishte me pasë nam të madh dhe gjaku kishte me u stërpague. Se hallku atëhere do të thojshin: «He, i lumtë pushka Gjokë Martinit! Ajo asht pushkë e bukur!» Dy ditë u solla rreth e rrotull dhe qe besa nuk e pashë të zotin e shpisë. Mandej mujta me u futë mrenda në shpi. Hyna në një gaviç kollmoqit, ç' ishte i boshatisun dhe fillova përgjimin si hajdut. Por të zotin e shpisë nuk e pashë e nuk e pashë. Tri ditë ndeja në atë drej gaviçit. Mandej hypa mi trenë të shpisë dhe qëndrova mbi nevojtores. Aty nuk vonoi me më ardhë i zoti i shpisë. Unë, sa çilë e mbyllë sytë nieri, ja krisa pushkë ballit kryegjakësit e ai veç asht shtrua në rrasë të nevojtores pllump si kali. Hë, qen! Po ti kujt ja ke vra vëllaun! Askush nuk e kuptoi se kah erdhën plumat e pushkës, se njerëzit rrëmbyen armët e dolën jashtë. Kurse unë isha në shpi, siç po jam njitash tuj kuvenë me ju dhe, më besoni, burra, ma kite tretë zoti frikën krejt. Nuk kishe ma frikë se njitash ç' po jam tue pi një këtë duhan me ju. . .

«Nieri asht ma i fortë se guri. . . Atëhere prapë neja nj'ashtu në trena të shpisë derisa u err. Natën mandej mujta me dalë. . .»

Nanë Dila vazhdonte të gërhiste dhe Hana u ngrit ndenjë. Papritmas Dilës i doli gjumi.

— Ku ishe Hanë? — pyeti ajo me zë të drithëruar.

— Askund — tha Hana.

— Uh, ç'andërr të keqe kam kenë tuj pa, mori Hanë! M'u duk se kishte ardhë Shaban Smajli me një sëpatë në dorë dhe na kishte metë te dera. Hej zot e shenjti shën Koll! Donte me na vra mahlugati. Atëhere pashë edhe një arkivol ç'i na ishte shtri në fund të shkallës. Hej ti, o shenjti shën Koll! Mue më kallëzojnë ëndrrat fort. Diçka ka me na nodhë, po hajr daltë, o zot! A po flen, Hanë-a?

— Ti nuk po na le me fjetë me këto andrra, nanë. Mendon tanë ditën për këso gjanash e natën i sheh në andërr.

— Jo, jo, nuk asht puna se mendoj, po mue më kallëzojnë fort ato.

Hana nuk foli më dhe nënë Dila nuk e ngacmoi.

Vajza e ndjente se nënë Dila nuk po flinte. U pendua që nuk doli më parë. Po prapë ndërroi mendim. Mbase do të ishte më keq. Mbase më vonë do të gjente ndonjë rast më të volitshëm.

Sakaq nëna filloi të gërhiste dhe Hana u ngrit ndejtur. Ç'të bënte pra tani në këtë orë të natës? Të shkante te xha Nika, do t'i dilte keq, sepse Gjoka mund ta kapte. Nikë Shkreli nuk mund t'ja dilte me Gjokë Martinin. Si të bënte pra? Pse nuk po ngrihej ashtu si e kishte bërë planin? Sa e vendosur kishte qenë në fillim!

Hana u bind se nuk ngrihej dot pa e kuptuar nënë Dila. Ajo uli kokën e dëshpëruar dhe filloi të mendonte prapë për ngjarjet e ditës. Kujtoi bisedat në brigadë, fjalët që i kishin thënë për mbledhjen e rinisë (se ajo vetëm nuk kishte qenë) dhe bisedat e zjarrta në atë buzëmbërmje me Sokolin. Sa me besnikëri i riprodhonte ajo bisedat me Sokolin, sado të parëndësishme të kishin qenë. Ata patën diskutuar shumë atë natë, kur Hana po kthehej në shtëpi nga ara. Ajo pat shfaqur drojtje dhe disa herë edhe pat qarë. Zemërohej, se i dukej sikur Sokoli nuk ja kuptonte tërë hallin që kishte, sikur ai nuk e njihte tamam Gjokën.

— Oh, sa më pëlqen kur të shoh kështu të zemërueme! — i kishte thënë Sokoli kur ajo ishte akoma me lot në sy.

— Ti je djalë dhe e ke rahat...

— Edhe ti duhet të bëhesh djalë — i kishte thënë ai dhe e kishte përqaftuar me afsh.

— Ti e di dëshirën teme, Sokol... por të baj ashtu si thue ti... e kam të vështirë...

Sokoli qeshte dhe e përkëdhelte si një fëmijë.

— Tash t'i lamë ato. Nesër vjen maqina dhe ti duhet të jesh gati. Nuk ka kohë për të mendue tash, Hanë. Lumtuninë tonë nuk duhet ta lamë në duert e të tjerëve.

— Ah, more Sokol!.. — Hana shikoi perëndimin e skuqur të diellit.

— Baba em ose do të më vriste mue ose veten. Gjo-kë Martini nuk duron.

— Le të mos durojë, Hanë! Le të na vrasë të dyve! Na nuk do ndahena prej njëni-tjetrit! — këto fjalë Sokoli i tha me një mënyrë të atillë që Hanën e tronditi akoma më shumë.

— Mirë, pra, Sokol... kështu po baj... Të bahet ç'të bahet!..

— Nuk të ka thanë kot Nikë Shkreli «E bija e trimit» — i tha Sokoli entuziazt. Ti duhet ta bash këtë tue ditë që vjen Sanija me ne.

— Mue nuk më besohet, Sokol.

— Posi, moj. Ajo do të vijë patjetër. Myftari nuk di gjaveç kur ta shohë atje.

— Sa e çuditshme asht ajo Sanija! Prapë vazhdon me qëndrue e shkreta!

— Kurse ti, pa i provue ato të këqia, do me u dorëzue!

— Unë kam provue të këqia boll, se jam rrahë nga njimijë herë — tha ajo duke i theksuar këto fjalët e fundit. — Po sidoqoftë unë do të vij... Tash më duhet me shkue. Sokol, se u ba vonë.

Ajo u nis drejt shtëpisë, duke kaluar ndanë arës së madhe me grurë, kurse ai qëndroi dhe shikonte si lëviznin këmbët e saj me çorapet e bardha. Çorapet dhe shamia vegonin në mugëtirë. Ajo kthente kokën herë pas here dhe përshëndeste Sokolin me dorë. Edhe ai ja kthente përshëndetjet.

Kur arriti te shtëpia, Hana takoi nënën, që kishte dalë ta priste te dera e oborrit.

— Njitash u liruem prej punës — tha Hana. — Nuk pata çka me ba.

— Mos m'i kallëzo mue ato, se e di kur jeni lëshue...

— S'kam çka me ba, pra, nanë!

— Futu mrenë e mos ta marrë vesh ai se ke ardhë vonë! Hala nuk ja mësove huqet ti, mori qyqe!

— Jam në punë, nanë, dhe nuk mundem me u ardhë huqeve të tij.

— Ke me i ardhë dajakut pra, ashtu siç i kam ardhë unë gjithmonë. Nuk pyet ai për kuvende popullit as për kurrëgjja. A nuk na ka rrahë prapë mbasi asht kritikue prej popullit?

— Ti e ke fajin, nanë! — tha Hana.

Nënë Dila ju afrua më afër vajzës. Asaj po i dukej se s'ishte e bija që fliste aq me guxim.

— Ti e ke fajin, — përsëriti Hana — se e ke mësue kështu tue i thanë gjithnji «peqe» e «lepe». Nuk ja ke ba fjalën mëdysh kurrë.

Rrudhat në fytyrën e nënës u thelluan akoma më shumë.

— Ti paske luejtë mendsh sonte, bijo! Pa ja ba fjalën mëdysh kurrë dhe më ka rrahë e jo ma me i pasë kundërshtue ndonjiherë!

— Atëhere do të të kishte rrahë ma pak.

— Mos, bijë, mos folë kështu, se po na e ban vorrin të dyjave! Po me kenë ai mas deret tash! A di çka bahet!

— Nuk mundem me durue ma, nanë!

— Ule zanin po të thom, se e more veten më qafë! Kështu e ka shkruë zoti për ne, moj bijë. U bana pesëdhete e sa vjeç kështu...

— Zoti nuk ka shkruë asgja për ne, nanë!

— Mos folë kështu për të lumin! Çohu e shko te lopa e leni muhabetet!

Hana nuk bëri zë, po mori kusinë, kaptoi oborrin dhe

hyri në kasolle, ku ishte lidhur lopa. Zgjidihi shpejt vëcin dhe ja lëshoi asaj. Lopa ngriti këmbën lart për të qëlluar, se ju lënduan gjithë e prerë nga dhëmbët e vëcit që më parë. Hana e kuptoi shpejt dhe e largoi me vështirësi. Pastaj ajo nisi të milte lopën dhe qumështi zhurmoi këndshëm në kusinë prej teneqeje. Ajo e moli lopën si pakup-tuar dhe u nis me vrap drejt shtëpisë me bishtukun dhe kusinë në dorë. Nënë e gjeti te dera dhe ajo e pyeti në e kishte ndarë vëcin.

— Uuu, harrova krejt!

— Je habitë sonte, e shoh mirë — i tha Dila.

Edhe kur u kthye herën e dytë, prapë e gjeti nënën në prak të shtëpisë. Ajo ishte e shqetësuar, se Gjoka po vonohej.

— Pse nuk vjen ky tash? — pyeti Dila me zërin e saj të ngjirur dhe të pasigurtë.

Hana një herë deshte të pyeste se kush ishte ai që nuk po vinte, po u kujtue shpejt, se nëna «ky» i thoshte Gjokës. Ajo tërë jetën e kishte thirrur Gjokën kështu.

— Ka mbledhje — tha pastaj si me mospërfillje.

— Ç'mbledhje tash kaq vonë, moj Hanë?

— I kanë mbledhë të gjithë ata që pengojnë vajzat ... Hana nuk e vazhdoi bisedën dhe Dila ndjeu stuhinë e re që i kërcënohej shtëpisë së saj. Ajo u mblodh krus-pull dhe brazdat në fytyrë ju bënë të thella dhe të errë-ta.

— A thue ke dhanë noj fjalë kund, mori bijë! — Ajo shikoi nga qielli dhe bëri tri herë kryq me dorë. — O shenjti shën Koll! Kam pa një andërr tash nja dy net ç'i aman, o zot! Mue më kallëzojnë andrrat.

— Ti, nanë, gjithmonë me andrra e me kryqe! — tha Hana dhe, papritur përgjigjen e Dilës, u fut në kuzhinën e madhe me blozë. Ndezi zjarrin, kulloi qumështin dhe e vuri për ta valuar, ndërsa nëna vazhdonte të lutej e të bënte kryqe. Nënë Dila e ndjente veten ngushtë. Në shtë-pinë e tyre në të vërtetë nuk kishte patur kurrë qetësi, po ama tani ishte prishur krejt, se të gjitha vajzat e fsha-tit po shkonin në aksion. I shoqi, Gjoka, e kishte ndjerë

rrezikun, prandaj ishte bërë helm e vrer dhe rrinte në shtëpi i ngrysur. Shpesh i kishin thënë atij ta dërgonte vajzën në aksion, po nuk pranonte Gjokë Martini, se e kishte vajzën të fejuar me një djalë, që akoma nuk i kish mbushur të gjashtëmbëdhjetë vjetët, megjithëse ajo po i kalonte të nëntëmbëdhjetat.

— Ti, nanë, a do të kishe me më lejue, po ta kishe në dorë? A kishe me më lanë me shkue në aksion?

— Nuk di — tha ajo, që ishte e papregatitur për këtë pyetje. — Mue nuk më ka pyetë kush kurrë për këso punësh.

— Më kallëzo ç'ke në shpirtin tand.

— Unë due që ti me kenë si asht ma mirë, moj bijë. Due me të thanë hallku vajzë e ndershme. Se ndryshe nuk të merr kush. Na jena malësorë. Në hekurudhë të del boja.

— Ç'i gjeti ato që shkuen në hekurudhë?

— Turpi nuk të ven njollë në ballë. Kush i fejon ma ato?

— Ato nuk i fejon kush, se fejohen vetë.

Dila bëri kryq tri herë për të treguar shqetësimin dhe habinë e madhe për fjalët që po dëgjonte nga goja e vajzës. Asaj nuk i kishte ndodhur asnjëherë kështu me të bijën. Vërtet kohët e fundit Hana kishte nisë ta lëshonte llapën para saj, po sonte po i kalonte të tërë kufitë. Dila kishte frikë se mos i mësohej goja, dhe pastaj fliste kështu edhe para Gjokës. Ajo i tha Hanës që ta rrudhte gojën, se Gjoka do t'i vriste të dyja.

— Deri kur me e rrudhë gojën, nanë? — pyeti Hana me zërin që po i dridhej.

— Ne na ka falë zoti femna dhe femnës nuk i ka dhanë të drejtë me folë kurrë. Ky asht fati ynë.

Ndërkohë u dëgjua një e kollitur kërcënuese në oborr.

— Po vjen ky! — tha Dila e alarmuar.

U hap dera dhe hyri Gjoka duke lëshuar një pshe-rëtimë të thellë lodhjeje dhe, siç e kishte zakon, nuk dha asnjë përhëndetje. Po të mos gjente mysafirë në shtëpi,

ai nuk përshëndeste kurrë. Me vajzën e me gruan nuk donte të tregonte afrim. Po të sillej me përzemërsi me to, kishte frikë se mos i hipnin në qafë dhe nuk i sundonte dot më.

Ai u ul rëndë në postiqen e dhisë, që i kishte shtruar Hana më parë dhe shfryu si tub kaldaje. Ishte tepër i ngrysur, prandaj Dila nuk pati guxim ta pyeste për asgjë. Gjoka e merrte fjalën ters, dhe hajde të rregulloheshe më me të pastaj. Dilës i qe dashur gjithmonë të përdorte takt me burrin dhe prapëseprapë nuk ja kishte dalë dot.

— A janë mbledhë ato bagëti? — pyeti ai si çdo natë, kur hynte në shtëpi.

— Po, more, bagëtia janë mbledhë — tha Dila dhe mori zemër të vazhdonte më tej. — Kujtueme se je në mbledhje.

Gjoka, që sapo kishte përfunduar së mbështjelluri një cigare, shikoi radhazi gruan e vajzën, ndezi cigaren dhe foli:

— Pse, a nuk e kini ditë se jam në mbledhje-a?

— Ti nuk më ke thanë gja... — tha Dila.

— E ka ditë mirë kjo — tha ai duke bërë me dorë nga Hana. — Nuk besoj se nuk e ka marrë vesh — dhe, si heshti pak, vijoi me një ton më të ashpër: — Bile kjo ka pritë si do të përfundonte mbledhja. Ka pritë me ardhë unë e me i thanë: «Nisu nesër me shokët! Hargalisu nesër sa të dësh me djemtë e katunit e të qytetit».

— Për Krisht, more ti, nuk i thotë kush vajzës sonë për aso punësh. Unë nuk i kam pa as nigjue gja kurrë...

— Ti je budallicë dhe nuk munesh me pa gja.

— Belda edhe nuk i kuptoj këto punët e rinisë.

— Sa për ty, vinë e ta marrin vajzën mrena e ti nuk kupton asgja, po të mos jem unë. Ti ke kenë gjithmonë hajvane. Na sill bukën tash!

Hana shtroi sofrën shpejt e shpejt. Ato të dyja u ulën të heshtura e nisën të hanë. Gjoka harroi të bënte edhe kryqin e zakonshëm, që nuk e harronte kurrë para buke e pas buke. Vetëm kur filluan të gjerbnin hirrën, u prish qetësia nga tringëllima e lugëve. Befas u dëgjua një e trokitur në derë dhe pastaj një thirrje:

— O Gjokë Martini!

— Hajde byjrym! — ja pritë Gjoka duke brofur në këmbë.

Dera u hap dhe në shtëpi hynë sekretari i partisë, plaku me flokët e bardhë, Nikë Shkreli dhe mësuese Teuta me dy vajza të fshatit. Gjoka ju lut të rrinin në sofër, po ata nuk pranuan duke thënë se kishin ngrënë. Hana u poqi mysafirëve nga një kafe. Mysafirët biseduan për motin e për punët dhe Gjoka e mbante bisedën të gjallë me zor. Ai nuk kishte dëshirë të bisedonte. Sikur të mos ishte turp, ai mund edhe t'i nxirrte jashtë, sepse e dinte mirë pse kishin ardhur ata. Bile kishin ardhur edhe tri femra t'i jepnin mend Gjokë Martinit. Biseda u vërtit herë me zvarritje, herë me energji andej-këtej dhe më në fund Nikë Shkreli çeku atje ku deshte.

— Edhe pse jena plak e jena frymë e vjetër, duhet me ecë me kohën, Gjokë Martini — tha Nika. — A e di ti se kanunin ç'i na i dalim zot kështu, nuk e ka ba aspak Lekë Dukagjini?

— Ju ç'i jeni vendali dhe m'i dini hallet, nuk ka hije me më ba rixha kështu. Unë vajzën due me e martue. Ti, Nikë, e ke rahat, se nuk ke vajzë për aksion.

— Lene Nikë Shkrelin, se ky e ka tregue me kohë — tha Zefi, sekretari i partisë. — Ky i çoi në shkollë vajzat i pari në fshat dhe sot i ka njenën mësuese e tjetrën mami.

— Pse s'kam vajzë me çue në aksion, kam me shkue vetë vullnetar — tha Nika. — S'ka hall pa marrë pjesë në aksion edhe një prej shpisë seme.

— Pash zotin, përnjimen-a! Si more don me shkue në aksion! — tha Dila e habitur.

— Pasha nerin po!

— Ti je ba gati shtatëdhjetë vjeç, more!

«Kur bahet nieri matuf», mendoi Gjoka.

— Nj'ashtu due me shkue e me punue me rininë, Dilë — tha Nika.

— Gjithkush ka hesapin e vet — tha Gjoka.

Sekretari i partisë, Teuta dhe xha Nika (ashtu si

dinte ai), i folën për vendimet e partisë, për fjalimet e shokut Enver, i folën e i folën vazhdimisht disa orë me radhë, por ai nuk po tundej.

— Vijën e partisë e njoh edhe unë — thoshte ai. — Nuk jam aq budallë në punë pulatike sa kujtoni ju, po nuk kam çka me ba. Kam halle... Për partinë jap jetën e jo ma me kursye nji vajzë...

Kështu deklaronte shpesh Gjokë Martini. Ai e donte partinë. E donte, se ajo e kishte shpëtuar atë jo vetëm nga gjaqet e nga vrasjet e panumërta, po edhe nga varfëria. Ai kishte treguar mjaft burrëri e trimëri në jetën e tij, ishte vrarë e ishte dërmuar, por kurrë nuk kishte shpëtuar nga varfëria. Në vitin më prodhimtar bujqësor ai kishte siguruar vetëm gjysmën e bukës për familjen dhe pjesën tjetër e kishte marrë borxh. Kështu kishte vuajtur ai vite të tëra, sidomos qysh se ishte ndarë nga vëllezërit. Ai kishte pasur tokë pak, dhe atë pak tokë nuk kishte pasur mundësi ta punonte. E ku mund të punonte ai në arë, kur e ruanin sa e sa gjakës për të marrë hak mbi të! Dhe tokën e kishte punuar e gjora Dilë. Kur mendonte për këto gjëra, Gjoka thoshte se njeriu është më i fortë se guri, se, po të ishte guri në vendin e tij, nuk do të mund të duronte aq sa kishte duruar Gjoka. E kush mund ta kishte çliruar Gjokë Martinin nga ajo mynxyrë përveç partisë? Gjoka i dinte këto gjëra dhe e falënderonte partinë herë pas here, por dy gjëra nuk i pëlqenin. Ai nuk ishte kurrë dakord t'u jepej liri femrave dhe të prisheshin kishat. Në këto pika Gjoka nuk mund të bënte lëshime.

— Po ti, Dilë, a po flet ndonjiherë? — e pyeti Nikë Shkreli nënë Dilën, që rrinte e heshtur në qoshen e saj. Ajo shikoi Nikën në sy dhe rrasi shaminë në kokë. Si të fliste ajo, që nuk i qe marrë mendimi kurrë për ndonjë punë nga burrat? Si ja bënte Nika atë pyetje para Gjokës, kur ja njihte kokën atij?

— Gratë nuk janë pvetë kurrë për këto gjana — tha nënë Dila me zë të ulët dhe lëvizti urët në zjarr.

Teuta bëri një lëvizje nervoze, po nuk foli. E pa më të arësyeshme të mos fliste në një situatë të atillë kur

Gjoka ishte aq i acaruar. Po heshtja zgjati pas fjalës së Dilës dhe Teuta nuk duroi më. Të bëhej ç'të bëhej. Ajo s'kishte si të heshtte para një skene të tillë. Një grua mohlonte të drejtën e vet!

— Ne femrave na ke rënduar pak sonte, Gjokë Martini — tha ajo më në fund. — Edhe Dilën e ke bindur se gratë nuk duhen pyetur. Ky është poshtërim i madh ndaj femrës.

— Më fal, shoqja mësuese.. Unë nuk thom për ju të shkollës, por këto gratë tona janë budallica e nuk dinë haje drej asnjë send. Unë po i shoh për ditë, o shoqja Teutë!

Atëhere ndërhyri Nikë Shkreli:

— Duhet pyetë edhe këto, Gjokë. Unë nuk baj asgja pa pyetë n'atë plakën teme dhe nuk më ka dalë keq kurrë që besa. Boll me ato marrinat e moçme, Gjokë, ej! Folë, Dilë!

— Çka kam me thanë unë, o Nikë... Na duem me e martue vajzën..

— S'ke faj ti jo. Kot që të pvesim. Ti nuk guxon me thanë gja.

— Ti, Nikë, gjithmonë me bomba — tha sekretari i partisë.

Gjoka rrinte kokulur dhe thithte cigaren me nxitim. Flaka e zbetë e zjarrit lëpinte me përtesë fundin e kuisë së qumështit të varur në zinxhirë. Jashtë dëgjohej një këngë lahute.

— E di pse i përdor bombat unë? Se fjalët e Gjokës janë tamam si ato të dom Lazrit. Edhe pse asht zhveshë prej detyrës së priftit, dom Lazri e ban punën e vet. Le mandej Mehmet Rama. Ai i ka thanë se hekurudha asht vend kurvënimit, i ka thanë se dalin djem e vajza mramjeve nëpër pyje e çka nuk bajnë, i ka thanë se flejnë edhe bashkë në kazerma.

Gjoka nuk fliste dhe thithte duhanin me rrëmbim. Hana dëgjonte kokulur. Tani që Gjoka heshtte, ajo mendonte se kushedi mbase i rrëshqiste goja dhe lëshonte ndonjë premtim që pastaj nuk mund ta hante më, se ai

fjalën nuk e bënte mëdysh deri në vdekje si për mirë si për keq. Po si do ti shkulej ajo fjalë pa! Forca, Nikë Shkreli, jepi muhabetit! Hajt, shoku Zef, mos ja lerë barrën Nikës! Po ti, Teuta? Jepini e mos pushoni, se ndoshta do t'ja shkulni ndonjë premtim! Flisni e mos pushoni, shokë e shoqe! Një herë po premtoi ky dhe...

— Unë mendoj që «të koritesh» edhe ti si «u koritëm» na të tjerët — foli sekretari i partisë. — Ti i pe shokët e tu sot, Gjokë Martini. Nuk janë të gjithë të pandershëm.

— Për zotin, more burra, po më turpënoni mjaft me këto fjalë, por e kam të vështirë. Vajza për martesë...

Nika u nxeh. U ngrit në gjunj.

— Nj'ate mos e thuej ma! Don me ba pajë? A e na lueme vetë pajën? Ë? A nuk qe edhe ti që e ngrite dorën kundër kësaj pune në kuvenin tonë ç'i patëm ba atëhere? Thuej ma mirë troç se nuk e don aksionin e pikë! Na e dimë.

— Mos më llomit me fjalë, Nikë Shkreli!..

— Edhe puna e martesës nuk asht pra — tha Nika. — Po të japim fjalën që plaka eme dhe nusja e djalit të Zefit do ta ndihmojnë Dilën për punët ç'i ka. Si thue, shoku Zef?

— Dakord. Bile, po të ishte paja ndonjë gja pozitive. do t'ja vejshe nusen në dispozicion për ta përgatitë.

— Për punë e halle të tjera e ndihmojmë ne Dilën e Gjokën — thanë vajzat njëzëri.

— Faleminerës prej jush! — tha Dila me zë të ulët.

Gjoka e shikoi me vërejtje, thithi fort cigaren dhe nuk foli. Për një çast heshtën të gjithë.

Kënga e lahutës, që në fillim vinte si më e zbetë, tani po oshëtinte me vrull sikur të këndohej mu aty pas dere. Ato dy bishta kali të lahutës, dy bishta që fërkohehin me njëri-tjetrin e nxirrnin tingujt, sikur po i fërkohehin brenda në tru Gjokë Martinin. Zëri i këngëtarit i përplasej si çekan në tëmtha dhe Gjoka sikur po mudohej ta zbonte. Eh, sa në hall ishte Gjokë Martini! Po t'i kishin ardhur dikur kaq njerëz dhe t'i luteshin për t'ju falur gjakun, ai do t'ua falte me siguri. Sa herë i kishte

thënë ai Nikë Shkrelit: «Me më thanë ti, ja pres kryet
nji vajze». Kurse tani nuk pranonte një gjë kaq të vogël.
Ata nuk kërkonin t'i priste kokën vajzës. Vetëm t'i jepte
lejen për të shkuar dy muaj në aksion. Ja sa pak kërkonin
nga ai! Kështu thoshin ata, por Gjokë Martini më lehtë do
t'i priste kokën se sa do të bënte atë punë.

Ndërkohë shkuma e qumështit në kusinë që ishte
në zjarr gufoi dhe për pak u derdh, po Hana e kapi kusinë
me shpejtësi dhe e largoi nga zjarri, duke i fryrë me bul-
shinj. Pastaj, me kusinë në dorë, kaloi në dhomën tjetër.
Nika e ndoqi me sy derisa u zhduk...

— Vajzë e rreptë — tha ai. — Pah, ç'vajzë!

— Gjynah ta ndash nga shoqet — tha Teuta, duke
tundur gishtin përpara. — Ç'kusur ka kjo? Kjo do të na
nderonte të gjithëve dhe jo të na turpëronte, siç thonë
prapanikët.

Ata prapë heshtën. Pastaj e mori fjalën Zefi, i cili
i kujtoi atij se sa duhej të bënte ai për miqtë në shtëpi,
qoftë edhe sipas zakonit, i kujtoi të gjithë të kaluarën, vu-
ajtjet, gjaqet, tmerret, varfërinë, i kujtoi se nga të gjitha
ato e kishte çliruar partia, kurse ai s'po i përgjigjej thirrjes
së saj.

— Ti duket sikur nuk ke besim — tha Zefi më së
fundi.

— Mos ma thuej nj'atë fjalë, shoku Zef! Unë nuk kam
besim te partia? Kjoftë larg e liga!

— Vetëm për këtë punë e le pa e çue vajzën në ak-
sion.

— Unë i pres kryet, për partinë, more, për Shën Koll!

— Ti nuk po ban asgja për partinë.

Tani Gjoka zuri të rrëmihte në hi me një një krande
të gjatë. Rrëmihte dhe thithte me ngut cigaren. Si t'u
thoshte atyre njerëzve, që kishin ardhur dhe ja kërkonin
vajzën me aq këmbëngulje? Zefi i fliste, Nika fliste, Teu-
ta fliste... Flisnin e flisnin pa pushim dhe ai ngulte këmbë
në të tijën, ai nuk ua plotësonte dot dëshirën atyre.

Aty nga mesnata ata nuk mundën të duronin më dhe
kërkuan të ngriheshin.

— Ti, shoku Zef, dhe vajzat shkoni, po unë nuk po luej vendit — tha Nika. — Unë nuk kam me fjetë pa më dhanë fjalën Gjokë Martini.

— Le të bajë mendim një herë — tha Zefi.

— Mendimi asht i bamë. Asht e pamundun ç'i Gjoka mos me e lanë vajzën me shkue në aksion. Si, more, nuk ke besim tek unë ti? Na kena shkue si vëllazën gjithmonë.

Gjoka thithte cigaren pandërprerje. Shuante e ndizte papushuar. Kaq shumë duhan në një kohë të shkurtër nuk kishte pirë ndonjëherë.

— Tepër po më ranon, Nikë Shkreli — tha ai pa ngritur kokën të shikonte bashkëfolësin.

— Nuk po të ranoj. Unë kam menue se ti i pret kryet për mue, ashtu si ke pasë thanë gjithmonë. A të kujtohet si më thoshe?

Gjoka piu deri në fund edhe një cigare, hodhi bish-tin e saj dhe tha me zë të hidhur:

— Nuk munem me e lëshue vajzën ashtu jo. Due me e martue e pikë. Ju paçi faqen e bardhë që kini ardhë në shpinë teme dhe rrimë sa të doni e qejfi po më ka boll, por për një kyt punë nuk kini pse me humë kohë. . .

Nikë Shkreli rrotulloi kokën me nervozizëm dhe bërtiti:

- Mos, Gjokë, he burrë!
- Mos m'u veni ma. . . Nuk munem. . .
- Mos e ndaj prej nesh Hanën, Gjokë!
- Nuk shkojmë pa të, jo!
- Bane zemrën gur, Gjokë Martini!

Plaku Nikë u fye nga qëndrimi i Gjokës dhe u ngrit. Mblodhi me nervozizëm gishtat e dorës së djathtë dhe bani një gjest kërcënues në drejtim të Gjokës si të donte ta qëllonte.

— Paç faqen e zezë, Gjokë Martini! Gjithmonë kena kenë shokë të ngushtë e tash në pleqëni po më len në bal-të! Bukur besa! Na ka hije mashalla! Jena një kamë në dhe e një kamë mi dhe e duem me pengue të rijtë mos me ecë në rrugën e tyne! Po kur të desim na, kush i pengon?

— A të pranojnë ty në aksion? — pyeti Dila Nikën ashtu kot pa qenë e interesuar për atë punë.

— Kë, mori, nuk pranojnë? Kam bisedue me shokët e rrethit. Pyet shokun Zef a më pranojnë — tha dhe vazhdoi të qortonte Gjokën.

Të ardhurit u ngritën më në fund. Gjoka, ashtu i hesh-tur, i përcolli deri te porta e oborrit. Pastaj u kthye e hyri brenda pa bërë zë. U ul sërishmi në postiqen pranë va-trës dhe ndezi një cigare. Tani nuk fliste fare. Vetëm thithte cigaren me nervozizëm. Diku larg u dëgjua edhe një këngë. «Ç'dreqin asht e gjithë kjo kangë tash natën!» tha me vete Gjoka.

— Na e mbyllni nj'atë drej pixherjet, se na çanë kryet ato kangë!

Dila mbylli dritaren. Gjoka ngriti sytë dhe vështrimi i tij i ngrysur u mbërthye te Hana. E thirri pranë vetes dhe ajo priti ndonjë të qëlluar si zakonisht.

— Më këqyr mue këtu! — i tha ai me atë çehren e ngrysur. Hana ngriti kokën dhe pa se sytë e të atit e kishin humbur ngjyrën e zakonshme. Në ata sy ajo pa vetëm kërcënim.

— Po nuk qëndrove ashtu si të kam porositë gjith-monë, mue nuk më dhimbet shpirti as sa një cigare duhan! Për punë neret unë nuk kursej asgja!

Hana uli kokën dhe zemra i rekëtiu nga dhembja.

— Çoje kryet e më këqyr mirë, se për shenjtin shën Koll çameti bahet për ty, ta dish! Mue nuk më dhimbet jeta! Punë e madhe se po u dënuetakam me vdekje! E kam hangër livadhin tash e nuk më prishet gja, po të des. Me dekë me nder asht puna për mue.

— Nuk di pse po më thue kështu, babë... Unë nuk kam ba gja...

— Mbylle gojën! — bërtiti ai duke u dridhur dhe ga-ti për ta qëlluar. — Ban si të porosis! Nigjo, se kam me të kërkue hesap për këto gjana! Ti je e fejueme! Aksion për ty s'ka! Kështu? Në qoftë se nuk u binesh këtyne po-rosive, e mjera ti për vete! Kam me ta përdredhë kryet si buçit. Unë turpin nuk e duroj! Më vjen ranë me kundër-

shtue fjalën e partisë, po nuk kam çka me ba. Me u kori-të nuk nigjoj. A more vesh çka të thashë?

— Po, babë...

— Po, more, kjo i ka aq mend në krye. Nuk asht e vogël mos me ditë si kujdesesh ti për të — tha nënë Di-la.

— Ti mbylle gojën e mos lej! S'ke ditë kurrë ti e jo me ditë tash mas vaktit — tha Gjoka dhe shkoi të flinte si zakonisht pa thënë: «Natën e mirë».

...Hana, duke rijetuar ato skena, sillej herë në një krah, herë në një tjetër. Jo, jo, ajo nuk mund të pranonte fatin e nënës së saj! Deri tani ajo kishte duruar, po tani durimit i kishte ardhur fundi. Po të rrinte e të nënshtrohej, atëhere do t'i nënshtrohej edhe martesës së padëshiruar, që po i trokiste pas dere. Pra duhej vepruar, se koha nuk priste më. Ajo ishte vajzë e një kohe tjetër dhe jo e kohës së nënë Dilës, që e kishin grabitur si një kafshë. «Ma mirë vdekun se një dasmë si jotja, nanë!» tha ajo me vete dhe kujtoi dasmën e nënës së saj, ashtu siç ja kishte treguar nëna disa herë.

Ajo kishte qenë ndër dasmat më të çuditshme. «Një-herë xhaxhai i Gjokës kishte shkuar me disa shokë për t'i shpënë shenjën e fejesës një vajze, të cilën e kishin fejuar me një kushëri të tyren. Atyre u qe bërë një pritje madhështore, ashtu siç u bëhej shpeshherë shkuesve. Në atë shtëpi shkesi kishte parë edhe një vajzë, që i kishte pëlqyer së tepërmi. Vajza në të vërtetë i kishte pikuar në zemër të gjithë dhe, pa ja bërë të gjatë, shkesi kishte pyetur në ishte fejuar apo jo. Ata i kishin thënë se ajo nuk ishte e fejuar dhe se ishte jetime. Jetimet sipas zakonisht duheshin pyetur për fejesë. Vetëm për ato bëhej përjash-tim. Shkesi megjithatë kishte shfaqur mendimin për të fejuar atë vajzë të bukur me emrin Dilë me Gjokën. Të bënë një rrugë e dy punë. Shtëpiakët e kishin mirëpritur propozimin dhe e kishin pyetur vajzën, e cila kishte kundërshtuar në çast. Shkesi kishte thënë ta grabisnin. Familja ishte lëkundur ca, po, më së fundi kishte pranuar. Atëhere burrat ishin çuar natën, e kishin kapur vajzën

lidhur dhe e kishin vënë në kalë. Në gojë i kishin futur leckat dhe më kot ishte orvatur ajo të bërtiste dhe të mallëkonte ato bisha, që e kishin grabitur.

Dha e mori dhe dikur ja kishte arritur t'i hiqte lecat nga goja. Kishte bërtitur me gjithë zërin: «O kushtrim kush të jetë, se më grabitën! Në dorën tuej kush të jetë kënde! O kuku për mue!» Papritmas nga errësira kishte dalë një burrë me një pushkë të gjatë në krah, një udhëtar jo i atij fshati. Por britma e vajzës, sipas zakonisht, e kishte shtënë në borxh kundrejt saj. Dikush kishte kërkuar ndihmën e tij dhe ai duhej medomos t'ja jepte. Dhe kishte ndërhyrë pa humbur kohë:»

— Ç'asht ashtu, more burra?

— Shko rrugës dai, se nuk kena punë me ty!

— Lëshoni vajzën që keni grabitë, se, përndryshe shkoi gjaku deri në gju! Lëshojeni shpejt!

Ata nuk e përfillën burrin se ishin shumë e ai ishte i vetëm. Megjithatë burri hoqi pushkën dhe i ra në krahebor njerit prej grabitësve që quhej Llesh. Lleshi u rrokullis përdhe. Udhëtari shtiu dhe një herë e plagosi dhe një tjetër, po pastaj s'që i zoti më, se një plumb e kapi mu në krye. Ai ra mbi një shkurre pa ditë ç'po ndodhte. Në fillim Dila mendoi se do të shpëtonte nga ato bisha, por jo; ata e morën atë në krah, morën të vdekurin e të plagosurin dhe vazhduan udhën. . . Kështu ajo erdhi nuse në shtëpinë e Martin Shytanit, pra u martue me të birin, Gjokën. Atëhere Dila ishte pesëmbëdhjetë vjeç. Mirë që Gjoka nuk ishte plak. Aso kohe ai nuk i kishte mbushur të tridhjetat, por ama gjarpër ishte. Këtë nuk e kish në natyrën e tij, po ashtu e donte zakoni. Pas një jave Gjoka kishte nisur ta rrihte. Martin Shytani kishte dashur të bënte dasmë të madhe për grabitjen e saj, po vrasja e Lleshit e prishi punën. Kjo vrasje ja shtoi fatkeqësitë Dilës. Njerëzit filluan ta quanin «mollë shërri», filluan ta ofendonin si grua të keqe. Kështu që edhe shoqet, sado që e donin në shpirt, nuk guxonin ta afronin. Megjithatë dashje e padashje ajo u bë gruaja e Gjokë Martinit. Martini, i ati i Gjokës, thoshte shpesh: «Duhet me e rrahë gruen edhe

pa të ba faj, se ashtu i fut frikën.» Dhe Gjoka e rrihte gruan pandërprerje. . . Pastaj filluan telashet e tjera. Ishte vrarë Lleshi, kushëriri i tyre, dhe duhej shpaguear. Një ditë Gjoka, Mehmet Rama, Bajram Gjetja me shtatë vetë të tjerë morën armët dhe shkuan në fshatin ku ishte vrarë Lleshi. Tani gjakmarrja ishte katund më katund dhe nuk kishte të bënte vetëm me shtëpinë e Martin Shejtanit. Të parin njeri që kishin takuar në atë fshat e kishin qëlluar me pushkë, pa pyetur nga ishte e nga vinte. Djali i vrarë nuk kishte qenë fare nga ai fshat. Po kjo nuk kishte rëndësi. Mjaftonte që Lleshi kishte dhënë frymën e fundit në atë fshat, mjaftonte kjo për t'u vrarë kush të gjendej mbi atë dhe. Atëhere ishte dhënë kushtrimi, ishin lëshuar fshatarët dhe kishte krisur pushka si në luftë. Kur ishin vrarë shtatë vetë nga ai fshat, pushka kish pushuar. Gjoka me shokët ja kishin mbathur më në fund për në fshatin e tyre me fitore të korrur, «me fitore të majme», siç thoshin ata. Gjatë rrugës u kish rënë në mendje se kishin vrarë edhe një grue, që po shkonte në mulli pas një gomari.

— Jena koritë, burra! — kishte thënë njeri. — Duhet me u kthye e ma i vra prapë, se tash na del za i keq, që kena vra një femën!

— Lleshi asht la e stërta — kishin thënë ata të tjerët. — Kena vra gjashtë mashkuj. Lene gruen e dreqit!

Ata kishin vrarë shtatë vetë dhe asnjëri nuk kishte dorë në punën e Lleshit. Ç'lidhje kishin patur ata me udhëtarin me pushkën e gjatë, që ishte gjetur një ditë papritmas i përmbysur mbi një dëllinjë? Eh, sa herë i kishte nëmur, sa herë i kishte mallëkuar Dila ata që kishin vrarë njeriun, i cili për pak do ta kishte shpëtuar nga thonjë e bishave! Po se mos do ta priste ndonjë fat më i mirë Dilën! . . . »

Hana u drodh duke kujtuar ato tregime të llahtarshme të nënës së saj. Më në fund nisi të agonte dhe Dila u çua.

— Çou, Hanë, e na tund nj'ata t'amël se unë po shkoj për ujë! — tha ajo.

.....
Një gjel rrahu krahët furishëm dhe ja mori një kë-

ge kumbuese. E pasoi edhe një tjetër, që e zgjati më shumë. Gjoka ndezi edhe një cigare në terr. Ai përherë e kishte pasur zakon që të ndizte një cigare kur i dilte gjumi, pa u çuar nga dysheku ashtu mbështetur në jastëk. Po atë natë ai s'e kishte shuar asnjëherë.

«Do të ketë shkue shumë vonë» mendoi Gjoka me vete. «Kur pushojnë kangët, domethanë ç'i ka shkue shumë vonë. O zot! O i lumi Jezu Krisht! Le të thonë të gjithë që nuk ka zot, se unë besimtar do të jem. Jam një kamë nën dhe e një kamë mbi dhe e nuk më ka hije mos me besue. Gjithkush des e nuk des e plaku des patjetër. Unë do të des ashtu si e do i lumnuemi me ner e me zakon. Disa shokëve të mi ua kanë lanë vajzat burrat, po mue nuk ka me më ndodhë kurrë. Ose ka me më gjetë në dhe të zi. Gjallë jo për të shnosh të zotit.»

Gjoka shuante e ndizte cigaren në errësirë. «Mos të të gabojë zoti, moj Hanë! Mos të të gabojë zoti me dhanë nonji fjalë nepër mbledhje, se për kyt besë të zotit të baj tanë grima-grima. Eee, ti besa, moj vajzë, nuk duhet me shkue në mbledhje aspak. Nuk janë mbledhjet për femna, kam thanë gjithmonë e thom prapë. O zot! Na të vjetrit s'kena pse me kenë gjallë. Po, përderisa jena gjallë, e kena me borxh mos me u korritë. Deka asht kapak florinit, kur të shkon puna me të lanë vajza burrin, ç'i i ke dhanë. E me siguri po të shkojë në aksion, e len burri kjo lushë! Hë, ç'asht kjo! Tamam si e ama. Në hekurudhë po thonë se po i lanë burrat të tana. Po prishen me mija fejesash. Prandej mue nuk ka burrë ç'i ma mush menen me e çue vajzën në hekurudhë. Unë jam Gjokë Martini, ç'i nuk më asht koritë as i pari as i mrami.

Ai nuk e kuptoi kur e zuri gjumi. Ëndrën që pa, nuk diti a e pa me sy hapur apo me sy mbyllur. Pa që Gjelosh Ujka i erdhi në derë duke bërtitur me të madhe: «Si ma bane kyt punë, Gjokë Martini?! Ka ba vajza jote kyt nam të zi e ti je gjallë! E bija e Gjokë Martinin mos me marrë djalin tem?! Me pasë guxim me kundërshtue e reja e Gjelosh Ujkës!? Kurrë sa të shkojë dielli për qiell nuk ma përbuz vajza jote djalin tem! Unë të due vajzën ose kryet

tand për plumb. Gjelosh Ujka nuk pranon mos me begenisë prej vajzës sate. Të tana këto faje i ke ti, ç'i e len vajzën me shkue në aksion! Tash, o vajzën, o kryet tand, po të thom! Nuk dal prej kësaj dere duerthatë! Kjo punë nuk i ka ndodhë kurrë fisit tem!»

Në atë ëndërr, Gjoka pa edhe dom Lazrin, i cili ishte krejt i mendimit me Gjelosh Ujkën. E kur nuk kishte qenë i një mendjeje dom Lazri me Gjelosh Ujkën? Sa herë kishte folur ai me simpati për Gjeloshin! Bile i kishte thënë edhe Gjokës që ndër katolikët burri më i mirë ishte Gjelosh Ujka, kurse ndër myslimanët ishte Mehmet Rama.

— Ooo! — bërtiti Gjoka me zë të lartë, dhe, kur hapi sytë, pa se drita kishte hyrë nëpër vrimat e tjegullave. Dëgjoi edhe të rrahurat e forta të dybekut që tundte qumështin e mëngjezit. U ngrit me rrëmbim nga dysheku, u vesh dhe doli jashtë. Nuk shikoi aspak si ishte dita, po u hapi derën dhive dhe i nisi malit me nxitim. U mundua të kalonte sa më shpejt kodrën e vogël, që ndodhej fill pas shtëpisë së tij. Nuk donte ta shihte kush në ato ditë, se të gjithë do t'i bënin agjitacion për të çuar vajzën në aksion.

* * *

«Baba shkoi malit me dhi e ka me u vonue. Unë kam me pasë kohë me ikë prej shpijet», mendoi me vete Hana. Veshi rrobat më të mira që kishte. Një herë desh t'i thoshte së ëmës, po pati frikë se mos ajo vinte kujën me zë të lartë «kuku, më iku vajza» dhe hajde ta rregullonte punën pastaj.

Gjoka mund të arrinte shpejt dhe të gjitha planet e Hanës mund të prisheshin. Dila e donte lumturinë e vajzës së saj, po nuk e kuptonte ç'rëndësi kishte për Hanën vajtja në hekurudhë.

Hana mori shaminë me plaçka dhe doli pa i thënë gjë së ëmës. Ja mbathi me vrap për te shtëpia e Nikë Shkrelit, pa shikuar prapa fare.

— Ta lumsha krahin, se paske kenë burrneshë! — i tha Nika. — Sa të më kesh mue, mos ki gajle për asgja.

Sa të kesh partinë xhanëm, se ajo na e dha këtë fuqi. Me pa strehë dikur një vajzë, ç'i ikte prej shpijet, më kishte krisë pushka ballit.

Ndërkohë erdhi Teuta me grupin e vajzave dhe të gjitha me një hije trishtimi, u përqaftuan me Hanën. Kur-se gruaja e Nikë Shkrelit qante.

— Po bahesh shkaktar gjaqesh belda, more ti! — i thoshte ajo Nikës.

— Asht lagë baroti i trimave tash, o plakë! Pushkët i kena për anmikun, plakeeee!

— Ti i ke për anmikun, po dikush i ka edhe për ty!

Nika lëvizi dorën, si ta quante të tepërt bisedën më tej me plakën.

* * *

Sokoli mbante në dorë çiftelinë dhe rrinte si i ngrirë. Shokët i luteshin t'i binte, po ai nuk ishte në humor. Hana i kishte thënë që, sapo të fillonin ata të hipnin në maqinë, do të vinte edhe ajo. Mirëpo maqina ishte mbushur plot dhe ajo nuk po dukej. Vërtet nuk dukej as Nikë Shkrelit, as Teuta, po puna e Hanës që ndryshe. «Hana duhet të vijë», mendoj ai, ndërsa po përpiqej të akordonte çiftelinë.

Në qendër të fshatit ishin grumbulluar shumë njerëz. Plakat e pleqtë u jepnin vajzave porosinë, që u kishte dhënë disa herë gjatë atyre ditëve. Sokoli shtrëngonte çiftelinë në duar dhe vështronte rrugën. Pse nuk po vinte Nikë Shkrelit, xhanëm? As Teuta! Si do të ishte puna atje? Mos kishte ndodhur ndonjë gjë e keqe? Ai nuk e kuptonte këtë vonesë dhe tani po vriste mendjen. Sekretari i partisë i tha Sokolit t'i binte çiftelisë. Teulat tringëllinë si të nervozuar dhe në një farë mase e shuan valën e bisedave e brohoritjeve. Është zakon në malësi që, kur këndon kush, edhe po të mos pëlqehet kënga, të mbahet qetësi deri në fund. Bile dikur, po t'i prishej kënga mikut në shtëpi, i zoti i shtëpisë duhej të vriste shkaktarin.

Sokoli ishte duke kënduar me çifteli, kur u duk xha Nika me mësuesen, me disa vajza të tjera dhe me Hanën në mes. Kënga e tij u bë kumbuese, sikur të mos ishte ai që u ankua pak më parë.

Xha Nikua hipi në maqinë i fundit, kur u bind se kishin hipur të gjithë. Ai ndjente se kishte përgjegjësi për të gjithë ata. Sa prindër i kishin thënë t'i kishte kujdes bijtë e tyre në hekurudhë.

Maqina nisi të kërkëllinte dhe të tronditej. Ishte e para herë që Hana po dilte nga fshati i saj hipur në një maqinë. Ajo më parë kishte qenë në qytet nja dy herë, po atëhere kishte shkuar më këmbë duke tërhequr gomarin për kapistre dhe me Gjokën përpara.

Vullnetarët brohorisnin me duart ngritur lart. Nikë Shkreli po u thoshte të rinjve që të këndonin akoma më shumë. Hanën që rrinte e heshtur, «e kërcënoi» me grusht që të këndonte dhe ajo.

— Nuk të ka Gjoka nën urdhëna tash — i tha Nika Hanës, pastaj ju kthye Teutës: — Kur të mos t'nigjoj në këto vajzat për nonji punë ç'i t'u thuesh ti, më thuej mue se ja u ndreqi unë këtyne. Na i kena mësue keq, shoqja Teuta, me do zakonte të këqia, prandej tash duhet me punue shumë. Shoku Zef më ka porositë disa herë.

— Çdo punë do ta bëjmë bashkë — tha Teuta buzëgaz.

— Jo, për çdo punë nuk di unë, po për çka të di e çka të mundem nuk kam me u kursye.

Teuta e përqafoi Nikë Shkrelin në mes të të qeshurave të shokëve.

Ata arritën në qytet pas një ore. Aty i ndanë menjëherë në brigada e kompani dhe u dhanë uniformën e aksionit.

* * *

Xha Nika ishte në një humor të rrallë atë ditë dhe do të vazhdonte kështu tërë kohën, sikur të mos ja kishin prishur vajzat, që po nguronin të hiqnin shamitë

dhe të vishnin pantallonat. Ai i qortoi me zemërim, se po nguronin edhe pasi u kishte thënë ai.

— Po ti, moj! — ju vërsul Hanës. — Të kena vue edhe komandante skuadre!

— Të paktën sa të kalojmë qytetin — i tha Hana.

— A je në vedi me men të kresë, mori! Si duem me dalë para tanë miletit, ashtu si thue ti! Kena me u rrethue para tribunës! Ti ke ikë prej Gjokë Martinit e tash don me na ba llafe! Hiqe shaminë ti e para!

— Nuk asht puna tek unë — tha ajo. — Po ngurojnë të tjerat e jo unë. Hë — ajo kapi thekun e shamisë me dorën e djathtë dhe e tërhoqi ngadalë si e mpirë, derisa i shkau nga koka. Ju duk sikur po shkëpuste një pjesë të kokës dhe i erdhi zor t'i shikonte të tjerët në sy. Ishte e para herë, qysh në shkollë, që hiqte shaminë para kaq njerëzish. Ajo ndjeu se si ju përhapën flokët e dendur mbi supe dhe Nika ja kapi e ja tërhoqi fort.

— Tamam si sykë peshterit më ke dalë! — tha ai.

Hana qeshi, po fytyra ju bë lulëkuqe. Pastaj edhe të tjerat i hoqën shaminë dhe Nika nuk pati nevojë të nevrikosej. Ai qeshte me secilën dhe secilës i gjente nga një nofkë. Pastaj u largua, se ato do të vishnin pantallonat.

Ndërkohë Hanën e njoftuan se ishte caktuar për të përhëndetur në meting me një fjalim të shkurtër. Ajo nuk diji si të vepronte. Kënaqësia dhe shqetësimi ishin bërë një tek ajo. Teuta i shkroi tekstin që do të lexonte Hana dhe kjo menjëherë filloi ta përsëriste shumë herë që të mund ta lexonte pa ngecur.

Ajo hyri mekanikisht në rrjeshtin e vullnetarëve, i cili po zgjatej drejt sheshit të qytetit, ku ishte vendosur tribuna dhe po prisnin kuadratet e tjera të vullnetarëve. Sheshi ishte zbukuruar me flamuj e parulla dhe Hana mendonte pse vallë nuk i qe dukur kaq i bukur herët e tjera qyteti? Ajo mbante mend mirë që kishte kaluar këtej me gomarin e saj.

Hana pa me habi si ishin rrjeshtuar tërë ata njerëz: brigada të rinisë shkollore, kooperativiste, punëtore, të ushtrisë e ç'nuk kishte atje. Tërë ata njerëz prisnin

fillimin e metingut. Në mes të tjerash, ata do të dëgjonin edhe Hanën dhe do të duartrokisnin për të. Më tej qenë rrjeshtuar një varg maqinash, që prisnin për të marrë vullnetarët.

Pas pak Hana kishte hipur në tribunë me shokët e partisë dhe të pushtetit në rreth. Tani ajo thuajse nuk dinte ç'po ndodhte. Mendonte vetëm si do t'i thoshte ato fjalë. Papritmas i erdhi një mendim ugurzi. Po sikur të qëllonte befasisht i ati nga ajo turmë? Ai kishte pasur mundësi të vinte me ndonjë maqinë qysh se ishin nisur ata nga fshati. Hana e mendoi këtë gjë, po nuk ndjeu frikë, Ajo ishte pushtuar më shumë nga ankthi i fjalimit që do të mbante. Dhe atëhere kur ajo nuk e priste fare, dëgjoi të thuhej:

— Në emër të rinisë kooperativiste përshëndet Hanë Gjoka.

Asaj i rekëtiu zemra dhe, si pa vetëdije, e pa veten para mikrofonit. Retë e ngarkuara me shi, që ishin varur mbi pemët e lulishtes, nisën të lëshonin ca pika të mëdha mbi kokët e njerëzve dhe disa hapën ombrellat.

— Shokë!.. Për ne rininë kooperativiste kjo asht një ditë e shënueme...

* * *

Ata e kishin marrë vesh që në aksion do të vinte edhe Sanija. Dhe ja ku u duk më në fund ajo e shoqëruar nga sekretarja e rinisë së rrethit. Kur zunë vend në autobus Nikë Shkreli me «vajzat e tij», Sanija me fytyrën e shqetësuar u afrua te dera e maqinës. Të tjerët panë me kureshtje atë nuse me fytyrë bardhoshe dhe me hundë të mprehtë. Hanës nuk ju durua pa thirrur me zë të lartë «Sanije!» Sekretarja e rinisë dhe disa shokë të tjerë të rrethit bisedonin me Teutën, Sokolin dhe xha Nikën. Pastaj thirrën edhe atë djalin, që quhej Myftar dhe që kishte qenë i shoqi i Sanijes para shkurorëzimit. Vullnetarët e shikuan me vërejtje atë djalë flokrrufç me një mbresë plage në faqen e majtë. Dalluan

se si një herë ai u zverdh dhe pastaj u skuq në fytyrë. Ata që e thirrën, biseduan diçka një copë herë me të dhe sakaq Sanija hipi në autobus. Ajo u përçafua me Hanën, Teutën dhe shoqet e tjera dhe nuk i mbajti lotët. Sa mirë kishte shkuar dikur ajo me ato shoqe! Ajo nuk banonte as në shtëpinë e burrit, as në të babait, se edhe i ati nuk e kishte pranuar brenda vajzën «e përdalun».

Në autobusët e tjerë oshëtinte kënga.

Pas pak autobusi u nis dhe të rinjtë shpërthyen në brohoritje. Hana shikonte herë në njëren anë, herë në tjetrën njerëzit që përshëndesnin me dorë anash rrugës. Përpiqej të rrokte me sy gjithshka. Nuk kishte kaluar këtej kurrë në jetën e saj, andaj çdo gjë që shihte, paraqiste interes për të. Pejsazhet vraponin me shpejtësi prapa dhe ajo nuk kënaqej dot me objektet. Shoqet këndonin këngë, po Hana nuk merrte pjesë. Herë pas here mendja i fluturonte te shtëpia, te nëna e shtypur tërë jetën, te babai fanatik e i papërmbajtur.

Hana ktheu kokën nga Sanija, pastaj shikoi edhe Sokolin. Sa gjë e tmerrshme do t'i dukej Gjokë Martinin po të shihte të bijën duke qëndruar ballë për ballë me Sokolin! Sa i çuditshëm do të ishte rasti kur do të takohet me Gjokën. Çudi! Shumë çudi. Babai i saj dhe Nikë Shkreli ishin moshatarë dhe kishin mendime krejt të ndryshme. Pse babai i saj ishte aq i prapambetur dhe pse xha Nika nuk ishte i tillë? Pse xha Nika i kishte çuar vajzat në shkollë e i kishte bërë mësuese, kurse babai i saj nuk e lejonte as të shkonte në aksion?

Edhe xha Nika dikur kishte qënë prapanik. Por djali që ja kishin vrarë diversantët, kishte punuar shumë me të. Ai kish luftuar me Nikën, derisa kish çuar motrat në shkollë, njëren për mësuese e tjetrën për mami. Pastaj xha Nika kishte rënë. Një herë ai nuk deshte ta pranonte vajzën e madhe të veshur «allafranga» në shtëpi, po pastaj u mësua dhe nuk i bëri më përshtypje të keqe. Kështu u rritën vajzat e tij dhe u martuan me dashuri. Xha Nika pas vrasjes së të birit u bë më luftëtar për të rënë. Eh, sikur ta kishte edhe Hana një baba të tillë.

— Hë, pse nuk këndon? — i tha xha Nika.

— Nuk e di krejt këtë kangë.

— Këndo, moj! Nuk di thotë! As unë nuk di, po bashkohem me shokët si daulle e grisun. Apo e ke menjën te Gjoka?

Hana shikonte gjithnjë pejsazhet që shtriheshin anëve të autobusit. Ajo pa shumë fusha, male, qytete dhe befaz pa diçka të çuditshme, trenin.

Hana u ngrit në këmbë, po mundi të shihte vetëm vagonat në kalim. Me kureshtje ajo vështroi detin dhe vaporët që kishin zënë vend jashtë portit dhe lëkundeshin, sikur t'i lëkundte era e lehtë që frynte zakonisht në ato orë të ditës. Bënte pyetje herë pas herë për çdo gjë si një fëmijë.

Pas disa orësh ajo u ndodh para një bote tjetër, që ja tërhoqi vëmendjen po ashtu si deti, vaporët, treni, Një turmë e madhe vajzash e djemsh me shami të aksionit dhe pantallona uniformë, lëvrinin me lopata e kazma, karro e tokmakë dhe grumbullonin dhe mbi një rryp toke si kurriz peshku. Vullnetarët. Hana nxitoi të pyeste gjërë e gjatë rreth vullnetarëve e trasesë, që ishte ngritur mbi tokë si një kurriz peshku. Ja ajo ishte traseja, rreth së cilës Hana kishte thurur aq ëndrra, për të cilën ajo kishte luftuar aq shumë, për të cilën ajo kish ikur edhe nga shtëpia. Vullnetarët i përshëndetën me dorë. Autobusat ecnin ngadalë dhe ndaleshin aty-këtu. Hana tani ishte bërë si e hutuar. Ku ta dinte ajo se këto skena përsëriteshin gjithnjë, kur vinin vullnetarë të rinj në këtë vend? Ajo nuk kishte parë kurrë kaq entuziazëm, kaq brohoritje, kaq humor.

Ata lanë pas brigadat e Kolonjës, Lezhës. Vlorës, Librazhdit, Universitetit dhe u ndalën rrëzë një ure, nën të cilën kalonte një lumë. Disa vullnetarë ngritën lopatat lart në shenjë mirëseardhjeje.

— Hajde frrokërit! — ja bëri një djalë me flokët e gjatë mbi veshë dhe me një këmishë me shumë xhepa.

— Mbylle, Fredi! S'ka lezet! Këta fyhen — i tha një vajzë me flokë të gjatë të ndarë në mes të ballit.

— Unë nuk e bëj për fyerje — tha ai që quhej Fredi.
— Kam qenë një herë në Pukë dhe kam vërejtur se shumë njerëz mbanin emrin Frrok. Qysh atëhere më jepet gjithnjë t'i thërres malësorët frrokër.

— Kështu kërkon të tallesh me ata ti... — tha ajo dhe nisi të përkulej mbi trase me lopatën e saj të gjatë. Fredi qeshi dhe shtoi:

— Kjo qenka për «punë të pavarur».

Hana e kuptoi se Fredi e pati fjalën për të, por nuk kuptoi se ç'ishte kjo «puna e pavarur».

— Mor budalla, mos folë më, të thashë! — i tha vajza, duke parë Hanën.

— E po duhet të bëjmë edhe shaka, djalli ta marrë! Njerëz jemi. — Fredi quante «punë të pavarur» dashurinë. Hana nuk e vrau mendjen të kapte kuptimin e fjalëve të Fredit. Ajo shikonte si e trullosur gjithshka përrëth dhe po me këtë ndjenjë ajo i kaloi tërë ato çaste, derisa maqinat u ndalën te sektori ku zbritën vullnetarët me çanta e valixhe.

Kur Hanës i erdhi radha për t'u futur në banjo, ju kujtua romani «Dasma», që e kishte lexuar fshehurazi prindërve. Ajo kujtoi që Sokoli nuk ishte dakord me atë pjesë të romanit ku Katrina thosh se vajzat e malësisë nuk kishin bërë kurrë dush para se të vinin në aksion. Sokoli nuk e pranonte këtë gjë, po Hana pak a shumë nuk ishte kundra. «Vërtet, mendoj ajo, ne nuk kena ba kësi dushi kurrë. Unë mushshe një kusi me ujë, e nxejshë, mandej shkojshë në një qoshe të kasolles tanë frikë se mos vinte baba e më gjente. U lajshë shpejt e shpejt, tue i hedhë kah pak ujë trupit me kallajçë dhe, kur mbarojshë, më dukej se kisha ma nevojë me fillue së parit. Pse, dush ishte ai? Mirë ka thanë Katrina. Kurrë nuk kena ba dush».

Pasi bënë banjo dhe u rregulluan në kapanon, ato shkuan të shkurtonin flokët te berberja. Hana qëndronte para pasqyrës së madhe dhe shikonte pyllin e dendur të flokëve, që e kishte zaptuar nga të gjitha anët. Kur ja kreu berberja, ata ju shpërndanë akoma më

shumë dhe asaj ju duk vetja si ajo bisha e çuditshme që kishte parë në një film, kur kish qenë në shkollë. Pastaj ndjeu gërshërën dhe pa tufën e madhe të flokëve të prerë që berberja e hodhi në tokë. Pas disa lëvizjeve të gërshërës dhe një të krehure të flokëve, Hana e shikoi prapë veten me vëmendje me flokët e shkurtuara. Sesi ju dukën tani edhe sytë e vegjël e shumë të zes dhe fytyra rrumbullake me faqet e fryra. «Sikur nuk asht fytyra ime kjo, mendoj me vete. Si do t'i dukem Sokolit? Me siguri kështu ka me më pëlqye ma shumë, se kështu dukem ma e bukur. Po Ucit të Gjelosh Ujkës si do t'i dukem? Si dreqin nuk e njofta atë njeri, xhanëm! Po të më shohë kështu, me siguri nuk do të më lypë ma për grue, se do të më quejë të pandershme».

Pastaj i mblodhën edhe një herë në kapanon e u dhuruan edhe nga një fustan basmaje.

— Këto rroba që kemi patur në fshat, do t'ja lëmë muzeumit — tha Teuta, duke u rënë me majë të këmbës disa çorapeve leshi të hedhura dosido në dysheme.

— Kur të shkojmë në fshat, nuk na lë kush kështu — tha ajo vajza shkurtalaje vetulltrashë, që quhej Zyhra.

— Po t'i shkoj babës me pantallona, do të më grijë—tha një tjetër andej nga fundi.

— More me këta fustanet, thuej, pa me pantallona dihet që nuk na durojnë. Jooo, more!

— Do të rregullohet edhe puna e veshjes suaj — tha Teuta. — S'ka të drejtë kush t'ju detyrojë të vishe ni më kështu si dordolece.

Të drejtë nuk ka, po e ban pa të drejtë—tha Hana.

— Sigurisht, po të ulim kurrizin, ashtu do të ndodhë...

Teuta zuri t'u fliste atyre për detyrat që u delnin sidomos pasi të ktheheshin nga aksioni.

Vajzat ishin grumbulluar rreth Teutës dhe po e dëgjonin me vëmendje të përqëndruar. Ajo kishte bërë një vit në fshatin e tyre dhe e kishin dëgjuar shpesh t'u fliste mu atje, në parcelat e duhanit apo pranë gropës së gëlqeres, te kapat e grurit dhe pllaja e bagëtive. Me-

gjithatë kishte pasur shumë nga ato që nuk kishin patur mundësi të bisedonim me të. Kurse këtu ato bisedonin lirisht, bënin pyetje për çdo gjë pa drojtje dhe jepnin mendimet e tyre. Ajo u dukej më e afërt edhe për arësyen se nëna e saj kishte lindur dhe ishte vrarë në krahinën e tyre.

— Sa vjet do të rrish në fshatin tonë, Teuta?—e pyeti njëra.

— Kur dolëm vullnetare për të ardhur këndeje, ishte fjala për dy vjet, po mbase do të qëndrojmë më shumë — ajo qeshi. — Po të më marrë ndonjë djalë në fshatin tuaj...

Disa thanë se ajo donte të tallej kështu, kurse disa të tjera u habitën se si ajo fliste ashtu, pa teklif, për martesën e vet. Vërtet ishin vetëm vajza atje, po ishte gjë e çuditshme që një vajzë të fliste ashtu e «pa pikën e turpit». Nga ana tjetër kjo u dha edhe zemër dhe dalëngadalë ato nisën diskutimin me zjarr.

— E, prit se po të marthohet kjo prej qyteti në fshat! Ma kadalë! — tha njëra.

— Nuk është e para herë që ndodh kjo gjë — tha Teuta.

Vajzat flisnin lirisht shumë gjëra tani dhe Teuta qeshte me të madhe, duke dëgjuar diskutimet e tyre. Ato dëshironin me çdo kusht ta ndalonin mësuken në fshatin e tyre, ato dëshironin që fshati të ecte përpara, dëshironin përmbysjen me rrënjë të prapanizmit, që u kishte zënë frymën.

Pastaj erdhi xha Nika e i njoftoi vajzat se do të shfaqej filmi «Komisari i dritës».

— Vajza, duhet me e pa me vëmëndje atë film, se del një prift aty tamam si dom Lazri ynë. Fytyrëlig... E kam pa atë film. Tamam ashtu ka punue edhe dom Lazri ynë, që i hëngërt shpirti baltë! Eh, ç'më ka ba mue ai! Nuk e harroj kurrë, as mbasi të hyj në dhe të zi. Njëherë, kur kishte ardhë shën Kolli e fëmijët e mi nuk kishin asgja me hangër veç bukë thatë, mue m'u desht me i dhanë

delen dom Lazrit. Duhej me ja dhanë se s'bante. «Ma ke borxh» thonte qeni. Po të mos e paguejshe priftin, të merrte mëni edhe katuni mbarë, bre. Ai kishte shumë shokë, kurse unë isha fukara dhe nuk më metej vend askund, qe besa e burrave!

— Ai na mori të keqen — tha Hana.

— Ashtu thue ti, po sekretari i partisë së rrethit tha se dom Lazrat kanë lanë helmin mrapa. A nuk e ke pa ti, Hanë, se Gjoka yt flet uratë për çdo natë?

— Baba em asht i veçantë — tha Hana.

— Ehu, sa Gjoka të tillë kena prapë! — ja bëri Sokoli. — Gjoka bile ka një të mirë se nuk asht me dy fytyra. Atë çka ka në zemër, ta thotë edhe në sy. Po asht hall me ata që flasin bukur nëpër mbledhje, çirren për emancipimin e femnës e kundër fesë dhe në shpiti e tyne janë fetarë e prapanikë me flamuj. Këta janë ma të rrezikshëm se Gjokë Martini me shokët.

— Rri, more Sokol, mos m'i del zot Gjokë Martinit, se shokët e tij nuk duhen gja hiç! Ky pushtet asht zemërgjanë shumë! Pale! Pale! Për të tana osullet asht kenë dakord Gjokë Martini, kur i kena shkruie letër shokut Enver e tash na ka hangër fjalët! Burrë asht ai pashnerin! Ai asht prapanik, more! Ai asht... asht... mahlugat, more, për nder! Ai pastë faqen e zezë gjallë e masi dektë, more qeni! A rrahen grueja e vajza si kafshët, siç ban ai, bre! Ma shok se unë nuk e ka pasë kush, po ai nuk asht nier aspak. Mos ma xen me gojë tjetër herë. Sa rixhanë ja kam ba atë natë për Hanën dhe nuk ju rrudh eshkja e synit aspak. Si me pasë kenë unë qen! Gjokë Martini nuk asht as burrë i zakonit, as i kohës. Burrat nuk i luejnë fjalët pa u ra pushka në ballë! E sa e ka ndihmue pushteti atë mashkull! Mos i del zot hiç, Sokol!...

Sokoli në të vërtetë nuk desh të mbronte Gjokën, po ec e merru vesh me Nikë Shkrelin.

— Duelëm nga tema — tha një vajzë me zë të ulët. — Na po flitshim për martesën e Teutës dhe dolëm këtu papritur!

— Këtu kena nevojë me dalë — tha xha Nika — Ja, he burrë! Kot tash kjo — ai e shikoi vajzën si me zemërim. — Muhabet kot! Për një këto punë po vuejmë, se Teuta ka me u martue simas qejfit!

Vajza tani u detyrua të kërkonte të falur që t'ja ulte zemërimin xha Nikës.

* * *

Kur dolën nga baraka, vajzat malësore panë se ishin grumbulluar shumë vullnetarë, studentë të institutit pedagogjik. Ato tani ndodheshin në mes të një brigade që mbante emnin «Qemal Stafa». Hana njohu vajzën me flokët e gjatë të ndarë në mes, që quhej Zanë, e cila e kishite mbrojtur para atij Fredit. Ajo mësoi se Zana na qenkish komandante e asaj brigade. Sa dëshirë do të kishte Hana të bisedonte me të! Po nuk kish si ta ndalonte, se i vinte zor. Si mund ta ndalonte ajo ashtu një komandante brigade studentësh? Ajo një fshatare e thjeshtë, një kooperativiste, që dinte vetëm të rrëmihte tokën?!

Hana kishte marrë vesh se në këtë vend ishte edhe një studente nga fshati i saj. Ajo quhej Lulë. Shumë shoqe kishin thënë se nuk e njihnin, po më në fund Lula erdhi papandehur. Hana ju hodh në krahëror. Tani ajo gjeti edhe një njeri të shkollës, me të cilin do të bisedonte pa drojtje për çdo gjë, edhe për gjërat më intime, do të qante me të hallet dhe ajo do ta ndihmonte më mirë.

— Po ti qenke ndryshue krejt, moj Hanë! Pupu si të kujtoj unë e si qenke tani! — Lula e përqafoi fort edhe një herë dhe e pyeti me ngut për shumë gjëra. — A të kujtohet kur kishim dalë në mal me dhi e unë hyna në rrush të Rexhep Rrukut?

— Si s'më kujtohet! Ti u turpënovë kaq shumë, sa qave. Qave, më duket se të shau ai burri.

— Kurse ju ikët e më latë në baltë!

— E kishim frikë Rexhepin kur na bërtiste. «E, kerçik thiut!»

Hana i derdhi Lulës një mori pyetjesh për jetën e institutit dhe tani për jetën në aksion. Ajo do të donte të dinte për fejesën e Lulës. Kishte dëgjuar të diskutohej për atë punë, kishin thënë njerëzit që Lula e kishte lënë burrin, po Hana nuk e kish tamam të qartë si kishte ndodhur puna në të vërtetë. Papritmas Lula u hodh vetë në temë. Ajo i tha Hanës me një buzëqeshje të ëmbël:

— A je e fejueme prapë me atë fëmijën, Hanë?

— Të shohim ç'po bahet...

— Ç'do të shohësh, moj? Ka vdekë ajo punë që ti nuk do ta marrësh atë burrë. Ehu, hala ke ura ti, Hanë!

Pastaj Hana e pyeti Lulën për fejesën e saj dhe kjo i tha se e kishte prishë me kohë, qysh në shkollën e mesme.

— Sa gja e bukur do të jetë po të mos jesh e fejueme qysh në moshë të vogël! — tha Hana. — Sidomos kur të fejojnë me pleq e me fëmijë.

Kjo bisedë e tërhoqi edhe komandanten Zana, e cila u afrua pranë tyre. Ja tani Hana do të kishte mundësi të bisedonte edhe me atë komandante studentësh. Sa shpejt ajo nisi të hynte në shoqërinë e studentëve! Zana me flokë të ndarë në mes të ballit e pyeti Hanën bile në e njih-te apo jo të fejuarin e saj dhe u habit, kur ajo tha se nuk e njih-te.

— Të paktën mendova se do ta kishe parë ndonjëherë rastësisht — tha Zana.

— Nuk ban ashtu — tha Lula. — Në qoftë se ai do ta shikonte dhe këtë do ta hetonte i ati, pra Gjoka, nuk do t'ja jepte vajzën atij. Prandaj e ka pa ma të arësyeshme të mos e shohë Hanën se sa të mbetej pa të. Kështu asht zakon atje te na.

— Shumë të egra ato zakone — tha Zana. — Si ke ndërmend të bësh tani? — e pyeti me dashamirësi Hanën.

— Kam ndër mend me e prishë fejesën.

Zana u entuziazmtua dhe i premtoi Hanës se edhe ajo do ta ndihmonte nëse mund të hynte në punë ndihma e saj për këtë rast.

— Ndoshta kjo çështje nuk do të zgjidhet edhe për

ca kohë — tha Teuta. Tashti bëhen mblesëritë me forma të reja. Ata që bëjnë matrapazllëkun e vajzave e porositin njëri-tjetrin që të mos i tregojnë askujt të vërtetën. Dhe vajzës zakonisht i thonë: «Ruaj mos të të gabojë zoti e të thuash se nuk e ke marrë vetë burrin, se, për nder, të zhdukim». Prandaj është gjë e vështirë për vajzat e fshatit...

Pastaj Zana pyeti për Sanijen. I kishte bërë përshtypje që ajo rrinte e dëshpëruar dhe si e hutuar. Teuta i tha vetëm se asaj i kishte ndodhur një fatkeqësi dhe kjo u ngjalli akoma më shumë kureshtjen. Ç'i kishte ndodhur vullë asaj nuseje, që rrinte ashtu si e shushatur? Sa e bukur ju duk Zanës ajo!

— Si e ka emrin brigada juaj? — e pyeti Zana Teutën.

— «Muho Selmani»

Zana u mendua ca, pastaj tha:

— Muho Selmanin e kanë vrarë diversantët.

— Po.

Po binte muzgu. Muzgu i parë për Hanën në këtë vend. Muzgu i parë që ajo ndodhej krejtësisht larg prindërve.

KAPITULLI I DYTË

Hana nuk kishte dëgjuar ndonjëherë bori dhe zëri i saj e hutoi për një çast. Nuk e kuptoi në ishte fjetur apo zgjuar.

— Shpejt përgatituni për gjimnastikën e mëngjezit! — thirri dikush.

Zëri i Teutës e bëri të hapte sytë, po gjithnjë ishte e hutuar.

— Hala nuk je zgjuar?! Hajde skuadërkomandante! — i tha Teuta me të qeshur. Tani mendimet ju kthjelluan plotësisht dhe tha me entuziazëm:

— Në gatishmëri të plotë, shoqja komisare! — ajo u ngrit me rrëmbim nga krevati dhe papritmas ju fanitën ngjarjet e jetuara më parë: arratisja, ardhja në hekurudhë. Teuta i tha të fluturonte sa më parë përjashta. Hana doli me një shkathtësi të çuditshme, po vajzat e tjera po vonoheshin. Dikush nuk mund të vishej shpejt, dikush kishte ngatërruar këpucët me shoqet, dikush nuk gjen-te dot të gjitha rrobat. Por më në fund, kush më parë e kush më pas, dolën të gjitha. Teuta nuk ua vuri re shumë, se ishte dita e parë.

Pastaj ajo i vuri të bënin vrap dhe, kur shkuan në fushën e gjerë, filloi t'u bënte ushtrime gjimnastikore. Ajo ndalonte pak nga pak për secilën kohë, se, përndryshe, bëhej rrëmujë. Vajzat e pamësuar me gjimnastikë mëngjezi nuk lëviznin dot në një kohë. Ato në të vërtetë kishin bërë gjimnastikë, kur kishin qenë në shkollë, po jeta e shkollës pothuajse qe shuar në kujtesën e tyre.

— Kujdes, vajza! Një, dy... Përkule trupin, Zyhra!.. Shtrije krahun, Diellë! Edhe ti, Gjyste!.. E prishe punën,

Hanë! Mos dil nga rrjeshti, Lulë!.. Një...dy...tre...katër...
Mirë ti, Zogë! Ashtu....

Pas pak ajo u tha:

— Tani do të shpërndahe mi, do të lajmë sytë, do të rregullojmë bukur krevatet dhe pastaj do të rrjeshtohemi për ngritjen e flamurit.

Hana, pa marrë frymë nga gjimnastika, mori peshqirin e sapunin dhe shkoi te çesma. Kur pa se studentët i lanin dhëmbët me furçë, u turpërua që nuk kishte edhe ajo.

Sakaq te çesma erdhi ai djali që i kishte quajtur «loke» e «froke», ai që e quanin Fredi. Ai kishte veshur një xhup lesi nga ata të importit dhe dallonte nga të tjerët nga shumë gjëra. Bile edhe peshqirin e sapunin i kishte disi ndryshe nga të tjerët.

— Dreqi nuk zgjohet kaq herët! — ju ankua ai shokut që quhej Lulëzim.

— E, mor Fredi, se nuk kemi ardhur për të dëfryer këtu, po për të punuar.

— Sidoqoftë zgjimi është shumë i bezdisshëm. Duhet të ngrihem në gjumin më të mirë.

Ai që quhej Lulëzim e qortoi disa herë.

— Uh, këtu janë edhe këta frrokërit! Thonë se do të flemë në një kapanon me ta — tha me shpoti Fredi.

— Mbylle, Fredi, tani! Mos e tepëro! Ti gjithnjë i kalon kufitë.

Hana i hidhte ujë fytyrës dhe nuk linte t'i shpëtonte asnjë fjalë. Ajo nuk po kuptonte se si mund të fliste një aksionist në atë mënyrë. Nuk kuptonte si ishte pranuar në aksion ai djalë, që kishte ato mendime.

Fredi shikoi nga Hana dhe sikur erdhi ca në humor.

— Qenka alamet cope kjo lokja, ore! — i tha ai Lulëzimit pas pak.

— Ore Fredi, do të rrish urtë apo të të qep një fletërrufe! Në qoftë se të pëlqen, thua ja asaj e jo mua.

— Unë po e lavdëroj. Nuk po them asgjë fyese.

— Mendo sikur t'i flasë kush motrës sate ashtu.

— Unë nuk kam motër fare, po edhe sikur të kisha, ajo nuk do të fyhej po ta lëvdonin njerëzit.

Hana mbaroi punë dhe me një lëmsh urrejtjeje për Fredin u nis për na kapanon. Hoqi çarçafët e batanijet dhe i vuri te koka e krevatit dhe për një çast u ndal të shikonte si e kishte rregulluar Teuta krevatin. E rregulloi krevatin dhe e prishi prapë aty për aty, se nuk ju duk i rregulluar si i Teutës. Ajo nuk kishte rregulluar krevat kështu kurrë në jetën e saj. Së dyti e rregulloi më mirë. Pastaj zuri të krihte flokët. Asnjëherë nuk i kish-te krehur më lehtë. Në shtëpi ajo zakonisht i kishte krehur rrallë flokët, sepse nuk kish ku të fshihej për ta bërë atë punë. Po ta shikonte Gjoka duke u krehur, do t'i thoshte: «Je ba me shkue te burri e nuk të rrihet kërkun, mori gabelicë!»

Pastaj Hanës i thanë të dilte dhe të rrjeshtohej për ngritjen e flamurit, ashtu si bëhej çdo ditë në sektor. Ajo doli pak me vonesë nga kapanoni, doli atëhere, kur oficeri i ditës po jepte komandën.

— Gati-i-itu! Për ngritjen e flamurit, djathtas nderro!

Ajo nuk dinte si do të hynte në rrjesht tani. Po sikur oficeri t'i fliste ndonjë fjalë për prishjen e rregullit? Sa keq do ta ndjente veten para gjithë atyre vullnetarëve! Sa do të turpërohej, kur ta shikonin të gjithë njëherësh! Dhe ndoshta do ta shikonin pastaj tërë kohën si një prishëse të rregullit.

— Hajde, hajde, futu në rrjesht! — i tha Hanës ai dhe ajo u skuq në fytyrë. Ajo priti edhe fjalë të tjera, po oficeri nuk i tha tjetër gjë. Sidoqoftë kjo e goditi. Si e hutuar shkoi në rrjesht, hyri në mensë me shokët dhe bëri ashtu si bënë të gjithë. Hëngri vetëm makaronat, kurse bukën, djathin dhe marmelatën i mori me vete për t'i ngrënë në trase, kur të bënëin pushim.

Ishte ora pesë e gjysmë, kur vullnetarët filluan punën në trase. Në kooperativë zakonisht Hana e kishte nisur punën më herët, sidomos në verë. Ajo shpesh ishte ngritur qysh në orën tre për të vjelur duhan apo për të prashitur.

— Fillim i marë! — tha Nika. — Po punon Nikë Shkre-

li dhe në këto dhena. Nuk kisha menue se do të punojsha në këto ana. Po të kisha dekë pa punue këtu, do të kisha dekë me merak. Edhe vështirë qenka mjaft.

— Pikërisht për këtë kishte nevojë për ty këtu — tha Teuta.

— Qesh ti qesh, po do të kallëzoi ty, kur të bajmë garë bashkë. Hanë, ti me më nejtë gati me dy karro. Unë mbush e ti derdh në trase. Forca! Nuk hahen kot makaronat këtu.

Hana nuk e kishte mendjen te shakatë e xha Nikës. Ajo e kish mbushur karron shumë dhe nuk po e shtynte dot.

— Lueje, lueje! — i tha xha Nika.

Ajo i dha fort e fort, i vuri tërë forcat, u skuq në fytyrë dhe nisi të djersinte derisa e bëri të lëvizte.

— Ja ke mbushur shumë, plak, — i tha tekniku xha Nikës.— Jo kështu.

— Pleqtë për drejt janë — tha xha Nika. — Kush ua ka pa hajrin pleqve!—

Tekniku nuk ishte në humor, prandaj nuk e vazhdoi më tej me xha Nikën. Ai i tha Hanës të kishte kujdes, sepse do të punonte edhe ditët e ardhme. Po Hana nuk pranoi ta lehtësonte ngarkesën, se ju duk që do të «koritej». Aq shumë ishte sforcuar, sa nuk e vuri re as Sokolin, që po punonte atje afër nga kaloi ajo. Atje ishte edhe komandanti i brigadës me tri vajza.

— A kaq pak e ke mbushë karron ti, Hanë! — i tha Sokoli për ta ngacmuar.

— Do me më vra krejt, a?

— S'qenka gja puna jote. Të djersitësh kështu me karron e parë!

— Pa hajde kape ti një herë të shohim apo djersitësh — i tha ajo me buzëqeshje.

Sa e ëmbël ju duk atij ajo buzëqeshje! Sa lirisht e shikonin tani ata njëri-tjetrin! Më parë ata shikoheshin vjedhurazi, kur ishin në prani të të tjerëve. Buzëqeshja e Hanës atëhere ishte e drojtur, kurse tani ajo ishte e

giltër dhe e këndshme si flladi i lehtë, që po frynte në atë çast mbi trase.

Hana me karron e saj prej dru ahu u kthye prapë te xha Nika, i cili menjëherë ngriti nga toka një panxhë të madhe dheu të ngjeshur dhe e hodhi me turr në karro. Po karrua nuk i qëndroi kësaj goditjeje dhe u rrokullis tatë-pjetë bokës. Hana ju vu prapa karros, por, po të mos shkonte edhe Sokoli për ta ndihmuar, ajo nuk do ta nxirrte dot, se vendi qe shumë teposhtë.

— Me të vërtetë që ti je për sherr — i tha Nikës Hana me të qeshur kur u kthye.

— Tue u rritë, tue mësue — tha xha Nika. — Jam i ri. Kur të rritem, do të bahem djalë i mbarë.

Hana qeshi dhe shikoi Sokolin, që po rrihte me tokmak. Sa e lumtur ju duk vetja në atë çast! Koha për të ecte me shpejtësi të mahnitshme; ditët dhe orët mbanin mbi shpatulla ngjarje të mëdha. Këto ditë të aksionit bënë atë që nuk e kishin bërë shumë vite. Ato bënë që ajo të rrinte tani pranë Sokolit dhe t'i buzëqeshte pa pikën e drojtjes, pa frikën nga thashethemet, që i kishin marrë frymën gjithmonë. Si mund të bënte më parë shaka të tilla me Sokolin në sy të të tjerëve? Në fshat ata nuk kishin mundur as t'i shfaqnin mendimin e tyre ndonjërit për martesën e tyre, ndonëse të tjerët e kishin nuhatur këtë gjë prej kohësh. Këtë bile vetëm Sokoli e kishte biseduar me Teutën, Sanijen e së fundi edhe me Zefin. Nuk ishte bërë një muaj që Sokoli, jo pa drojtje, ja kishte thënë Zefit që donte të martohej me Hanën.

— Kjo asht diçka interesante — kish thënë Zefi — Unë kisha ndigjue diçka, po nuk isha i sigurtë. Kjo asht një inisiativë e vështirë, por ne do t'ju përkrahim me të gjitha forcat dhe besoj se do realizohet pa pasoja të këqia. Janë tri pengesa për t'u kapërcyer në këtë mes: martesë midis feve të ndryshme, martesë brenda fshatit dhe martesë me dashuri, duke prishë një fejesë tjetër të kurdisun sipas zakonit. Ky do të ishte një shembull pozitiv për të gjithë fshatin, mësimet e partisë në praktikë. Ti mos u tërhiq. Domethanë ke vendosë përfundimisht?

— Po, po! Unë nuk marr tjetër përveç Hanës.

Zefi u mendua një copë herë.

— Duhet të gjejmë një mënyrë pune me Gjokën. Ai nuk ban lëshime në punë zakoni e feje. Por do t'ja dalim. Duhet vetëm vendosmënia juej. Se ndoshta shumë gjana duhet t'i bani si rebelë.

— Edhe atë do ta bajmë. Na do të bashkohena me çdo kusht.

Zefi kishte qeshur me një kënaqësi të veçantë dhe i kish rrahur shpatullat Sokolit.

— Po sikur të shohësh ndonji kërcënim të fortë?

— Nuk do të tërhiqem.

Këtë mendim ka edhe Hana?

— Po.

— Ju do të keni ndihmën maksimale të organizatës së partisë të fshatit. Organizata e partisë sigurisht ka fuqi shumë më të madhe se kanuni dhe mbeturinat e fesë në fshat. Ti mos u tërhiq, por në fillim me takt... Po baba yt ç'do të thoshte për këtë gjë?

— Sigurisht nuk e pranon. Ti e di sa i lidhun asht ai mbas fesë e zakonit.

— Ashtu asht, po me Shabanin bajmë punë. Kur asht fjala për djalin, malësori ynë ban lëshime, por vajzës nuk i fal asgja.... Për mue asht gëzim i madh, se kena mbetë mbrapa me këto gjana; prandaj unë do të punoj pa u kur-sye. Mesnatë e mesditë kurdoherë më mësyj këtë gjë. Gjatë kësaj kohe unë me shokët do të përgatisim terenin, që as Gjokës, as Shabanit të mos u vijnë të paprituna — ai buzëqeshi dhe i ra supit Sokolit. — Martesa që bahet me sakrifica asht ma interesante, prandaj ma mirë kështu.

Sokoli ua kishte shfaqur këtë mendim edhe dy-tre shokëve të tjerë të organizatës së rinisë edhe mësueses komuniste Teuta. Kurse Hana ja kishte thënë vetëm ku-shërirës së saj, Shaqes. Vetëm kaq. Teuta ishte gëzuar shumë edhe ishte treguar e gatshme për t'i ndihmuar ata ashtu si dhe Zefi, kurse ata të tjerët ishin treguar të lëkundshëm nga frika e ndonjë vrasjeje.

— Të marrësh vajzën e të ikësh nga fshati, kjo mund

të bahet — i kishte thënë njëri nga shokët — por të mar-
tohesh e të jetosh me të këtu, është punë e vështirë. Të
vret, more, burri i botës!

Xha Nikës nuk ja kishin hapur muhabetin, sado që
kishin besim në të. U vinte zor t'ja thoshin.

Hanës ja ndërpreu mendimet një e qeshur që u dë-
gjua andej nga studentët. Një vajzë po bënte garë me një
pedagog. Ishte ajo vajza, që në një reportazh ishte quaj-
tur «gjigantja e trasesë». Ishte e madhe dhe e shëndoshë e
punonte shumë, aq sa nuk ja dilte asnjëri. Pedagogu sapo
kishte ardhur dhe nuk e dinte sa punonte ajo, ndaj hyri
në garë me të i sigurtë se do ta thyente, por ja që ajo e
kish mundur dhe të gjithë po qeshnin. «Atë vajzë e quaj-
në Violeta Çukeli, mendoj Hana, që ishte takuar me të
edhe më parë, dhe më duket se asht prej Vlonet». Sa zë të
trashë që kishte ajo studente! Tamam si djalë! Ose si bu-
rrë plak. Hana mendonte se Violeta do të ishte ftohur dhe
i qe ngjirur zëri.

— Ej! — e shkëputi Hanën nga habitja zëri i Nikë
Shkrelit.

Hana nuk priti më, po i dha karros me vrull. Kurse
Teuta i tha të mos ngutej, se do të thyhej shpejt.

— Uuu, jam mësue me këso punësh në kooperativë.
Këto nuk më duken gja hiç. Për ty që nuk je mësue me u
fërkue me punë, po — tha Hana.

Teuta shikoi duart e veta, që kishin nisur t'i skuqe-
shin. Ajo kishte duar të buta dhe lëkurë të hollë. Kishte
punuar në prodhim edhe të tjera herë, po kohët e fundit
kishte qenë e zënë me punët e mbylljes së vitit shkollor.
Ajo kishte marrë pjesë edhe herë të tjera në aksione rinie.
Kish punuar edhe për hapjen e një rruge malore në rre-
thin e saj. Kish punuar shumë sidomos në kohën kur kishte
bërë stazhin e kandidaturës për në parti. Tërë jetën e saj
ishte marrë me detyra të rëndësishme shoqërore, qysh se
kishte qenë në shkollën tetëvjeçare. Edhe tani, me të
ardhur këtu, e bënë komisarë. Sa detyra kishte për të kryer
këtu! Brigada duhej sa më shpejt të ngrinte estradën, të
formonte skuadrën e volejbollit të vajzave, të organizonte

studimin e historisë së partisë. Pastaj i binte barra të ndihmonte në prishjen e fejesave të vajzave, që i kishte në brigadën e saj. Kurse ndonjëri e quante diçka të lehtë të jesh komisarë. «Nuk je komisarë luftime», i tha një shoqe atë mëngjez. Po a nuk ishte edhe kjo një luftë e madhe? Vetëm luftën me pushkë e konsideronte luftë ajo shoqja?

— Shoqja komisarë, do të të mund — i tha Hana.

— Më ngadalë, moj, se do të mbetesh pastaj.

— A pranon me ba garë me mue? — i tha Hana Teutës.

— Bëjmë, posi — ju përgjegj ajo.

— Të fitoj hallvën unë. Ai pedagogu me Violetën e kishin ba që, kush të fitonte garën, t'i hante hallvën shokut, atë hallvën e drekës.

— Po kush e fitoi garën, Violeta apo pedagogu?

— S'kishte si ta fitonte garën ai pedagogu. Atij ju rrëzua karroca nja pesë-gjashtë herë, kurse Violeta e dërgonte në trase si rrufeja.

Xha Nika u afrua, duke ngritur lart lopatën.

— Ej! — ja bëri ai — Tash po na e marrin flamurin, pra!

— Ne nuk mundet me na e marrë kush — tha Hana, ndërsa po shikonte Teutën që ishte duke punuar në një vend me ujë. Vërtet ajo ishte mbesë malësie, se nëna e saj ishte vetë nga ajo krahinë dhe ishte martuar me një vullnetar nga Jugu që në aksionet e para të rinisë, po sidoqoftë ajo ishte qytetare, sepse atje kishte lindur e ishte rritur dhe ishte çudi që punonte me gjithë atë këmbëngulje në atë vend të vështirë ku edhe Hana, që ishte kalitur me punët e bujqësisë, do ta kishte të vështirë.

— Po hyj unë — i tha Teutës Hana. — Unë jam mësue me këso punësh.

— Edhe unë duhet të mësohem.

— Ti nuk ke nevojë të mësohesh, se nuk asht zanati yt ky.

Teuta qeshi dhe këmba e saj i humbi më thellë akoma.

— Nuk është ashtu — tha ajo. — Puna në prodhim është zanati i të gjithëve.

— Ç'u bane, Hanë? — thirri xha Nika.

Hana vrapoi te karrua. Nika ishte pështetur në bish-tin e kazmës dhe vërente i kënaqur se si punonin vullnetarët. Pastaj lëvizi, vuri dorën strehë mbi ballë dhe tha:

— Ku asht plaku, derdhet gjaku. O shoqja komisare!
Ha-ha-ha!

— Urdhëro, xha Nika!

— Due me hi në garë me ty.

— Kur të duesh.

— Ti thue ashtu se menon ç'i ke me më mund, po për besë të burrave, nuk munesh me më mujtë aq rahat, moj jo!

— Ta provojmë një herë.

Xha Nika tundi kokën për të treguar habinë që Teuta nuk ja vlerësonte fuqitë. Papritmas, atij i erdhi në vesh një melodi kënge. Dikush kishte varur një radio me bateri në një pemë dhe transmetohej kënga «Festë në malësi»

— Kanga e Mrikës — tha xha Nika. — Kjo më pëlqen fort. Kam kenë gjithmonë merakli kangësh.

Po atë kohë u bë pushim dhe zhurma nuk e la xha Nikën të dëgjonte me qejf. Atëhere ai zuri të kundronte grumbullin e madh të dheut, që ishte ngritur për një kohë aq të shkurtër. Atë e hante meraklu për punën, se i dukej që kishte përgjegjësi për të. Sa e sa herë i kishin thënë drejtuesit që të kujdesohej për punën dhe të rinjtë! Të gjithë vullnetarët ishin ulur për të pushuar, kurse ai shikonte grumbullin e dheut dhe trasenë, që po endej në atë luginë.

Hana me shoqet shkuan tek autoboti për të marrë ujë të pijshëm. Gjatë rrugës ajo pyeste gjithnjë shoqet për të gjitha gjërat që shikonte: për majat e maleve, për luginën e përthyer të lumit, për vreshtin e gjelbër që kishte mbuluar kodrën. Pyeste vazhdimisht për emrat e vajzave, që takonte së pari dhe i vinte çudi pse ato nuk i thoshin: «A je?», «A je lodhë?», «A je mërzitë?» Vërtet nuk e njihnin, po a nuk ishte përshtëndetur ajo me qindra herë në fshat me njerëz të panjohur? Si mund të takohej

njeriu në rrugë dhe të mos thoshte asgjë? Sa bëhej gati t'i përshëndeste, ato sillnin kokën në tjetrën anë.

Pasi mbushën paguret, u nisën nga brigada dhe xha Nikën e gjetën tek shikonte gjithnjë punën e bërë. Hana pa qiellin me kënaqësi. Një fillad i lehtë dridhte gjethet e plepave dhe zogjtë cicëronin pa pushim. Më tej gurgullonte lumi.

Hana shkoi te studentët dhe e gjeti Lulën duke u treguar shoqeve se sa pengesa kishte hasur për të prishur fejesën.

— E kisha vështirë, se baba më thosh: «Burrin e ke të mirë e të ri dhe nuk ke përse me na turpënuë kot...» «Vërtet ishte i pashëm. Ishte edhe revizor konsumi. Dhashë e mora, po nuk munda. «Do me luejtë me bisht» më thoshte baba. «Do me marrë burrin sipas qejfit tand, po kështu nuk ka. S'të la unë me dredhë bishtin».

— Paska qenë prapanik modern babai yt — tha Zana.

— Prapanikët modernë janë më të rrezikshmit.

— Vazhdo, Lulë!

— Futa të gjithë njerëzit, që kishin shoqëni e miqësi me babën dhe ishin të një mendje me mue, që ta rregulloja punën në mënyrë paqësore, po më kot. Njeni nga ata që kisha shti unë më spiunoi te baba dhe ai u zemëruë ma keq me mue. Atëhere shkova në komitetin e rinisë së rrethit dhe ata pastaj thirrën një ditë babën e shkesin dhe u dhanë një dush të fortë. Baba ja ktheu paratë dhëndrrit dhe mue më shikoi shtrëmbët disa kohë, po ma në fund u rregulluem.

— Nuk paska qenë interesante kjo — tha një shoqe. — Prisja ndonjë gjë me më shumë dramacitet. Ty ta pas-kan prishur të tjerët fejesën. Vetë nuk paske bërë gjë.

— Ti qenke e një mendje me mua — i tha Fredi asaj. — Lula e bëri me forcën e tjetërkujt. Me dorën e të fortit edhe fëmija shtatë vjeç mund të bëjë mrekullira.

— Po partia nuk e bën me dhunë — tha Lulëzimi.

— Presioni i autoritetit të partisë i detyron të përkulen si para një dhune. Dora e të fortit dhe e të drejtit.

— Prapanikët dorëzohen vetëm kur binden — tha Lulëzimi. — Autoriteti i partisë bën punën e tij, po ama ata që nuk binden, nuk dorëzohen. Përkundrazi vrasin edhe njerëz.

— Tani edhe më plaku e di që i shkoi koha kobures dhe ka frikë.

— Ti je profan në lëmin e zakoneve popullore — tha i nxehur Lulëzimi. — Po ke edhe të drejtë. Ti vetëm një herë ke dalë nga kryeqyteti dhe ke jetuar tri ditë në Pukë. Për atë kohë që ke ndenjur atje, ti ke mësuar vetëm fjalët fyese «Frrok» ose «frrokër». Ti nuk e njeh psikologjinë e malësorit tonë. Atij nuk i dhimbet jeta, kur i preket «nderi», sedra e tij patriarkale. E di që do të pushkatohet, ta zëmë, kur vret vajzën, po nuk tërhiqet nga kjo gjë. E bën këtë punë se e sheh me të arësyeshme të vdesë se të rrojë i «koritun». Pra ajo vajzë që prish fejesën, bën heroizëm, sepse merr parasysh sakrifikimin e jetës.

Fredi nuk e zgjati më, se e dinte që Lulëzimi do t'i kundërpërgjegjej vazhdimisht, si e kishte zakon.

— Le të bëjnë ç'të duan — tha ai për të mbyllur bisedën.

— Si, ore, le të bëjnë ç'të duan?! Të qëndrojmë indiferentë ne? Këtu po ndodhin përmbysje të mëdha, revolucion!

Edhe pse Fredi nuk ju përgjegj, kritika kundër tij nuk u shua. I foli Zana, Lulëzimi dhe të tjerë. Hana dëgjonte me interesim si e kritikonin ata dhe sa kryeneç tregojnë Fredi. Herë pas here matej t'i thoshte atij ndonjë fjalë, po kishte frikë se nuk fliste bukur si ata dhe do ta përqeshnin. Por ndonjë ditë ajo nuk do ta linte pa kritikuar. Bile do t'i vinte edhe fletërrufe.

Dikush thirri xha Nikën dhe i tha se e kërkonte gazetari. Ai u kthye nga ata dhe vuri dorën strehë mbi ballë.

— Çka më do gazetari mue, more? Mue më kanë ra trutë më qafë e nuk i duhem gja askujt tash — tha ai duke u afruar. — Tungjatjeta, shoku gazetar!

— Tungjatjeta, Nikë Shkreli!

Xha Nika u përçafua me gazetarin sipas zakonis dhe i tha se nuk ja kishte bërë qejfin. Gazetari u habit, se këto fjalë Nika i foli pa buzëqeshje.

— Pse ta kam prishur, xha Nika?

— Nuk ke ardhë me punue me plakun.

— Aaa, shumë e drejtë! Po thashë të vija në fund, që të kisha mundësi të rrija më shumë.

— Ma ka ana me qeshë, besa, more shok... Nuk po thom përnjimend... Po çfarë librash shkruen ti? — e pyeti atë.

— Unë shkruaj artikuj në gazeta, reportazhe... Kam shkruar një libër me reportazhe.

Xha Nika e kapi gazetarin për mënge dhe e ndau më vete.

— Due me më shkruaj për një vajzë, ç'i thonë Hanë. Ajo ka ikë prej shpijet. Ju shkrueni në gazetë shpesh për këto të ikurat e vajzave. Më kanë lexue shpesh të rinjtë kësi artikujsh. Edhe vetë di me lexue, po nuk di me ja marrë kuptimin si duhet. Unë e lexoj gazetën vetëm në faqen e katërt ka pak, se kam qejf me ditë ç'bahet atje në Evropë. Nejsje, po e kam muhabetin me na shkruaj shumë për këte vajzë.

Gazetari nxori blokun nga xhepi.

— Me na shkruaj edhe për një nuse — tha ai dhe u vrënjt në fytyrë. — Me i ba edhe një kritikë asaj gjykatës së rrethit tonë, që me u bindë dreqi.

— Po pse, xha Nika?

— Duen me e nda këte gruen kot së koti.

— Gjykata i di punët mirë...

— Për këtë nuk di gja hiç! — tha ai duke lëvizur kra-hun me një gjest nervoz. — E di unë ç'i s'ka nuse ma të nershme. Unë bile kam ba mendim me shkue vetë një ditë në gjykatë dhe me u thanë ç'i dëshmitarët e Myftar Alisë kanë rrejtë si qentë.

Gazetari u zu ngushtë. Buzëqeshi me zor dhe i tha xha Nikës:

— Përderisa burri e ka ndarë gruan, pse të mos e ndajë gjykata? Nuk duhet t'i lënë të bashkuar me zor bre,

xha Nika. Bile edhe kjo nusja duhej ta kërkonte ndarjen. Ç'vlerë ka një familje e tillë, që mbahet në këmbë pa dëshirën e bashkëshortit?

— Aty asht ba një punë e parrugë krejt — tha xha Nika. — Hajde të shkojmë tek ajo nusja.

Xha Nika i priu gazetarit përpara drejt skuadrës, ku punonte Sanija, e cila tani po mbushte dhe me lopatë. U kishte dalë zot shumë karrove për t'i mbushur përnjëherësh dhe nuk i dilte koha të ngrinte kokën për të parë kush lëvizte andej. Shpeshherë nuk i vinte re as karrot kur i vinin për furnizim. Nuk vuri re as Lulën që erdhi nga brigada studenteske për të marrë dhe te Sanija. Dikush i tha që po furnizonte edhe brigadat e tjera dhe vetëm atëhere ngriti kokën e pa Lulën që qeshi me zë të lartë.

— Kam dalë për ndihmë — tha Lula. — Thonë se lypësi nuk ndahet pa gja, por ka faqen e zezë prapa.

— Të furnizoj unë edhe ty — tha Sanija.

Disa anëtarë të tjerë të brigadës i thanë Sanijes që nuk duhej të furnizonte brigadat e tjera. Sanija tani i kishte vënë re xha Nikën dhe gazetarin që po e shikonin atë dhe diç po bisedonin. Ajo e mori me mend se ai po mblidhte ndonjë shënim për të.

Pas pak xha Nika me gazetarin shkuan atje ku po punonte Myftari, i cili nuk e ngrinte kokën nga toka, po edhe kur e ngrinte në të rallë, rrinte ashtu i ngrysur e i pezmatuar. Fliste vetëm kur e kishte të domosdoshme, kur ja donte puna. Xha Nika vuri re se ai po dukej më i hutuar se herë të tjera. Vërtet ai po kujtonte gjëra të trishtueshme. Po kujtonte si ishte paraqitur një ditë te zyra e ndihmës juridike i lagur e i qullur, me fytyrën të zverdhur dhe gjymtyrët që i dridheshin, si deshte të hyn-te në zyrë pa radhë dhe si e ndaluan njerëzit që prisnin atje para tij. Pastaj si ishte ulur në një stol duke u dridhur nga të ftohtit dhe duke psherëtirë. Pastaj, dikur i kishte ardhur radha e kishte hyrë te ndihmësgjyqtari, po nuk kish mundur t'ja thoshte të gjitha gjërat që

kish pregatitur më parë. Kishte thënë vetëm se kishte shkuar aty për të paditur gruan, se donte të bënte ndarje me të. Kishte thënë se e akuzonte gruan për tradhëti bashkëshortore dhe kishte deklaruar se e kish parë me sytë e tij. Ndhmësgjyqtari i kish kërkuar dëshmitarët dhe Myftari kish dhënë emrat e Mehmet Ramës, Bajram Gjetos dhe Gjokë Martinit. Pastaj kishte dalë nga zyra me një letër të daktilografuar në dorë. Toka e qielli sikur e kishin zënë në mes tyre dhe po e shtypnin me forcë. Rrugët e qytetit atë ditë i ishin dukur shumë të ngushta. Myftar Alia kishte ngritur padinë në gjyq! Më parë e kishte sharë Sanijen, pastaj e kish nxjerrë jashtë duke e tërhequr për krahu, ndërsa ajo derdhte lot dhe i lutej:

— Të paktën mos më hap fjalë të këqia, Myftar! Më ndaj, po mos më nxirr fjalë!

— Ti je kurvë! Për këte flet i gjithë fshati.

— Mos, Myftar! Vetëm disa prapanikë flasin kështu! Aman, Myftar! Tregomë ç'ke pa ti me sytë e tu! Mos na prish çerdhen e fëmijëve! Ne kemi dy fëmijë dhe nuk kam si t'ua sjell shpinën!

— Fëmijëve u marrsh të keqen! — kishte thënë nëna e Myftarit. — Ata i mbaj unë si bylbyla.

— Shporru përjashta, lushë! — i kishte bërtitur edhe babai i Myftarit.

— O dil jashtë, o të vrava! — i kishte thënë së fundi Myftari dhe i qe vërsulur Sanijes me grushta, kurse i ati kishte kapur një shkop dhe e kishte qëlluar, po ajo i qe shmangur goditjes. Sidoqoftë ata e nxorën Sanijen në oborr. U mblodhën komshijtë dhe u lemerisën, erdhën edhe shoqet e punës të tmerruara. Qante Sanija, qanin fëmijët e vegjël, që në të vërtetë nuk dinin ç'po ndodhte, po ishte e kotë çdo përpjekje.

Myftari e përcolli Sanijen në shtëpinë e vet dhe u tha prindërve të saj se e kishte ndarë për shkelje kurore. Ata mbetën të shtangur, se nuk kishin dëgjuar asgjë të keqe më parë. U mblodhën familja dhe fisi dhe u nxehën gjakrat. Dikush thoshte që gruaja kur gjendej keq, duhej vrarë; dikush thoshte se vrasjes i kishte ikur koha;

dikush thoshte se nuk dihej puna mirë, se akuza mund të ishte pa baza. Po në fund të fundit Myftari ishte mashkull dhe mashkulli sipas zakonit duhej të kishte të drejtë, ndaj dhe i dhanë të drejtë.

— Edhe pse asht bija jonë e ne na ka ndodhë keq, kjo bushtër do të ketë pasë faj, se femnat gjithmonë kanë faj. Myftari asht djalë i mirë e i shpisë së mirë, prandaj nuk e ndan gruen kot — tha një kushëri.

Babai i Sanijes u egërsua aq shumë, sa kapi sëpatën për ta prerë Sanijen, si të ishte bagëti. Po të tjerët e ndaluan.

— Më lëshoni, se do t'ja pres kryet kësaj shakë! Jam ba gjashtëdhjetë vjeç e nuk ndigjoj me u koritë! Sot në këte moshë me m'u nda vajza për çështje të nderit! Për nder asht farue fisi em, more! Më lëshoni se do ta vras! Në mos sot, nesër, kur të shkon ju, do ta vras!

Plaku në të vërtetë nuk e vrau të bijën, por një gjë e bëri: e dëboi nga shtëpia. Qysh atë natë ajo nuk pati shtëpi të sajën, po banonte herë te një teze, herë te një motër...

Dielli po ngrohte fort dhe Myftarit i shkonin djersët çurg. Atëhere ai e hoqi fare xhaketën, që nuk e kishte hequr asnjëherë. Xha Nika dhe gazetari tani po bisedonin me Hanën. Sokoli qeshte. Myftari u mbështet në bishtin e kazmës për t'u çlodhur ca. Retë e bardha mbi malin e lartë përkundruall tani ishin nxirë dhe lëviznin në mënyrë të çrregullt si të nervozuara.

— «Ty, Myftar, të kanë zanë sytë lesh për besë! Mos, more, se je i biri i babës së mirë! Nuk të ka hije kështu. Grueja jote po na ndyn të tanëve. Unë tash po e kapi vetë ndonji ditë në dorë dhe do të bindet dreqi. Ka me kenë keq për ty ashtu!...

— Pse nuk e sheh tjetërkush keq, vetëm ti dhe ndonji shok yti bre, Mehmet Rama?...

— Të gjithë e shohin, po kanë frikë, se kështu e do emancipimi!... Nusja jonë asht e pandershme!..

— Po pse, mor babë! Ç'di ti për të?..

— E kam pa vetë, more, me Sokol Shabanin!...

— Nuk asht e vërtetë! Ai ka dashmore të bijën e Gjo-kë Martinit!.

— Hë, budallë, ti, po a kujton se nuk mundet me të dyja ai!..

— Na e nxive fytyrën, bir, me këtë grue! Nuk na e vlen lëkura nji pare ma para shoqënisë! Për gjithë natën na sillen njerëzit rreth shpijet!.

— Ti, nanë, nuk e ke dashtë kurrë Sanijen.

— ...E kam ditë unë ç'asht kjo shakë, prandej nuk kam dashtë me e pa kurrë.

— «Vra shakën, se nuk të sillen ma qentë» ka thanë i moçmi...

— Vallahi, sa ke ndenjë në ushtri, kjo grue ka binë dhenë me magjypina! Jam matë sa herë me të çue letër, po thojshë hajt ku po i qes idhnim...

— Edhe ti Bajram Gjetja paske këte mendim?..

— Paj, more djalë, ju jeni shpi e mirë e na ka anda me ju pa me nder e me erëz ashtu siç keni qenë gjithmonë...

— Hiqe deret këte grue, bir, se na marroi!...

Myftarit i dukej se po e shtrydhte horizonti. Kështu e kishte ndjerë veten edhe atë ditë kur kishte shkuar nëpër qytet me akt-akuzën në dorë. Një grup vullnetarësh të brigadave studenteske po qeshnin duke shtyrë një gur të madh, që u kishte zënë rrugën. Sa të gëzuar i dukeshin ata dhe sa i pikëlluar ishte ai! Kishte bërë disa seanca gjyqësore dhe divorci nuk ishte bërë akoma. Ai kish thënë që e kish parë gruan keq vetëm e vetëm që të rëndonte sa më shumë mbi të dhe ta ndante lehtë, po vetë nuk kishte parë gjë kurrë. Sa shumë ishin dashur me Sanijen! Ai kishte thënë vetë sa herë që dëshironte të vdisnin të dy përnjëherësh, se njëri pa tjetrin nuk do të mund të jetonin të gjallë. Kurse tani jetonin të dy gjallë të ndarë pa u shikuar as në sy!

Ai kujtoi si kishte shkuar në fshatin e Sanijes dhe e kish parë atë vajzë që i kish pëlqyer aq shumë. Pastaj kishte futë njerëz që t'i mbushnin mendjen familjes së saj.

Familja nuk pati kundërshtim. Myftari vinte shpesh në fshatin e Sanijes me agronomin e kooperativës, që e kishte shok dhe e vërente Sanijen si bëhej lulekuqe në fytyrë. Asaj nuk i pëlqente që Myftari e shikonte ashtu, pa ja ndarë sytë asnjë çast. Pastaj ajo e shikonte si ndalej ai edhe te këndi i emulacionit, ku kishte dalë Sanija në fotografi, si punonjëse e dalluar. Bile për këtë gjë babai i Myftarit nuk e kishte pritur mirë fejesën me këtë vajzë, po edhe nuk e kishte kundërshtuar. Sipas tij një grua «e nderhme» nuk duhej të dilte në kënde e në gazeta.

— Këtu nuk kena me e lanë me dalë as në kande as në gazeta — kishte thënë babai aso kohe.

Megjithatë ata u martuan dhe qenë një çift i lumtur. Ai nuk e dinte se si mund të dashuroheshin më shumë njerëzit. Kur shkonte ndonjëherë në shtëpinë e saj, Sanija i thoshte atij ta linte sa më pak, se nuk rrinte dot larg tij. «Ç't'i bajmë zakonit, se kurrë nuk kishe me të çue me ndenjë ma shumë se tri net» i thoshte Myftari.

Prindërit e Myftarit nisën të mos e shihnin me sy të mirë këtë dashuri.

— Mue kurrë nuk më ka pa kush tue folë me gruen — i thoshte i ati. — Edhe unë e kam dashtë gruen, por me kufi. Burri nuk duhet me u zgërdhi me gruen kështu. Ajo duhet me të pasë frikën. Grueja duhet me të dash-të e me të drashtë. Myftari em më ka koritë. Kuven me mue këndeje e sytë i ka kah e shoqja. Ma hangërt dreqi burrëninë e tij!

Një herë bile plaku e shfaqti këtë mendim edhe në sy të Zefit.

— Ju shokët e partisë po u nepni ujë shumë këtyne të rijve... — ai i kishte treguar mendimet e tij për djalin e nusen, Sanijen.

— Ç'hall ke, mor Ali? — i kishte folur Zefi — Ti gjendjen e ke të mirë në shtëpi. Djali dhe e reja punojnë dhe i ke shumë të mbarë për shtëpi. Kush asht ma mirë se ti sot?

— Kur të hash marren me bukë, nuk të duhet gja mirësia, Zef-a!

— Sanijen e Myftarin i kemi punonjësit ma të mirë të kooperativës, prandaj të mos u përzihesh me u qitë idhnim. Asht fat për ne me pasë këso nusesh siç asht Sanija.

Aliu deshte t'i thosh: «Po besa, fat asht për ju, se hargaliseni me të», po ju duk tepër e rëndë kjo fjalë për sekretarin e partisë, për të cilin ushqente shumë respekt.

— Pse nuk na vritni më mirë ne të tjerëve, pra shoku Zef?

— Na dëshirojmë t'ju përtërijmë dhe jo t'ju vrasim.

— Nji kështu na vrisni për së gjalli. Kena pasë zakone të mira. Zakonet tona i ka lëvdue edhe shoku Enver Hoxha.

Zefi pastaj i kishte shpjeguar edhe një herë atij se cilat ishin në të vërtetë zakonet e mira dhe cilat të këqia, po Aliu i binte kavallit të tij.

Të tëra këto gjëra po i kujtonte tani Myftari, ndërsa studentët po gajaseshin duke rrotulluar gurin. Një shok i tyre ishte rrëzuar në baltë dhe ata qeshnin. Ai ngriti kokën lart dhe pa vjedhurazi Sanijen tek po mbushte karrot. Sanija e kishte vënë re se si Myftari e shikonte shpesh herë vjedhurazi dhe nuk dinte ta shpjegonte këtë gjë. Edhe ajo në ato çaste po mendonte për të njëjtat skena dhe e kishte kapur një mall i thellë për fëmijët. Ajo ishte e bindur se Myftari e donte dhe nuk do të mund ta largonte nga zemra, po habitej si mund të vepronte kundër vullnetit të tij. Me qindra herë ja kishte bërë vetes këte pyetje dhe nuk kishte ditur t'i përgjigjej.

Një maqinë u ndal para tyre dhe filloi shkarkimin e shinave e të traversave. Disa vullnetarë shkuan për të shkarkuar materialet, kurse Sanija vazhdoi mbushjen e karrove. Hana i tha disa herë që ta ndërronte, se ishte lodhur, po Sanija nuk pranoi.

Pastaj ju afrua Sokoli dhe ja mori lopatën nga dora, po ajo rrëmbeu një lopatë tjetër dhe vazhdoi mbushjen e karrove. Myftari i shikoi me vërejtje tek punonin bashkë. Ai i kishte akuzuar edhe në gjyq se ata ishin dashnorë, duke u bazuar te dëshmitarët e rremë, po tani ishte i bindur krejtësisht se nuk kishte patur marrëdhënje dashurie

në mes tyre, ishte bindur se bisedat e shumta të Sokolit me Sanijen kishin qenë gjithmonë për Hanën. Sanija kishte qenë një ndihmëse e fortë e tyre, se dëshironte t'i martonte së bashku. Eh, ç'budallallëk i kishte lejuar vetes Myftar Alia! Po tani ishte vonë. «Burrat e zakonit» e kishin lavdëruar veprën e tij si një vepër burrërore po nga ana tjetër i kishin thënë që, po ta merрте prapë atë grua, që e kishte ndarë një herë, do të koritej njëmijë herë dhe fytyra e tij do të bëhej si sholli i këpucës pa asnjë vlerë. Si mund të dilte para të atit, po të ribashkohej edhe një herë me gruan?

Mendimet e tij ja preu zhurma e madhe që po bëhej rreth garës së xha Nikës me Teutën. Xha Nika kishte shpërvjelur mëngën e këmishës, kurse xhaketën kadife e kishte varur në një pemë. Ai nuk e kish parë veten kaq të djersitur kurrë, se zakonisht djersinte me zor.

— Ku asht plaku, derdhet gjaku! — ja bënte ai. — Nikë Shkreli nuk ja kalon një vajzë për të shëndoshë! Po më dhimbet mjaft kjo komisarë, se i janë ba duert gjak, po nuk kam çka me i ba.

Një grup vullnetarësh, duke punuar, morën një këngë popullore, po tani xha Nikës ato nuk ja tërhiqnin vëmendjen. Një herë e kishte kapur si me shaka, po tani e kishte zënë inati dhe nuk donte ta linte Teutën t'ja fitonte garën.

«Unë jam plak dhe tash po bie gardh për faqe të zezë, mendonte xha Nika. Kjo vajzë asht e re dhe e fuqishme e nuk munem me ja dalë. Jam gati shtatëdhjetë vjeç. Si nuk po nxeht hiç kjo komisarja xhanëm, ë? Kurse unë kryet gjok e mendjen zok! Unë kam kenë te pesëdhjetë vjetët, kur ka le kjo vajzë, me të cilën po baj garë tash! Më ka tha etja dhe nuk kam kohë me dalë e me pi ujë, se metem mrapa.»

Pastaj dikush këndoi kastile për t'ja tërhequr vëmendjen:

*Moj e mira synë e zi,
kërkun çiftin nuk ta di*

— Hë, të lumtë goja, bukur po këndon! — ja bëri xha Nika. — Kush këndon kështu si me kenë prej Malësisë së Madhe se? — thoshte ai pa e ngadalësuar ritmin e punës.

— Do të ta ha racionin e hallvës, xha Nika! — i tha Teuta me të qeshur.

— As dhetë vjet masi të des, nuk munesh me ma hangër hallvën ti, more!

Myftari po buzëqeshte, sado që ndaj këtyre gjërave ai përpiquej të qëndronte indiferent. Ishin çastet e fundit të orarit të punës dhe vullnetarët kishin ulur kurrizin që të përfitonin nga këto minuta. Po nuk vonoi të binte boria e mbarimit dhe vullnetarët u grumbulluan rreth Nikës e Teutës, ndërsa komandanti e tekniku po bënë matjen e punës. Erdhën vullnetarë edhe nga brigadat e tjera; erdhën edhe gazetari me sekretarin e partisë. Fredi po u thoshte shokëve se Teuta ishte patriotja e tij dhe Hanës nuk ju durua pa folur:

— Ç'dreqin e ban atë patrioten tane!

— Moj frroke, kush foli me ty!

— Fredi! — ja tërhoqi vëmendjen Lulëzimi zëtrashë.

— Kjo më fyeu mua! S'ka lezet, Asgjë nuk po i thosha!

Hana u fut në mes shoqesh dhe nuk foli më gjatë.

— Nuk erdhe me më pa në garë — i tha xha Nika gazetarit.

— Ku ta dija unë këtë gjë. Nesër do të rrimë tërë ditën bashkë.

Ata biseduan edhe ca, po ua ndërpreu komunikata e garës:

— Xha Nika ka nxjerrë një metër e tetëdhjetë centimetra kub dhe në trase, kurse Teuta dy metër e pesë centimetra.

Sakaq në radhët e vullnetarëve shpërthyen duartrokitjet.

— Eh, ç'm'i ke qitë krahët e rij, moj komisare! — tha me të qeshur xha Nika dhe toku duart me Teutën. — Sot e mrapa nuk do të thom ma «ku asht plaku, derdhet gja-

ku». Të rijtë janë të zotët për me derdhë gjak e me ba gjithëfarë punësh.

Teuta ja ngriti të dyja duart xha Nikës dhe i bërtiti:

— Dorëzohu, Nikë Shkreli, se tani po ta ha racionin e hallvës!

— More, për nder prapë më han shpina me ba garë me ty. Jam i Shkreli dhe nuk dorëzohem. Jam prej bajrakut të Bec Patanit e të Çul Patanit.

Bec Patani e Çul Patani

U thotë Malcia kah po mani

— zuri të këndonte xha Nika dhe entuziazmi në trase arriti kulmin.

Hana i dëgjonte këto biseda e afruar fare pranë Sokolit dhe e ndjente veten më të lumtur se kurrë. Papritmas si gjithnjë kur ishte e lumtur, i vajti mendja te babai.

Sa fusha e male, fshatra e qytete, përrenj e lumenj kishin hyrë në mes të asaj dhe Gjokë Martinit! Një botë e tërë! Një botë e tërë i ndante edhe mendimet e tyre. Ajo qëndronte në rrjesht pranë Sokolit. Ata këndonin dhe ajo e ndiqte automatikisht, pa e patur mendjen. Kërcënimet e babait vinin si një jehonë e largët, shumë e largët, po papritmas ato sikur trokitnin pas rrypit të gjatë të trasesë fare afër. Po të kthente kokën anash, do t'i dukej me siguri që do të shihte Gjokën, duke bërë kryq pas kryqi. Ai do të përpiquej t'i ngrinte kryqet mbi trase, por traseja do të dilte prapë mbi kryqet e tij. Ajo me të vërtetë e ktheu kokën anej, por në vend që të shikonte Gjokën me kryqet e tij, shikoi grupin e vullnetarëve të turnit të dytë. Gjoka ndodhej shumë larg nga traseja, kurse Hana ndodhej pranë Sokolit në rrjesht, duke kënduar një këngë partizane. Vajza e Gjokë Martinit, e atij që kishte vrarë me dorën e tij shtatë vetë, rrinte pranë dashnorit të saj pa pikën e turpit! Ajo mendonte se nuk e dinte askush ç'kishte me Sokolin.

Edhe kur arriti në sektor, edhe kur oficerja e ditës po tregonte për aktivitetet që do të zhvilloheshin atë pasdite,

edhe kur u nisën për në mencë, asaj gjithnjë i ngatërrosheshin në përfytyrim fytyra e babës dhe kryqet që bënte ai herë pas here.

Në mensë nuk mendoi për ato gjëra, se ishte lodhur dhe e kishte marrë uria. Mensa ishte një barakë e madhe populiti me tavolina të gjata, në të cilat rrinin nga gjashtëmbëdhjetë veta. Hanës i bënë shumë përshtypje sidomos mbulesat e tavolinave me tigrë të pikturuar. Bëri ç'bëri e u ul në tavolinë së bashku me Sokolin. Sanijen e caktuan përgjegjëse tavoline.

— Edhe këtu me u sulë si në trase — tha Xha Nika.

— Mos flisni duke ngrënë, se ju pengohen reflekset! — tha një student.

— Çka tha ky? — pyeti Hana.

— Ti don me ditë gjithçka, xhanëm! — i tha xha Nika. — Thueja ti, Sokol, se unë nuk e mora vesh a foli shqip a turçe ai studenti.

— As unë nuk e mora vesh ç'desh me thanë ai.

— Si nuk e more vesh? A je sekretar rinie?

Sokoli u mundua të mbante të qeshurën.

— Këto gjana dihen tue mësue në shkollë, kurse sekretar rinie mund të bahesh edhe me aq shkollë sa kanë shokët e tjerë të organizatës.

— Nuk di unë, por ti duhet me i ditë këto gjana, se rinia merr men prej teje. Shtatë klasë shkollë i ke ba edhe ti, ushtar ke kenë e... asht marre mos me e ditë, he burrë.

Sokoli tani e pa se nuk po ja mbushte mendjen dot xha Nikës, prandaj e mbylli bisedën me një buzëqeshje. Për një kohë në mensë dëgjohej vetëm zhurma e lugeve.

Pastaj në mensë u futën Ylli, kryetari i komitetit ekzekutiv të rrethit dhe dy-tre të tjerë. Xha Nika u ngrit në këmbë për t'i respektuar, po ata i thanë që të mos ngritej, se në bukë nuk duhej ngritur për asnjëri.

— Si, more, nuk po çohena! Edhe sorra për sorrën thonë se lot e jo ma nieri për nieri! Çoni, more, paçi faqen e zezë!

— Mos luaj, Nikë Shkreli! — i tha kryetari.

— Mos e folë atë fjalë, he burrë, po si nuk po luej! Nuk po më ikë gjella kah, bre burrë! — tha ai dhe toku duart me ta.

— Ti je Nikë Shkreli, ë? — e pyeti kryetari buzëgaz.

— Kam pasë kenë dikur.

— Po tani nuk je?

— Tash jo, se këqyr si jam ba! Kam nja shtatëdhjetë pa dy vjet në shpatulla. Më janë zbardhë edhe qimet e fytyrës, se lene ma të kreut.

— Derisa punon me rininë, ja ke hedhur pleqërisë, Nikë Shkreli.

— Më merr e keqja me kenë i ri kanjiherë... Por sot jam koritë, shoku kryetar. Aty i thashë vetes: «Je plakë, o Nikë Shkreli, dhe nuk të ka metë asgja tjetër veç fjalëve» — tha dhe u tregoi shkurtimisht për garën që kishte bërë me Teutën.

Vullnetarët qeshën me ushqim në gojë. Përsëri dikush tha të mos qeshnin, se po u pengoheshin reflekset, kurse xha Nika e ftoi kryetarin me shokë që të uleshin për të ngrënë.

— Na byjrymni, burra, se nuk asht mirë na me hangër e ju me këqyrë.

— Ne nuk e meritojmë, se nuk kemi punuar sot — tha kryetari me shaka.

Ata pastaj dolën jashtë dhe, pasi mbaroi dreka, e thirrën Sanijen në Zyrën e Yllit. Atje dëgjuan hollësisht nga goja e saj si i kishte ndodhur fatkeqësia.

KAPITULLI I TRETË

Shoqet flinin...

Hana e mbaroi letrën së shkruari dhe e futi në zarf. Po ja dërgonte atë letër shoqes së saj të ngushtë, Shaqes, dhe ajo do t'ua lexonte Dilës e Gjokës, se ata nuk dinin të lexonin asnjëri. Po a do të pranonte Gjoka ta dëgjonte atë letër të së bijës së ikur? Ai, që tani do të ishte duke bërë planet për vrasjen e saj? Si mund ta lexonte Shaqja letrën para tij? A nuk do të kishte frikë? Sidoqoftë nënë Dilës të paktën do t'ja lexonte.

Të nesërmen Hana pati rast të punonte pranë Myftarit dhe biseda e parë që hapi me të ishte puna e Sanijes. Myftarin e kishte thirrur Ylli dhe Hana e kishte marrë vesh se kishin biseduar për çështjen e Sanijes, ndaj ajo e pyeti se ç'i kish thënë ai. Myftarit nuk i pëlqeu ajo pyetje e Hanës. Si t'i përgjigjej asaj? Ai mori barominën e ajo varenë dhe vazhduan hapjen e një vrime për minë në shkëmb. Atje ata të dy ishin vetëm dhe tani po punonin pa fjalë. Myftari ishte i ngrysur dhe nuk donte muhabet. «U lodha, mendoi ai. Kam kalue tanë ato gjyqe e stërgjyqe, po kam qëndrue i patundun. Para shokut Ylli u lëkunda pak», mendoi dhe kujtoi edhe një herë bisedën me të...

— Ti ke hall të madh — i kishte thënë Ylli. — Kisha qejf të bisedonim edhe një herë së bashku. Po të ishe dakord ti, do të kisha dëshirë të më thoje me përpikmëri si ka qenë puna. Kam dëshirë ta dëgjoj nga goja jote, se nga të tjerët e kam dëgjuar mjaft — ai i shtriu dorën dhe

Myftari e kuptoi përse. — Ma jep dorën si burrat. A ke besë si burrat e malësisë?

— Kam besë...

— Dua të më tregosh diçka.

— Në kjoftë se e di...

— Këtë gjë e di me siguri — dhe uli sytë si t'i vinte rëndë të bënte pyetjen. — Ti në gjqyq ke deklaruar se e ke kapur gruan në flagrancë. A është e vërtetë kjo?

Tjetri nguroi të përgjigjej menjëherë. Ju duk se po e shtrydhnin të gjitha muret e dhomës dhe dielli nuk bënte dritë përjashta. Si t'i përgjigjej Yllit? Ai nuk e kishte kapur gruan asnjëherë në flagrancë. Si të thoshte, kur edhe djali që kishte akuzuar në gjqyq, ishte aty?

— Këtë çështje nuk do ta lëmë kështu, Myftar. Atë djalin që ke akuzuar ti, do ta kapim. E dimë që ai dashuron edhe një vajzë. Ndoshta ai ka dëshirë të bredhë lule më lule, po shoqëria nuk duron këso shfaqjesh imoraliteti...

E si të përgjigjej ai, kur, në të vërtetë, nuk e kishte parë?

— Gjykata është e mendimit se ty të mungojnë provat për shkurorëzim. Edhe dëshmitarët e tu janë të dyshimtë. Ata, në qoftë se të ndajnë, e bëjnë këtë vetëm ngaqë ti ngule këmbë së tepërmi dhe atyre nuk u intereson që të të mbajnë me zor në kurorë. Unë dua të di në e ke kapur apo jo në flagrancë dhe do të të ndihmoj pastaj.

— Shoku Ylli... Unë... Tashti krejt në flagrancë nuk e kam pa... por aty afër... Domethanë... — Ai po nguronte. I qe lidhur gjuha, sepse tani e ndjente se duhej të thoshte të vërtetën. Në këtë çast ai po kujtonte se si ja kishte spjeguar Sanija çështjen. Në të vërtetë Sokoli kishte biseduar me Sanijen shpesh për çështjen e Hanës, se ato ishin shoqe të ngushta. Sanija përpiquej sa mundej për ta, se i vinte keq që ata të mos martoheshin me njëri-tjetrin. I vinte keq për Hanën që ishte fejuar ashtu, dhe që kishte një baba aq prapanik të egër si vetë kanuni.

Myftari po nguronte... Sekretari i partisë lëvizi nga vendi dhe ripyeti:

— E shihje ndonjëherë duke biseduar në ndonjë vend të papërshtatshëm? Më fal që po të të pyes si në gjykatë!

— Po... në çdo vend që të ishte, shoku Ylli... ajo nuk kishte të drejtë me bisedue me të... Ç'punë kishte me të...

— Qysh se i the të mos bisedonte me të, ajo nuk e përsëriti, apo jo?

— Kjo asht vetëm një anë, mor shoku Ylli. Kam ndejë pak në shtëpi dhe nuk kam mujtë me ja pa të gjitha të këqiat, po kjo asht rezile. Pse sillet mirë këtu, nuk do të thotë gja.

Dy orë biseduan me Yllin dhe Myftari mundohej gjithnjë të qëndronte me kryeneçësi, po fjala e tradhëtoi. Nuk mundi të qëndronte në ato fjalë që kishte folur më parë. Sa do të zemërohej babai, po ta merrte vesh atë lëkundje të Myftarit para Yllit!

«Në kjoftë se e merr ma atë grue, ta dish se ta pres kryet, në mujsha! Kështu, bir. Masi na e hoqi zoti një herë deret, kurrë mos na e çoftë ma shoqen e saj! Atë shtrigë shtriget! Ma mirë me deké! Prano gjithçka, biro, e atë mos e prano ma në shpi, pa deké!...

Aq më keq do të ishte, po të merrte vesh lëkundjen Mehmet Rama. Sa shumë ishte gëzuar ai njeri, kur Myftari ndau gruan!

«— Valla e ke ba një punë me ven tamam si burrat motit. E ke lanë pikë. Të lumtë! Veç po të thom edhe një gja: Në kjoftë se e merr prapë, pra zota koritesh krejt, korit të parë e të mram e nuk ta nep ma kush dorën për burrë! Prandej kije kujdes vedin! Qëndro burrë i fortë, se grueja asht e dhimbshme, sado me ta prishë. Grueja ka shti shejtanin në shishe — i kishte thënë Mehmeti me një frymë.

— Nuk jam fëmijë, more Mehmet. E kam vendosë një herë — i qe përgjigjur Myftari atij me vendosmëri.

E di e di, po kah niyej hallkun njëashtu, tue thanë po e merr Myftari gruen prapë, nuk ma ka anda; a di, zemra më grihet, me të folë pa rrena. Jo pse të kam dalë dëshmitar në gjyq, po nuk më ka qejfi, se je një copë djalë i mirë. Një herë e lave vedin si burrat e tash me lëpi prapë pështymën

që ke qitë një herë për gojë. Mos më thançin Mehmet Rama, në mos ta gjej një grue ma të mirë se atë. Bile vajzë gjash-tëmbëdhjetë vjeçe dhe të nershme, që mos me ja gjetë shoqen.

— Ajo që thue ti, Mehmet, ka vëllain e arratisun.

— Po ç'të keqe ka, bre Myftar? Ai asht i arratisun për vete»

Eh, sa ngushtë kishte rënë Myftar Alia!

Ai ngriti kokën dhe vështroi qytetin e vogël kundru-all. Sa kënaqësi po i ngallnin ngjyrat e qytetit dhe gjelbërimi i pyllit përreth!

— Sa shejpt u djersite, Myftar? — Hana e bëri këtë pyetje sa për të thënë diçka.

— Nuk jam mirë sot... Jam si pa qejf...

— Ulu pusho, pra!

— Nuk jam i lik aq fort. sa mos me punue, he burrë-neshë!

Toni me të cilin ju përgjegj ai, e bëri Hanën të mos vazhdonte më.

Myftari hodhi shikimin nga brigada që punonte poshtë dhe vështrimi i tij u ndesh me atë të Sanijes. Ajo uli kokën. «Sanija asht shumë e mirë, mendoi ai. Sa punëto-re! Ajo asht kandidate e parë me fitue distinktiv e fletëlavdërim. Kështu ka punue edhe në kooperativë.»

— A thue se do ta fitojmë flamurin sot, Myftar? — pyeti Hana prapë.

— Ku di unë... Ndoshta....

Sakaq erdhi minatori për të bërë mbushjen.

* * *

Studentët kishin rrethuar Sanijen dhe po diskutonin pa drojtje për çështjen e saj. Shqetësimet për të nuk jetonin vetëm në ndërgjegjen e anëtarëve të brigadës «Muho Selmani», po i kishin shtrirë rrënjët edhe në çadrat e kapanonet e brigadave studenteske. Disa shoqe studente i kishte zemëruar qëndrimi i Sanijes. Pse ajo kërkonte të

bashkëjetonte me atë njeri që e kishte fyer aq rëndë personalitetin e saj? Zana po fliste me të madhe kundër Myftarit si një njeri i padenjë për t'u ribashkuar. Le të kishte fëmijë. Nuk duhej t'i mbanin bashkëshortët të lidhur vetëm fëmijët, thoshte Zana.

— Eh, ti nuk i njeh si duhet ato zakonet tona, moj Zana — psherëtiu ajo. — Ai më do me gjithë shpirt dhe nuk asht dakord kurrë me më fye ashtu, por fanatikët, nana e baba, zakoni. Myftari asht njeri i mirë, për këtë jam e sigurtë.

— Sido që të jetë, ti ke dinjitetin tënd dhe nuk duhet të durosh fyerjet. Ai të ka fyer. Ç'e do një djalë të ri që është bërë mashë e prapanikëve.

— E trullbësën gjarpënit! Ja morën mendtë! Ai më do...

— Po ty a do të të trullosnin gjarpërinjtë?

Sanija uli sytë.

— Jo, ty nuk do të të trullosnin — vazhdoi Zana, duke u dhënë flokëve me dorë. — Ti ishe e sigurtë në dashurinë tënde dhe të tij, prandaj nuk do të mund të të thyenin prapanikët. Kurse ai nuk paska pasur siguri te ti.

— Ka fëmijët, moj Zana! — ndërhyri ajo që quhej «gjigantja e trasesë», Violeta Çukeli.

— Nuk asht puna te fëmijët — tha Sanija. — Unë fëmijët i marr me gjyq, se më takojnë. I marr dhe i rrit, se për këtë kam ndihmën e partisë, po puna asht se na të dy e kena njeni-tjetrin në zemër.

— Unë do t'ja përplasja surratit atij burrit! — tha e indinjuar ajo studentja me sy të vegjël, që quhej Zhuljeta. — Ai nuk mund të jetë më bashkëshort. Një njeri që ka kryer edhe ushtrinë të jetë kaq naiv, kaq idiot, sa të shkollë qorrazi pas thashethemeve!

Sanijes nuk i erdhi mirë që ajo e quajti Myftarin «idiot», po nuk e bëri veten. Ajo ishte e bindur se ai ishte i mirë, ashtu siç ishte e bindur se e kishte kuptuar edhe gabimin për dëbimin aq të rrëmbyer të Sanijes.

— Ndikimi i ambientit mbi individin — hodhi një fjalë Natasha.

— Lëri filozofitë! — bërtiti Zhuljeta. — Ai do dajak!
Unë do ta pështyja në mes të njerëzve!

— Duhet ta kapim ne punën në dorë — tha Violeta dhe ju drejtua Hanës: — Si thua ti, Hanë, që i njeh më mirë këta?

— Unë thom që këta duhen bashkue.

— Interessant!

— E keni gabim — tha Zana e nxehur. — Nuk duhet pranuar kurrë më një burrë i tillë, kushdo qoftë ai.

— Ndryshe kot që flasim për emancipimin tonë — tha Zhuljeta.

Sanija nuk tha gjë. Ajo nuk mund të bashkohej plotësisht me këtë mendim.

— Ky është një inferioritet absolut — tha Zana.

— A ka mundësi të më ndihmoni të rrokullisim këtë shkëmb? — u tha atyre një djalë i brigadave të inxhinierisë.

Ato i shkuan në ndihmë.

«Të gjithë më duen, të gjithë shqetësohen për fatin tim, mendoi Sanija. Bile edhe zihen në mes tynë për punën teme. Edhe në fshat më kanë dashë shumë njerëz. Ata që nuk më kanë dashë, kanë qenë të pakët, por lumtuninë ma shkatërruen. Si qenka e mujtun me e pësue njeriu kështu për fjalët e botës? Unë jam mundue gjithnji me qenë e pastër, me ruejtë nderin, me punue. Kur më ka propozue kush për dashuni, e kam përbuzë me neveri. Megjithatë ata që kam përbuzë më kanë ngjitur nga një grusht fjalë. Dhe fjalët e tynë për çudi janë besue. Myftarin e due prapë, se nuk ka faj. Ai më do shumë. Ja prishën mendjen nana e baba. Asht vështirë mos me u besue nanës e babës. Ata kanë qenë të nxitun nga Mehmet Rama me shokë. Ata kishin inat që unë shkoja mirë me burrin. Atje nuk duhet me të pa kush tue folë me burrin, se e kanë për marrë. Ata kishin inat që unë shkoja në mbledhje të ndryshme dhe që isha anëtare e kryesisë. Ata kishin inat, se bajsha ditë pune ma shumë se burrat. Ata kishin shumë inate. Dhe më hodhën në greminë. Kurrë nuk do ta kisha besue, se do ta detyronte kush Myfta-

rin të thoshte «E kapa gruen në flagrancë». O, si më asht dukë kur e kam ndigjue së pari herë në gjyq! Sa mirë që gjyqi bahej me dyer të mbylluna. Ashtu tha ai, po megjithatë dukej se më donte.... S'di ç'po ndodh me mue. Shoku Ylli diçka do me ba. Kot nuk më thirri mue në zyrë. Kot nuk ka shkue në gjykatë prej këtu. «— Mos u mër-zit, — më tha — do të rregullojmë diçka. Ti mendon se ai të do?».

— Po, asht e vërtetë — i thashë.

— Po qe puna kështu, do të bëjmë diçka. Ti puno, ji këmbëngulëse. Myftari në të vërtetë duket njeri i mirë. E kam vërejtur. Sidoqoftë ti mos u mër-zit. E drejta nuk do të shkelet kurrë. Rri pa merak». Kot nuk m'i tha këto fjalë shoku Ylli.

Ajo shikoi kurrizin gjigant të trasesë, që po zgjatej drejt lindjes dhe ja nguli sytë vendit, ku do të hapej tune-li. Tani atje kishte vetëm një piketë me ngjyra bardhë e kuq, por edhe pak ditë atje do të shpërthenin minat dhe malit do t'i hapej një plagë e çuditshme.

Pastaj filloi punën motokompresori dhe zhurma e tij i mbyste bisedat dhe këngët. Tani Sanija sikur mendonte më lirshëm.

— Mos u grind ma me atë studenten — i tha ajo Hanës, nëpërmes zhurmës shurdhonyëse.

Hana ju afrua më pranë për të dëgjuar qartë ç'i tha ajo.

— Mi-i-na-a! — bërtiti dikush nga larg.

— Mos luej, se s'ka punë me ne! — i tha Sanija Ha-nës. — Janë brigadat e inxhinierisë.

— As gurët nuk kanë punë me ne?

KAPITULLI I KATËRT

Dheu kishte kulluar mirë dhe vende-vende shkrifej. Kur takonte me rrezet e diellit, tehu i lopatës shndriste si të ishte prej argjendi. Kjo punë e pastër atyre u ngjallte kënaqësi. Ata ishin mërzitur nga ditët me lagështirë dhe tani punonin të gëzuar. Para tyre dredhonte një shtrat lumi që priste trasenë. Atje duhej të ngrihej një urë, prandaj hëpërhë do të ndërpritej puna dhe do të kalohej përtej, përsëri në teren shkëmbor.

Vullnetarët kaluan në anën tjetër të luginës së vogël të asaj dege të lumit dhe filluan të kafshonin fundin e kodrës. Atje tani u ngrit një kor i fuqishëm tringëllimash të lopatave e kazmave, por shpejt zëri i atij kori u mbyt nga të thirrurat e motokompresorit që me zhurmën e tij kishte pushtuar tërë luginën e lumit.

Vullnetarët po bisedonin në se mund ta mposhtnin deri në drekë atë kodrinë që kishin përpara.

— E mposhtim — tha Hana.

— Ti ja fut kot — i tha xha Nika.

Po pastaj me Hanën u bashkuan si të drojtura edhe Zyraja, edhe Gjystja me sy të mëdhenj, që fliste shumë rrallë.

— Tash ç'i foli edhe Gjystja, kena me e hapë se s'ban — tha xha Nika. — Po ju pse po flisni me kaq frikë, bre trimënesha? Po, pasha besën e burrave, e mbarojmë se s'ban, në kjo shim gjallë. Nuk dalim këndeje sot pa e marrë. Fundi i fundit unë jam ma plaku ner të gjithë. Pale! Pale!

— Jo, xha Nika, kështu nuk duam, — tha Teuta. — Puna është e mund ta napim brenda orarit.

Sokoli u tha se fjalët e shumta ishin fukarallëk, prandaj t'i jepnin punës dhe të mos druheshin fare, sepse ata nuk kishin dështuar kurrë dhe nuk do të dështonin asnjëherë në zotimet e tyre.

— Të lumtë goja, se njitash ke folë mirë për nder! — ja pat xha Nika.

Hana kishte një kazmë të rëndë, që e lodhte shumë, por i vinte zor të ankohej. Tani ajo po punonte për krah Tafë Brahimit, një plaku tjetër, i cili kishte ardhur në aksion ndryshe nga Nikë Shkreli. Ai kishte ardhur për të shoqëruar të bijën. Këtë plak e urrente Hana edhe më shumë se Fredin. I vinte plasje sidomos kur thoshte: «— Erdha se ma vunë detyrë të rinjtë.

— Me na shkue në aksion me rininë, Tafë — më tha sekretari i partisë.

— Jam plak, bre burrë — i thashë.

— Hajt, hajt, se kështu të duem». Hanës i vinte inat dhe i ndërronte çehrja, kur fliste kështu Tafa, po nuk i thoshte dot «Mos gënje», se ishte i vjetër. E kujt ja shiste ai pa? Hanës që kishte vuajtur tërë jetën nga pleq të tillë «përparimtarë»? «Nuk hyn minarja në thes», mendonte Hana. Mirëpo pse rrinte kaq i ngrysur Tafa këto ditët e fundit? Pse ai nuk bënte shaka ashtu siç kishte bërë ditët e para? Vazhdimisht, kur fliste kush me të, dukej i hutuar dhe vononte t'ja jepte përgjigjen. Ç'kishte ai njeri vallë? Mos nuk i kishte pëlqyer jeta në aksion? Hana e kishte dëgjuar t'i fliste xha Nikës me simpati për jetën në hekurudhë, për kushtet e mira të punës për vajzat. Mos i kishte folur me ironi?

— Këtu për punë të nderit janë të sigurtat — kishte thënë ai për vajzat.

Kurse xha Nika i kishte thënë: — Ti, Tafë, më duket je mrapanik, se gjithnji mendon se po të çnerohen vajzat në aksion.

— Jo, pasha zotin! — ishte betuar ai.

— Mos ma ban be zotin hiç, se atëhere nuk të besoj

aspak. Aksionet i ka qitë partia e çdo gja ç'i qet partia, asht e mirë, ka besë e ner mbrenda, prandej mos thuej asgja».

Hana ngriti kokën lart. T'i fliste apo të mos i fliste Tafës? E shikoi një herë me ngulm dhe vendosi t'i fliste. Të bëhej ç'të bëhej.

— A je pa qejf, Tafë, a?

— Jo, more, me shëndet jam mirë, po kam lanë do fëmijë të vegjël në shtëpi me atë grue e... nuk di si ma kanë hallin.

— Kujdesohet kooperativa për ta, bre Tafë — tha Hana buzëgas.

— Po, more, po, por... sadokudo mërzitem kah një fije.

— Po atëhere pse erdhe në aksion pra?

— Nuk mujta me ja prishë rinisë, o vajza e Gjokë Martin!

Ç't'i thoshte Hana? T'ja thoshte apo jo atë që mendonte ajo? Po sikur ta merrte vesh Sokoli dhe ta qorton-te? Ai do t'i thoshte me siguri «llafazane». Nuk kishte si të mos ja thosh këtë, sepse ajo po fliste shpesh vend e pa vend kohët e fundit. Megjithatë mendoj t'ja thoshte më mirë se sa të rrinte me mllef në zemër. Ajo e shikoi edhe një herë fytyrën e rrudhur në ngjyrë të dheut të Tafës dhe e pyeti:

— Pse t'u vunë vetëm ty që kishe të gjitha këto halle, Tafë?

Ai ngriti kokën nga dheu dhe e shikoi vajzën me kurrshtje.

— Më kanë dashë gjithmonë. Unë nuk ua kam prishë kurrë... Shokët e rinisë dhe të partisë... — s'dihet ç'desh të thoshte, se e la me aq.

— Sa herë e ke çue vajzën në aksion? — pyeti Hana.

— Çdo herë e kisha çue, po nuk ka dashë. Edhe kësaj here gati si me zor e kam pru — u përgjegj ai duke e parë Hanën me habi.

— Nuk asht e vërtetë — tha Hana dhe u pendua që

i foli një plaku ashtu pa takt. — Due me thanë ajo, si vajzë e re, pse të mos e pëlqente aksionin? Aksioni u pëlqen të gjitha të rejave.

— Domethanë unë po rrej, Hanë, a?

Ajo u zu ngushtë. Fytyra ngjyrë dheu e Tafës sikur u vesh nga një prazhë ndryshku dhe i ra tokës me tërsëllëm.

— Domethanë po rrejt kam, ë? Mos folë kështu, se je e bija e babës së mirë! Asht marre për ty! Gjokë Martini ka qenë burrë i mirë fort, po thuej dy jetë nuk po i ka kurrkush. Nuk asht rahat me qenë e bija e Gjokë Martinit. (Tafa nuk e dinte se Hana kishte ikur nga shtëpia)

— E paske njoftë mirë, ë?

— Oj, po kush nuk e ka njoftë Gjokë Martinin! Eh, kur shkojshim dikur në Shnjon të Hotit e dilte Gjoka te krëni me gjue. Ai ka pasë majtë gjithmonë një peticë karadakut. Megjithëse kishin dalë atëhere pushkë të mira, kishin dalë këto mavzerët e serbit, ç'i ishin aq të bukura e të mira, po Gjoka mbante gjithnji peticën e karadakut me vete. Siç thoshte ai, ajo peticë kishte pasë zar. E, siç kjeç tuj të thanë, Gjoka me atë peticë i bite shejit për-mjedis tiiik! E besa shumë bajraktarë e burra të mirë nuk mujshin me i ra nj'ashtu si ai.

— Për gjuetje shenjtit dhe për gjaqe të ka pëlqye aq fort baba ty. Paske qenë edhe ti merakli për pushkë — tha Hana.

— Ka qenë koha ashtu atëhere, bre sojnikë.

— Pse nuk ndigjon me vallëzue në mramje vajza jote? — e pyeti ajo papritmas.

— Nuk do... — tha ai dhe e shikoi atë nervoz. — Ty allahile a të ka vu kush me më spiunue, a? Pse më pvetë kështu?

— Kam të drejtë. I ke ardhë vajzës mbrapa e nuk e le me marrë frymë si dynjaja. I ke ardhë roje mbrapa e thue të ka pru rinia!

— A të asht ankue gja ajo a si asht halli yt?

— Ajo nuk guxon as me u ankue — tha Hana. —

Asht e humbun. Me qenë si ajo, kishe me ba si shoqet dhe ti të bajshe gametin mandej!

— Mos më fyej, se i thom komandantit! Nuk jam mrapanik me e pengue vajzën ashtu! Apo menon ti se të gjithë pleqtë janë mrapanikë dhe frymë e vjetër! Jo, moj vajzë, jo! Unë bile kam ba axhitacion me çue vajza të tjera në aksion.

— Si nuk u bindët se askush nuk u çnderue në aksion, xhanëm!? — ja bëri Hana, që tani ishte nervozuar më shumë. — Ju keni pa se kanë shkue shumë vajza e nuse në aksion prej anëve tona dhe nuk u korit asnjë. Asnjënes nuk ju ba shenjë. E ju prapë dyshoni se këtu vajzat bajnë magjypi!

— Si, more, me folë kështu e bija e Gjokë Martinit! Jo, more, s'ka si me qenë ti e bija e Gjokë Martinit, atij babe të ndershëm!

— Po, se asht në një palë men me ty!

— Mos më kenë ti e bija e Gjokës, ta fus shuplakë turinjve, çu pasha hatrin e zotit, gjysa të del boll!

— Ka faj Nazirja që të bindet ashtu — tha ajo dhe nuk u zgjat më në bisedë, se pa që plakut ju prish qetësia dhe fytyra i mori akoma më shumë ngjyrën e dheut.

Pastaj Hana bëri ç'bëri dhe u largua nga ai. U vendos në një vend, ku dheu ishte si i betonuar: argjil i përzier me gurë të vegjël.

— Këtu hajde me punue, shoqja komisare — i tha Teutës.

— Aaa, këtu vërtet qenka me spec — tha Teuta kur e provoi. Asaj kishin nisë t'i ktheheshin fshikëzat në kallo, po ishin akoma me limfë brenda dhe, kur fërkoheshin me bishtin e kazmës, i digjnin. Ishte keq sidomos me shuplakën e dorës së majtë. Sa shumë i therte ajo, kur kapte bishtin e lopatës apo të kazmës! Hana e kishte hetuar dhe kërkoi që ajo t'i tregonte shuplakët.

— Nuk është orar vizitash mjekësore — i tha me të tallur Teuta.

Po Hana nguli këmbë ashtu si e kishte zakon ajo, dhe më në fund Teuta u detyrua t'ja hapte shuplakët, po e porositi atë që të mos i tregonte njeriut.

Pas pak shtresa e parë e tavanit u thye dhe nisi gërmi në thellësi. Hana po punonte me qejf dhe kishte djer-sirë shumë. Herë pas here i bënte pyetje Teutës dhe më në fund i tregoi edhe për grindjen, që kishte patur me Tafën, që Teuta nuk ja priti mirë.

— Nuk bën ashtu — tha Teuta serioze. — Ne e dimë pse ka ardhë Tafa në hekurudhë, por më mirë që bëri ashtu dhe e solli të bijën se sa të mos e kishte sjellë fare. Edhe pse ka roje prapa, siç thua ti, ajo diçka përfiton. Herën tjetër Tafa nuk do t'i vihet më prapa vajzës, se po e sheh që këtu «nuk luhet horllëku» siç thoshin në fshat. Po edhe në mos e lëntë ai, Nazirja do të ikë ashtu siç ke ikur ti. Ajo nuk veçohet lehtë nga kjo jetë.

Pastaj dikush sinjalizoi për shpërthim minash dhe ato vrapuan shumë larg, se atje nuk kishte strehë.

Edhe pas shpërthimit të minave Hana punoi një copë herë pa bërë zë, pastaj u mbështet për një çast mbi bish-tin e lopatës për të kundruar perëndimin e diellit. Ky perëndim i pëlqente shumë, se i kujtonte perëndimet në fshatin e saj. Ajo nuk i vinte re ndryshimet e dukeshme në mes dy perëndimesh. E ku kishte patur kohë ajo në fshat të kundronte hollësitë e perëndimit të diellit! Nuk i kishte rënë në mend për një gjë të tillë nga hallet që e kishin pllakosur gjithmonë. Në fshatin e saj dielli humbiste pas maleve, kurse këtu skuqej e rritej shumë, dukej si një sofër e madhe prej druri të panjës. Hana e shikonte atë disk të kuq, kur pështeste kokën diku në një vend të turbullt, që nuk dukej as si tokë, as si det dhe ajo turbullirë e përpinte pastaj pak nga pak dhe disku i gjakosur nuk dukej më.

Edhe atë natë në qiell u përsërit po ai perëndim i bukur. Hana u mallëngjye. I vajti mendja te fshati, te nëna, te babai. Sado keq që ishte sjellë babai me të, ajo kishte dëshirë ta shikonte një herë. Ajo tani po e kuptonte çdo ditë e më shumë se nuk ishte i keq babai, po zakonet, errësira, helmi që kishte mbjellë dom Lazri në shpirtin e tij.

KAPITULLI I PESTË

... E dashtuna Hanë! Letrën tande e kam lexue disa herë. Ja kam lexue edhe Dilës pikë për pikë. Nuk di me e shprehë gëzimin e madh që ndjej për sukseset e mëdha që ke arritë qysh ditët e para të aksionit. Më duket sikur i jetoj edhe vetë ato çaste. (Besa unë do të vij aty në turnin tjetër edhe në qittë top baba.) Tash po të kallëzoj për disa gjana të tjera. Për fjalimin që ke majtë në qytet, e morëm vesh mbrena ditës, se kishte pasë njerëz në meeting prej katundit tonë dhe asht ndigjue edhe në radio. He, o Hanë, sa bukur ke folë në radio! Atë natë Mehmet Rama me mustaqe e çibuk të gjatë erdhi në shtëpinë tuej i ngrysun e i pezmatuem, që mos e pyet ma gjatë. Gjoka e Dila e pritën si s'ka ma mirë. I poqën kafe dhe e lutën të ulej në shilte, po nuk ndigjoi gjarpni. Atë çast ai foli me atë gjuhën e tij tanë helm si e ka pasë zakon. Vetëm të padiste ty dhe therte Gjokën kundër teje, me të vra e me të pre për turpin që kishe ba demek.

Dila rrinte dhe e ndigjonte, tuj ba kryq e tuj rrotullue rruzaret nëpër duer, tuj këqyrë herë mas here atje, ku ka pas qenë varë fugurja e Zojës së Bekueme me Jezuin, që tash nuk e sheh aty, po i asht ba zakon (ti e di se ajo e var prapë nonjherë msheftë në atë vend). Dila asnjëherë nuk flet, po ndigjon plasjen e poteres. Mehmeti vazhdon të derdhë helmin e tij: «Nikë Shkreli asht kenë nier i panamuz. Ai ashtu i ka lëshue edhe vajzat e veta; gjithkush ka qeshë me to. Gjithmonë i ka pëlqye gjanat e reja ai matuf. Gjoka kapi kryet në grusht e tha:

«Medet për mue! Drue se nuk mundem me ja dhanë ma atij burri! O zot i shenjti shën Koll, si m'u nxi ftyra tash në pleqëni! Edhe Nikë Shkreli ma ka gjakun borxh! Po më bie pika, Mehmet Rama! Boll keq asht për mue, kur të marrë vesh Gjelosh Ujka. Asht rrezik me ma lanë vajzën e mos me ma marrë as dreqi ma, raftmi pika në ballë! Dhe, me ba me e lanë ai, haje dreq se e merr kush, veç noj qorr a sakat. Le që atë do ta martoj te vorri, xhanëm! Atje ku kam çue shtatë hasma, kam me e çue edhe vajzën teme. Dila bahet me plasë dhe m'i tregon mue të tana punët fill e për pe. Mas pak ditësh erdhi letra jote. Tue ja lexue, Dila bante kryq herë mas here. Kur e morri vesh Gjoka për letrën tande, më detyroi t'ja lexojsha pikë për pikë. Pa përfundue mirë letrën, ma kapi në dorë dhe ma bani grimca.

Një natë, që qeshë edhe unë te ju, erdhi shoku Zef, sekretari i partisë. «— Më kanë thanë që je mërzitë shumë për punë të Hanës, Gjokë — i tha ai.

— Me të thanë se s'jam mërzitë, të rrej — tha Gjoka

— A pranon se ke ndonjë faj edhe ti ndaj Hanës apo i ka të gjitha ajo gabim sipas teje? Ë?

Gjoka nuk u përgjegj menjëherë, po u mendua pak me kryeulun. — Për fajet që kam unë, me më ikë ajo prej shpijet, thue ti, Zef?.

Zefi buzëqeshi. — Domethanë edhe ti je i bindun se ke faj — i tha Zefi.

— Nuk thom se s'kam faj e se s'kena pasë gabime na të vjetrit, po nuk ban me na e shpërblye kështu. Janë do punë ç'i nuk kanë si me u ba ndryshe. Fjala vjen puna e fejesës. Unë e kam fejue një herë atë dhe s'ka si kthehet mbrapsht. — Gabimi duhet kthye mbrapsht, Gjokë».

Shoku Zef ndenji shumë atë natë dhe tanë natën pati në gojë punën tande, por Gjoka nuk pranoi çka i tha ai.

Tash, Hanë, nuk po të shkruiej ma gjatë, por me kaq priti të falat e mia, që më dalin prej zembrës, që të do ty aq shumë. Të fala të ban edhe nana jote, Dila, që nuk pushon tue qa për ty. Harrova me të thanë se Gjoka nuk asht tue e rrahë fort Dilën. Ai asht ba i heshtun dhe nuk ndihet

hiç me asnjëri veç merr nj'ato dhi e del e ulet prej malit e s'dihet ç'dreqin bluen me vete. Pra edhe një herë priti të falat e mia të përzemërta.

Shoqja jote shumë e dashtun

Shaqe Pjetri.

Hana fshiu lotët. Shqiponja u mundua ta qetëson-te.

— Kjo dihej — tha Shqiponja. — Po ç'do të bëjnë ata, kur të lexojnë në gazetë për atë mbledhjen, që do të bëjmë tani!

— E-e, Mehmet Rama, he gjarpën, se ti i ngatërron punët gjithmonë!..

— Edhe po të mos ishte Mehmet Rama, Gjoka pak a shumë në atë gjëndje do të ishte. Përfytyroje atë plak, duke dëgjuar gjëra të tilla për të bijën, atë plak, që është mësuar tërë jetën me gjaqe e trimëri, atë plak, që i është helmuar jeta nga kanunet.

Hana nuk foli.

— Mua nuk më besohet se do ndodhë gjë — tha prapë Shqiponja.

— Ti kështu thue gjithnji.

— Kjo është llogjike — pastaj, për t'i larguar shoqes trishtimin, tha: — Ngrihemi e lajmë pjatat, se kushedi kur do t'i mbarojmë tërë këto.

Ato të dyja atë ditë kishin radhën e shërbimit në men-së.

— Punë e randë fort të lash pjatat-qesëndisi Hana.

Ato u ngritën dhe ja hynë punës. Njëra kapi një rresht tavoline, tjetra rreshtin tjetër dhe mblodhën lugët në një tenxhere të madhe, kurse pjatat i bënë stivë-stivë dhe i transportuan pak nga pak në lavaman. Pastaj Shqiponja filloi larjen e lugëve, kurse Hana mori një kusi ujë të ngrohtë e po lante mushamatë e tavolinave. E filloi pastrimin më parë te tavolina ku hante Sokoli.

Në fund pa se ju mblodh një piring i madh mbeturinash

dhe i hodhi në një fuçi jashtë.

— Gjoja mbarove — i tha Shqiponja.

— Jo, «gjoja», po mbarova me gjithë mend.

— Ti më duket, pastron vetëm vendin ku ha Sokoli.

— Pse po thue ashtu?

— Më duket çudi si t'u mbush mendja të marrësh një njeri të fesë tjetër. Në anën tuej kjo gjë edhe në qytet ndodh rrallë.

— Para shumë vjetësh kanë qënë martue katolikë e muslimanë në anët tona, domethanë... kjo ndodhte ma shpesh dhe nuk ishte ndonji gja kaq e çuditshme. Ma vonë, kleri erdhi tuj u ba ma përçamës e ma i egër. U banë priftnit e hoxhët që...

Ajo bisedë u zgjat aq shumë, sa kuzhinjeri e humbi durimin dhe u tha të bënin më pak muhabet e më shumë punë.

— Nuk do t'ju pranoj tjetër ditë — tha ai me të qeshur.

— Sa për në kuzhinë s'kisha dashë me ardhë hiç, po kisha radhën e shërbimit — tha Hana.

— Nuk të pëlqyeka shpirti i repartit? — pyeti kuzhinieri me faqe të fryra nga shëndeti.

— Më pëlqen kuzhina, po unë kam ardhë me punue në trase e jo në kuzhinë. Më pëlqen puna me kallaballëk — tha Hana dhe u përkul mbi pjata.

— Unë kam tetëmbëdhjetë vjet me këtë zanat.

— Prandej je majë kështu kaq fort? — qeshi Hana.

* * *

Atë pasdreke zhvillohej një ndeshje volejboli në mes vajzave të brigadës «Muho Selmani» dhe vajzave të një brigade tjetër fshatare, që mbante emrin «Reshit Bajrami». Xha Nika kishte qëndruar pranë arbitrit, që të shikonte se mos «i bante hile». Xha Nika, duke marrë pjesë përditë në stërvitje, i kishte mësuar rregullat e lojës. Hanës i fliste vazhdimisht, se nuk i pëlqente loja e saj. Ai i

shikonte tek luanin dhe grindej me to, nuk i durohej pa u folur herë pas here.

— Moj Hanë! Ma shkathët një fije! Mos rri si e mbërthyeme me gozhda. Edhe ti, Teuta, nuk po më dukesh ashtu si duhet. Tash po na mujnë. Asht turp për ne, me na mujtë — fliste xha Nika, ndërsa ndiqte lojën me vëmëndje.

Pastaj skuadra tjetër kaloi në avantazh me pikë dhe xha Nika kishte arritur në kulmin e zemërimit. Ju afrua arbitrit sikur të donte ta shqyente.

— Më duket se nuk je tuj e pa punën drejt — i tha atij i egërsuar.

— Pse, or xhajë? Përkundrazi unë po përpiqem shumë.

— Nuk di, po mue po më duket se nuk po e man mirë lojën. Vajzat e mia luejnë mirë. Si ka mundësi me ua kalue ato të tjerat këtyne ç'i luejnë kaq bukur?

— S'kam ç'të bëj. Kjo është e vërteta.

Pastaj xha Nika ju shkreh vajzave:

— Turp, vajza! Për ner nuk ju flas ma me gojë! Ë, moj Hanë, a e sheh sa bukur luejnë ato! Nuk ka faj ky shoku me bylbyl, jo. Kot po i flas. Ju keni faj, ç'i më rrini si me kenë të kapuna për tokë!

Po nuk kaloi shumë e vajzat e «Muho Selmanit» kalluan në avantazh dhe xha Nika nisi të hidhej përpjetë. Tani e kishte hequr shaminë e aksionit që e mbante zakonisht rreth qafe dhe po e tundte në ajër.

— He, jua lumsha! Edhe racionin e hallvës teme hajeni për ner, kurdo ç'i të kena hallvë.

Më në fund «vajzat e xha Nikës» fituan dhe ai u përqaftua me të gjitha, duke u rrahur shpatullat.

Si e morën veten nga ndeshja vajzat e skuadrës, Teuta filloi orën politike me brigadën e saj. Ato studjonin rregullisht historinë e partisë dhe diskutonin për probleme të ndryshme ideologjike në këtë orë, që ato e quanin ora politike.

*
* *
* * *

Po atë mbrëmje Sokoli i bëri një surprizë Hanës. I kishte blerë një fund të ri. Ishte e para herë që i bënte një dhuratë Hanës. Ajo një herë u mpi nga emocioni, ju duk sikur tani filloi me të vërtetë jeta bashkëshortore.

— Këtë fund ta bleva me rastin e prishjes së fejesës-
i tha ai. — Tash më duket se u bane imja zyrtarisht.

— Ti e le veten pa lekë... Nuk ke ku t'i marrësh le-
kët.

— Ç'më duhen lekët, moj Hanë! A nuk po kena me
hangër, a?

Ajo deshte të thoshte shumë fjalë, po vetëm qeshi.
Dhe ajo e qeshur tha më shumë se mijëra fjalë.

— Na filluem jetën përnjimen si të fejuem, po Nikës
nuk i kena kallëzue hala. Ai ka me na u hidhënue, kur ta
marrë vesh se duhena, se duem me marrë njeni-tjetrin e ai
nuk di gja. A e pe si foli në mbledhje për mue? — tha Ha-
na, duke ja mbajtur Sokolit dorën në dorën e saj.

— Atij nuk mundem me ja thanë, Hanë, po do t'ja
thona me kalimin e kohës. Nuk na hidhënohet, jo.

Pastaj Hana ja tregoi Shqiponjës fundin që i kishte
blerë Sokoli, se Shqiponja ishte në një bërthamë për punë ve-
shjesh.

Hana i tha:

— Çdo gja ç'i ka me më ble Sokoli, do ta jap ty me ma
pre e me ma rregullue, Shqipe. Hajde drejt, rrobat malcorçe
nuk jam tue i veshë ma — pastaj Hana me atë frymë hu-
mori i foli asaj se si vuanin gratë e vajzat në malësi me
veshjen e tyre të rëndë.

— Do të vij një herë andej nga ju, Hanë!

— Hajde, mirë se të vish.

— A më pranon Gjoka po të vij në shtëpinë tande,
pa?

— Kur vjen në shpi, çdo mik e pret mirë. Mikpritja
është një zakon i mirë te na. Po jo ashtu si ka qenë ajo për
nanën teme «Kur vijshin miq, tregon nana për kohën kur
ka qenë e re, rrijshim tanë natën tuj ba muhabet punë

gjaqesh e punë dreqit. Mue më mshileshin sytë në kamë. Detyrohesh me i lagë me ujë, prapë më vinte gjumë, se kisha disa net kështu pa fjetë. Atëhere e kapsha mishin me thoj, që të më dhimte fort e kjo dhimbje të mos më lente me fjetë. Munohesh me qëndrue, po Martini, vjehri, më diktonte. Kur shkojshin miqtë të nesërmen, Martini i thoshte Gjokës: «Tfy, jazëk! Me të fjetë grueja para miqve!» Atëhere Gjoka kapte shkopin e më rrihte bam e bam, derisa më lente të shtrime në dysHEME. Kur më rrihte fort, i thoshte Martini: «Hëh, tash po ma ban qejfin! Do me më ngja mue, namuztar. Kështu duhet. Me e rrahë gruen sa ma shumë, me ja shti frikën, që, kur të ndigjojë emnin, të dridhet. «Njëherë më ra të fikët prej pagjumësisë dhe, në vend që të më bajshin derman, më rrahën të dy përnjiherësh, ky dhe plaku. Kur erdha në vete, më shkonte gjak për hune e për goje prej të rrahunave...»

Shqiponjës i qenë mbushur sytë me lot, duke dëgjuar Hanën, sado që i dukeshin edhe gjëra të hiperbolizuara. Ajo nuk mund të bindej kurrsesi se mund të ndodhte me njerëzit ashtu.

— Po si do të bësh, që s'të shohin dot në fshat me veshje të lehtë?

— Me luftë.

— Edhe për veshjen luftë?

— Luftë të madhe bile.

— Ju malësoret jeni të gjitha heroina. Unë vështirësinë më të madhe në jetë e kam pasë vetëm në mësim.

— Kurse unë atë kisha me e quejtë dëfrim.

KAPITULLI I GJASHTË

Pothuaj të gjithë vullnetarët ishin grumbulluar në kinoklub. Në muret e sallës ishin vendosur shumë parulla e citate që flisnin kundër zakoneve prapanike dhe paragjytimeve fetare.

Hanës i rrahu zemra, kur mendoi se do të ngrihej të fliste para tërë këtyre njerëzve. Ajo kishte folur edhe para më shumë njerëzish, po ndryshe ishte ai fjalim e ndryshe ky. Tani ajo do të shpallte para të gjithëve një gjë aq të madhe, sa do të çonte peshë shumë gjakra. Sapo ta merrte vesh Gjelosh Ujka, do të shkonte menjëherë te Gjokë Martini dhe do t'i kërcënohej me vrasje. «O vajzën, o kokën tande për plum» do t'i thoshte. Hana shikoi edhe fotopllakatin e madh me shkrimin: «T'i djegim me zjarr zakonet prapanike». Kinoklubi ishte po ai që kishte qenë për natë, po në atë çast ai po dukej me përmasa të mëdha, me tavan shumë të lartë e me një gjerësi përballore. Atje sikur ishte mbledhur bota. Hana shikoi Tafë Brahimin, që rrinte si një re e zezë, sado që përpiquej të qeshte ndonjëherë më të rrallë. Sa keq do të ndikonte kjo mbledhje në ndërgjegjen e vajzës së tij. Kot që do të lodhej ai më pastaj ta frikësonte atë. Kot përpiquej ai të ndalonte atë që nuk mund të ndalohej. «Kësaj pune i ka ardhë koha dhe nuk nalet. Unë jam budallë që kam ardhë këtu. Në mos sot, nesër edhe vajza ime, o ka për të ikë, o ka për të marrë një burrë me vullnet. Mirë që nuk e kam fejuë vajzën, se kështu do të më bante edhe kjo. Ç'kam me ba unë? Mos do të qes pushkë e me fikë edhe fëmijët? Jo, mor vëlla!»

Ndërkaq mbledhja kishte filluar dhe xha Nika po fliste gjithë zjarr.

—... Na pleqtë kena kenë të paditun. Hoxhët e priftënit na kanë lanë në errësinë. Na ka lanë në errësinë edhe e kaluëmja me qeverinat e mrapshta e na ka lanë në errësinë kanuni..

Nika fliste e Tafë Brahimi i trembur si asnjëherë kalonte nëpër mend jetën e tij. «Besa nj'aty nuk po thue keq, o Nikë, mendonte ai. Edhe unë e kam rrahë gruen njiqind herë kot. Kur isha kryetar këshilli, erdhi njeni e m'u ankuë për gruen e unë i thashë: «— Bjeri dajak!

— Kam frikë se më padit e më kap ligji — tha ai.

— Bjeri, more shakës, se jam unë këtu qeveri e ligj! Bjeri dajak! S'ke turp me të tremë gruaja?! A do me të dhanë unë nji dajak?» Kena pasë shumë marrina na të vjetrit. Po sikur të ngrihet dikush e të thotë që Tafë Brahimi asht prapanik, se ka ardhë mas vajzës në hekurudhë? Atëherë ku due me shkue unë? Sado t'i thom unë atij që rren e shpif, nuk ban dobi. Fjala e atij do të besohet, kurse e emja jo...

... Ja, ja, po flet e bija e Gjokë Martinit! Kjo asht krejt pa turp. Kur i ka ikë vajza Gjokë Martinit, po ne të tjerëve? I përkrah partia këto, prandej ikin. E dimë që ke ikë, mori ftyrë e keqe, mori bushtërrr! Pse po i thom ashtu? A ban që ikën edhe vajza eme?»

—... Nji prej atyne vajzavet të shituna si bagëtia kam qenë edhe unë. Vetëm dhetë vjeç kam qenë, kur erdhi në shpinë tonë njëfarë Gjelosh Ujka me mustaqet vesh më vesh e i tha babës:

— E jotja asht kjo vajzë?

— Volla bash emja.

— Paske vajzë të mirë.

— Mjerë kush i ka — tha baba. — I plasun zemret gjithmonë. Me marre mas dere sa të jetë jeta.

— Paske kohën me ma dhanë mue këte vajzë — tha Gjeloshi.

Dhe baba aty për aty ju përgjegj:

— Nuk kam vajzë për ty, bre Gjelosh. Kjo asht e keqe për ty.

— Mue, qe besa po më pëlqen, pra.

— Në të pëlqeftë ty, asht punë e rahatshme, po mue më duket se nuk kam vajzë për ty.

— Volla unë e due, Gjokë.

— Na kjoftë për hajr — tha baba, pa ditë për kë më kërkoi Gjeloshi, për vete a për djalin e vet, a për ndonji tjetër. Mjafton që më kërkoi Gjelosh Ujka, ai burrë i pikasun, që nuk kishte lanë gjak pa marrë në kohën e tij...

«Hë, shakë, po a ke dashë me të marrë hatrin, a? Ke dashë me të thanë «Cilin burrë do me marrë, a?», mendonte Tafa.

—...Kur u prishën disa fejesa në fshat me vendimin e popullit, baba im nuk më lejoi të pohojsha se nuk e dojsha burrin. Ato ditë ishte ba tepër i egër e na rrihte mue edhe nanën. Unë u tregova e ligë, shumë e dobët dhe para organizatës së rinisë thashë: «E due burrin». Gabova dhe bana punë të poshtme. Këtë që ka ndodhë përherë me ne vajzat unë e quej shitje dhe... ja ku deklaroj para jush se, qysh sonte e... konsideroj të prishun — po thoshte Hana. Ajo ishte skuqur në fytyrë dhe shtati i kishte marrë zjarr. Për një çast ju fanit fytyra e Gjokës shumë e qartë dhe ju duk se grushti i tij ju vërtit rreth turinjve. Ajo gati deshte të lëvizte kokën që t'i shpëtonte goditjes, por pastaj e kuptoi që kjo qe vetëm një fanitje. Po aq qartë ajo pa edhe fytyrën e Gjelosh Ujkës, por pastaj duartrokitjet dhe thirrjet nga salla «Të lumtë, Hanë! Të ndiqet shembulli i Hanës!» bënë që të dyja ato fytyra të tërhiqeshin nga salla. Ato u përzunë nga duartrokitjet dhe thirrjet e sallës dhe Hana nuk i pa pastaj derisa u ul në vend.

Tafa ja nguli sytë dhe u dridh. Sa frikë kishte pasë se mos fliste ajo vajzë kundër tij! Tani ju duk se ju largua ca rreziku. Të tjerët nuk do ta përmendnin me emër, edhe pse të gjithë flisnin për të në të vërtetë. Ajo vajzë ja kish-te thënë në sy qysh ditët e para.

Pas mbledhjes në klub e jashtë në territor vullnetarët

prapë diskutonin. Mbledhja për ata nuk kishte mbaruar akoma. Ajo kishte mbaruar vetëm formalisht.

Për të parën herë Hana po rrinte me Sokolin vetëm për vetëm e bisedonte, duke patur edhe të tjerë njerëz rreth e rrotull.

— Më duket se u çlirova nga një barrë e randë — po thoshte Hana.

— Kjo ka qenë një barrë, që të ka ndenjë mbi shpinë për vite me radhë.

— E kisha peng pa e shfryr këtë duf. Nuk di si kam folë.

— Rreptë ke folë. Unë nuk e besojshë se do të flitshe ashtu.

— Jo, jo, Sokol! S'bahet ma keq, sido që të veprojmë tashti. Unë nuk kam frikë për asgja.

— Mirë, moj Hanë. Mue më ke gati.

— Asht puna se si me ja thanë xha Nikës.

— Ajo asht puna ma e lehtë.

— Do t'i vijë keq që nuk i kena kallëxue ma parë.

— E rregulloj unë me të.

Më tej Fredi po hahej në bisedë me një grup shokësh e shoqesh.

— Ç'na mërzhitën këto sonte! — ja bënte ai. — A thua se janë para trekëndëshit! Dreq! Unë s'kam parë asnjëherë mbledhje për prishje fejesash dhe u indinjova. Ajo Hana ka folë bukur, megjithëse me siguri e hiperbolizoi. Ashtu si tha ajo nuk bën as më i prapambeturi, as më i çmenduri, as kurrkush. Ajo nuk është e vërtetë.

— Cila nuk asht e vërtetë? — u hodh Lula.

— Se njeriu mund të shesë vajzën pa ditur fare se kujt ja jep. Të paktën të bëhej pak kurioz dhe vetëm nga kurioziteti të pyeste.

— Nuk ke faj ti. Për atë që nuk i njuh zakonet, ashtu asht. Por ajo që tha Hana asht krejt e vërtetë. Edhe motra ime që asht fejue në djep, ashtu asht fejue. Baba im ka ndenjë në burg në kohë të Zogut me një burrë, i cili i ka pëlqye babës për trimënitë e tij dhe i ka thanë: «Due me të dhanë një vajzë që më ka le tash».

— Unë nuk kam për kë me e marrë. Vetë jam i martuem, djalë nuk më ka le hala, mashkull tjetër nuk kam.

— Në qoftë se të len djalë, e merr për të, ose, në qoftë se nuk të ban grueja djalë hiç, martohu me vajzën teme dhe, me siguri, do të kesh djem. A e lamë kështu? Puna asht me u ba miq. Hajde na qoftë për hajr!» Mirë-po për fat të motrës sime, ai u vra nga gjakësit. A të duket e besueshme kjo, shoku Fredi? — e pyeti Lula atë më në fund.

— Për nder gjëra të çuditshme.

.....

Në çadër ishte fikur drita. Vullnetarët flinin. Sokoli nuk e ndezi dritën, po u zhvesh në terr. Atë natë për atë nuk do të kishte gjumë. Pikërisht kur ra i vërshuan në kujtesë shumë mendime, shumë probleme, që e preokuponin. Ai e dinte se do të martohej me Hanën, po sesi do të bëhej ajo punë, nuk e kishte të qartë. Si do të shkonte në fshatin e tij dhe do të ngrinte atje familjen me Hanën? Babai nuk e pranonte në shtëpi. Sokoli mund të jetonte kudo me Hanën, po kishte dëshirë të shkonte në fshatin e tij. Si do ta priste këtë gjë Gjokë Martini? Ku gjendej ai tani? Po i ati me vëllanë e madh që ishin shumë fetarë, ç'do të mendonin?!

KAPITULLI I SHTATË

Dielli u ngrit si me përtesë mbi kodrat kundruall dhe lëshoi afshin e ngrohtë mbi vesën e rënë nëpër fijet e barit dhe kallinjtë e misrit. Fushat furfurinin. Gumëzhimat e mbytura të një traktori vinin nga larg si rrokullisje ortiqesh dëbore. Kënga e ngatërruar e tokmakëve, kazmave e lopatave, përplasej tutje në arën e pjerrët të misrit dhe mbytej pastaj nga gurgullima e fuqishme e lumit në atë teposhtë të rrëmbyer. Rrezet e diellit prekën trasenë. Hana i hodhi sytë përreth dhe ngriti ca kapelën prej kashte, pastaj zuri të shtypte dheun me tokmak. Aty ku punonte ajo kishte qenë luginë dhe tani traseja ishte ngritur shumë lart për t'u niveluar me pjesën tjetër. Ash-tu e kishte ajo e uruar trase: diku kërkonte gjermim në tokë, diku rrafshim, diku duhej ngritur shumë lart.

Atë mëngjez vullnetarët po përpiqeshin të takonin trasenë e tyre me atë të sektorit fqinjë. E kishin vendosur këtë punë sapo kishin filluar turnin, po tani po shikonin se kishte mbetur edhe një copë e madhe për t'u punuar dhe disa po shfaqnin dyshim për këtë gjë. Hana ngulte këmbë që t'i takonin. Fredi po i thoshte se në trase nuk ishte puna si me makaronat.

— Hana i ha makaronat dhe trasenë — tha xha Nika. — Ka stomak të fortë e bija e Gjokë Martinit.

Hana mendoi të gjente një batutë, me të cilën ta mundte Fredin dhe njëkohësisht të krijonte humor.

— Më vjen keq që po e nxin dielli këtë djalin tuaj

punue në trase — tha ajo, se nuk e dinte që ata të qytetit e kishin gjë të preferuar nxirjen në diell.

Teuta tha se nuk ishte koha për shaka, kur vullnetarët ishin në atë tension dhe u tërhoqi vëmendjen disave prej tyre.

— S'kena hall pa i përpjekë trasetë sot, sido që të jetë puna — tha Hana. — A ban me punue jashtë orarit? S'po bahet gazepi! Fredi Begaj le të shkojë, se e bajmë edhe pa të.

— Do t'i sakrifikojmë të gjitha sot për hir të takimit të traseve — thanë disa njëzëri.

— Meritë do të ishte të mos sakrifikonim asnjërën nga këto — tha Teuta.

— Duhet ngritur lart traseja — thoshte tekniku, duke patur frikë se mos ata, duke nxituar, bënë punë shkel e shko.

— Në qiell do ta shpiesh, mo? — i tha Fredi teknikut.

— Mos u tall, shoko! — tha tekniku. — Në qiell ta shpiem, posi!

— Me e çue në hanë — tha Nikë Shkreli.

Vullnetarët qeshën dhe Nika i ra me bërryl Myftarit.

— Qesh edhe ti një herë, he burrë, se nuk asht shemë dynjaja! — i tha.

Myftari qeshi mekanikisht. Ai kishte shumë kohë që nuk qeshte. Në çdo kohë, natën e ditën, ai përpiqej të gjente zgjidhjen e problemit të tij që ja kishte errësuar tërë gëzimin. Tani ai e kishte kuptuar gabimin dhe e shihte që gruaja e tij kishte rënë viktimë kot së koti, po si ta kthente pllakën mbarë? Ai kishte folur shumë fjalë fyese kundër së shoqes. Si mund të ngrihej e të thoshte se ato fjalë tani nuk ishin të vërteta? Kohët e fundit ai kujton-te me mallëngjim jetën e lumtur që kishte kaluar me gruan. Si do ta mposhte sedrën e të bashkohej prapë me të? «Si u katandisa kështu unë budallai, mendoj ai me vete. Shkon një i marrë e qet një gur në ujë e shkojnë njizet të urtë e nuk munen me e nxjerrë».

— U koritëm — tha xha Nika.

Një mërmëritje shqetësuese përshkoi rreshtat e vullnetarëve.

— Asht marre me u koritë — tha pastaj xha Nika.

— Nuk koritena kurrë për të gjallë — tha Hana.

Tani të gjithë ishin të shqetësuar. As kënga nuk dëgjohej në këto minuta. Kishte mbetur fare pak kohë dhe ata kishin frikë se mos «koriteshin» me gjithë mend, ashtu siç thoshte xha Nika. Hana kishte thënë e para që do t'i bashkonin trasetë dhe tani rrinte e ngrysur e pa humor. Ajo po kujtonte se si punonin në kooperativë, si mposhtnin vështirësitë kooperativistët, si luftonin për të mbajtur zotimin, që kishin marrë përsipër. Tani ajo nuk dinte ç'të bënte. Po sikur t'i thoshin tani që ajo ishte zotuar në tym? Pa pritmas ra sinjali për lënjen e punës, se kishte ardhur edhe turni tjetër, që do të punonte po në atë vend.

— Të dalim tani — tha komandanti.

— Nuk do të dalim! — folën të gjithë njëherësh.

Nuk dolën as brigadat e institutit. Hana shikoi se mos Fredi do të kundërshtonte si e kishte zakon, po kësaj here ai nuk u ndie. E ç'do të bënte një zë i vetëm në mes të atij kolektivit të madh qindra zërash?

Në tunelin përballë buçitën minat dhe pastaj u lëshuan ushtarët dhe u grumbulluan te gryka e tij me tezga e karro. Në atë tunel punonte vetëm brigada e rinisë ushtarake.

Hana shikonte se si traseja e re po i afrohej shoqes së saj më të vjetër. Puna që po bëhej tani e mahniste. Vullnetarët nuk e ngrinin kryet nga toka. Edhe kënga kishte pushuar hëpërhë. Këngët tani vinin vetëm nga brigadat e turnit të dytë. Hana pa edhe një herë Tafë Brahimin, të cilit në atë çast i tha Nikë Shkreli:

— A po flet një herë, o Tafë Brahimi!

Tafës i shkuan mornica në trup dhe i trishtuar ngriti kokën nga toka. Pa përrreth se mos e shikonte njeri. «Ndoshta deri tash po më këqyrshin mue, po m'i danë sytë, kur panë se nreqa kurrizin. Nuk kam ven këtu jo. Duhet të iki, se nuk kam ardhë si vullnetar».

Traseja e re ju afrua fare afër së vjetrës. Në bishtin e saj ishin mbledhur dy brigada dhe punonin grumbull. Hanës, me karrocën e saj, i takoi të kalonte fare pranë Fredit, i cili ngriti kapelën dhe i hodhi asaj një romuz rreth flokëve të shkurtër dhe faqeve të skuqura. Ajo nuk foli.

— Urraaa! — bërtitën vullnetarët kur u përpoq traseja dhe Tafë Brahimit ju duk sikur të gjithë e përqeshën.

— Sonte do të bëjmë një mbrëmje të madhe vallëzimi, më të madhe se kurrë!

— Oo, për sonte e kini hallall — tha xha Nika. — Ju lumtë, rini... Jo, na lumtë ne, rinisë!

— E ndreqe shpejt, se desha të të vë fletërrufe — tha Teuta.

— Jo, nuk munesh ma me më kapë! Si thue, Tafë Brahimi?

— Ashtu, ashtu...

— Jena rini edhe na.

Pse Nikë Shkreli, kohët e fundit, i vihej kaq shumë me muhabet Tafës? A nuk tregonte kjo se Nika kishte një qëllim?

Tafa ngriti kazmën me nervozizëm, e hodhi në sup dhe mori rrugën për në sektor. Nga të shkonte që të mos e shihte njeri? Ku të futej? Nuk rrinte dot as në fillim, as në fund, as në gjysmë të rreshtit. E ku të shkonte pra? Si, xhanëm, Tafë Brahimi nuk qe i zoti ta bënte edhe këtë gjë për partinë, siç bëri shumë gjëra në jetën e tij, siç vuri në rrezik jetën sa e sa herë për të, kur ishte nevoja? A nuk ishte po ajo parti, për të cilën ai nuk kishte kursyer asgjë? Pse pra ai e uli veten kaq poshtë për të bijën? Pse nuk i besoi partisë kur ajo i tha se e kishte vajzën të sigurtë, kur i tha se hekurudha është vend edukimi e kalitjeje? Pse bënte kështu Tafë Brahimi dhe thoshte nga ana tjetër që ishte përparimtar dhe luftonte për partinë e atdheut? Mos vallë ai ishte vërtet prapanik?

Ai nuk e kuptoi se si arriti aq shpejt në sektor.

KAPITULLI I TETË

— A e kini ndi?

— Hajrli, çka ka ndodhë?

— Vajza e Gjokë Martinit shetit natë e ditë me djem të qytetit.

— Si, si?

— Mos u çuditni! Ajo shkon e lahet në lum me djem, lakuriq si e ka ba e ama.

— Allah, allah! Mos na e hiq zot marren!

— Edhe burrin e ka lanë.

— Kush, more, e ka lanë burrin?

— Nj'ajo Hana. Pse po çuditesh? Ma vështirë e ka pasë me ikë, se me prishë fejesën.

«Me gjithë men ta ketë prishë fejesën?!» mendonte Gjoka, që i dëgjonte këto biseda pas një gardhi, ku po kulloste lopën.

— Po nuk e le punën ashtu Gjokë Martini, jo!

— Kanë qenë burra ma të mirë e ma trima se Gjokë Martini, po s'kanë mujtë me e luejtë, se asht vështirë. Duhet një penë buej me e ngrehë kamzën e pushkës.

«Domethanë nuk flitka vetëm Mehmet Rama për vajzën teme. Për këtë flitka edhe katuni. Ajo paska prishë edhe fejesën. Unë s'kam pse me qenë ma gjallë me gjithë këte marre. Ç'më duhet jeta tash? Më më kallëzue të tjerët me gisht! Jo, jo, këte nuk e duroj! Kurrsesi nuk e duroj. Do ta vras vajzën! Edhe sikur të më vrasin edhe mue, do ta vras! Nuk bahet ndryshe! Unë nuk kam ma të dalun nër shokë. Paska të drejtë Mehmet Rama. Për vajzën teme flitka i gjithë katuni, flitka gjithkush më njeh mue! O

Zot!» Ai bëri kryq disa herë. E la llopën atje dhe u kthye në shtëpi. Dilës nuk i dha të kuptonte gjë. U mundua të mbante gjakftohtësi, bile deri në atë shkallë, sa Dila u habit si ai nuk ishte i ngrysur si herët e tjera.

— Due me shkue te Mrika, grue — tha ai. — Due me nejë nja dy net, se jam i mërzitë.

— Mirë, more nier...

U bë gati. Shkoi te Mehmet Rama për të marrë revolverin, që i kishte premtuar sa herë. Gjoka nuk donte të merrte pushkën me vete. Mehmeti kishte një pistoletë të fshehur qysh në kohën e luftës, por kësaj here u frikësua t'ja jepte Gjokës. Ai i kishte thënë sa herë Gjokës që të vriste, por tani po i dukej e rrezikshme. U pendua që i kishte treguar Gjokës për pistoletën. «Kryqali asht ky, tha me vete. Si mund t'i besonte ai tani një «kaurri», siç e quante ai shokun e ngushtë, Gjokën. Po sikur t'ja diktonte kush atë armë dhe të dilte pastaj se ishte e Mehmet Ramës? Por tani nuk kishte nga t'ja dilte. Nuk kishte leverdi të prishej me Gjokë Martinin, sepse ky e dinte që Mehmeti kishte armën.

— Unë po ta jap, Gjokë, por... Ti e perëndia...

— Mos ban merak, he burrë!

— E di, e di, por...

Mehmeti i tha Gjokës ta shoqëronte, siç kishin biseduar sa herë, por ky nuk pranoi.

— Mor unë nuk pata me të vu vesh, pata me të ardhë me zor, por nuk po munem, se po kam frikë mos biem në sy. Na çkallajtisi edhe gjyqi i asaj kurve.

Gjoka mori pistoletën dhe shkoi në shtëpinë e Gjelosh Ujkës, të cilit i shfaqti dyshimin se vajza kishte prishur fejesën.

— Edhe unë e kam ndigjue kyt punë, — tha Gjeloshi — por kjo nuk ka randësi. Ajo e ka prishë e na e rregullojmë. Sido që të jetë, unë due vajzën në këtë vjeshtë. E baj unë mëshqerë atë, që, besa e burrave, me më ndejë «gati-tu» si ushtare. Kështu. Po deri këtu do të ma biesh ti. Unë nuk pranoj asgja tjetër. Jena shokë e miq të ngushtë, por me u koritë nuk mundem, nuk e pranoj assesi.

Gjoka u largua edhe më i dëshpëruar, edhe më i egërsuar. Domethënë Gjeloshi nuk i tha asnjë fjalë të mirë, po ju kërcënua. Shqip i tha se do ta vriste. Tani ju bë më e qartë se nuk kishte rrugë tjetër veç të vriste vajzën. S'kishte vrarë njeri që njëzet e ca vjet më parë. Gjakësin e fundit ai e kishte vrarë tri javë para se të çlirohej Shqipëria. Dhe qysh atëhere, nuk ja kishte provuar më grykën e pushkës në një gjoks njeriu (ai gjithnjë kishte pasë qejf t'u binte gjakësve në gjoks). Pas kaq vjetësh do të vriste një femër. Oh sa gjë të turpshme e kishte patur dikur të vriste një femër! Dhe kë pa? Të bijën! Ai bëri kryq disa herë, duke ju dridhur duart nga nervozizmi dhe pastaj këndoi një lutje.

Gjoka mori udhën.

Deri në Durrës udhëtoi pa telashe, po atje e zuri nata. Deshte të flinte në stacion, po nuk e la dezhuri. Dikush i tha të shkonte në hotel, se kishte mjaft vende, dikush e ftoi të shkonte në shtëpinë e tij, po ky i falënderoi si të parin si të dytin. Gjoka mund të flinte rehat. Verës ai zakonisht nuk kërkonte vend në hotel, po flinte në fushë me një trastë nën kokë. Kështu bëri edhe atë natë në Durrës.

Të nesërmen me trenin e parë arriti në zonën e vullnetarëve. Një herë zbriti në një qytezë, shumë larg sektorit ku punonte e bija. Atje kishte mjaft vullnetarë. Ai pyeti shumë nga ata për Hanën, po asnjeri nuk dinte t'i tregonte gjë. Pastaj i hipi një kamioni dhe arriti në sektorin e së bijës.

Në qytezën ku zbriti, e pati të vështirë ta gjente vajzën, se nuk kishte guxim të pyeste, ngaqë s'desh të binte në sy. Më në fund ai i pa barakat e vullnetarëve. U suall rreth e rrotull dhe nuk pa asnjë të njohur. Pastaj diku dëgjoi krisma minash dhe këngë.

* * *

— Kë kërkon, xhaxho? — e pyeti një vullnetar.

Ai nguroi të përgjigjej. Si mund të thoshte? Ndoshta njeriu që e pyeti do të shkonte e të lajmëronte. «O zot!»

mendoj dhe deshte të bënte kryq, po u kujtua shpejt se aty nuk ishte vendi. Ai kishte dy vjet që i bënte fshehur kryqet.

— Një shok i emi ka hy me takue një djalë të tijin, po u vonue shumë — tha Gjoka me dyshim.

Tjetri nuk e pyeti më gjatë. Por kjo pyetje ishte e mjaftueshme për t'i futë tmerrin Gjokës, që e kishte mendjen gjithnjë se mos zbulohet nga ndokush.

Nisi të errej, ndërsa ai vazhonte të sillej kundruall barakave. Por aq larg sa ishte ai, nuk mund të shihte gjë. Atëhere hyri në një arë me misër. Qëndroi aty derisa u err mirë. Pastaj lëvizi. Ju afrua sektorit. I pa vullnetarët kur u rreshtuan si ushtria dhe paraqitën forcën. Dëgjoi edhe Sokol Shabanin duke komanduar: «Kompania, gati-tu! Në qendër ndero!» Të tjerat nuk i mori vesh. Pastaj dalloj edhe Nikë Shkrelin dhe Tafë Brahimin. Tafa rrinte në fund të rreshtit, kurse Nika kishte qëndruar andej nga fillimi. Po Hana nuk po dukej kund. Gjoka mendoj se ajo mund të kishte dalë me djem misërishtave. Po pse nuk po shihte asnjëri duke shëtitur natën, ashtu siç i kishin thënë? As në prozhëm as në misër. «Tash po dalin ma vonë, mendoj ai me vete. Patjetër kanë me dalë. Tanë këto vajza si pela të hazdisuna nuk mund të rrinë pa dalë këtyne kodrave me u hargalisë me djem».

Gjoka priste. Vullnetarët u shpërndanë rreshta-rreshta. Po shkonin në mensë. Ai dëgjoi bile edhe komandën që u dha për në mensë. Tani ata po i kalonin jo shumë larg dhe ai po shikonte shumë fytyra të njohura. Më në fund pa edhe Hanën dhe sepse ndjeu një të rrëqethur. Pse rrëqet-hej ai që nuk ishte rreqethur kurrë në kesi rastesh? Pse tani para së bijës? E bija ishte midis vajzash dhe jo midis djemve, siç kishte menduar ai. Tani Gjokës i kishte ardhur ora për të bërë kërdrinë. Ishte rasti më i volitshëm për të qëlluar...

Gjoka ndenji deri para agimit në atë vend. Atëhere hyri në një misër dhe u mundua të flinte, po ishte tepër ftohtë jashtë për gjumë. Po edhe sikur të ishte në dyshek, ai atë natë nuk do të flinte.

Të nesërmen u largua ca, që të mos binte në sy. Pa vullnetarët që lëviznin nëpër sektor, që bënë gjimnastikë, që u lanë dhe u rreshtuan prapë si ushtarët, ngritën flamurin dhe shkuan në mensë. Pastaj me vegla pune në krah shkuan për në trase. Gjoka nuk pati guxim të shfaqej tani në dritë të ditës dhe nuk pati guxim të kërkonte as vajzën, as Nikë Shkrelin. Ai shkoi prapë në pyllin ku kishte ndenjur një ditë më parë, po pastaj u pendua dhe mësyu drejt qytetit. «Atje nuk bie në sy, mendoi. Kurse në pyll, mund të më gjejë dikush dhe do të më kapë si nieri të dyshimtë. Mue nuk më njeh askush. Do të iki, i erdhi një mendim papritmas. Këtu nuk mund të baj gja. Kanë me ardhë atje e kanë me më gjetë. Pa ja marrë shpirtin vajzës seme nuk e la. Atje kam me e ba kërdinë ma mirë. Tash po shkoj...»

KAPITULLI I NËNTË

Retë qëndronin të ngritura lart dhe lëviznin me ngathësi në kupën e qiellit. Ngado ndjehej lagështira dhe aroma e këndshme e shiut, që sapo kishte pushuar. Ngaqë ishte vrerët, dukej sikur zgjimi ishte bërë më herët nga ditët e tjera. Sokolit i digjnin sytë dhe i rëndonte koka. Kishte fjetur fare pak. Sapo kishte rënë, kishte filluar ai shiu i rrëmbyeshëm, që nuk e kishte mbajtur as çadra. Ujin e kishte futur edhe vija që kishin hapur rreth çadrës. Shiu kishte qenë shumë i fortë.

— Mirë e pësuar — i tha Hana Sokolit, kur ky ju ankua. — Pse nuk keni hapë një kanal të thellë?

— Nji shi kaq të madh nuk e kena parashikue.

— Unë jua kam qa hallin mbramë.

Retë qëndronin gjithnjë lart. Komandanti i sektorit një herë tha që të mos shkonin në trase, sepse kishte shumë lagështirë, po disa vullnetarë u zotuan për të punuar edhe ashtu. Plasën diskutimet. Më në fund thujse të gjithë qenë të mendimit se atë ditë mund të punohej. Dhe komandanti nuk ua prishi brigadave dëshirën për të shkuar në punë. Ato u nisën si zakonisht me këngë. Në trase kishte shumë baltë dhe karrot nuk lëviznin fare. Si do ta zgjidhnin këtë problem? Si mund të transportohej tërë ai dhe, ajo baltë e ngjeshur, që kur të ngjitej këmbëve, ishte zor ta shqisje? Tezga kishin fare pak. Atëhere vendosën të shkonin në kooperativën bujqësore fqinjë dhe pas pak grumbulluan shumë tezga. Ata kishin lidhur aleancë të fortë me kooperativën bujqësore. Kur kishte fusha-

të kooperativa, ata i shkonin vullnetarisht dhe i bënëin aq punë sa kooperativa nuk do ta bënte për shumë kohë.

Hana kishte shpërvjelur pantallonat deri në gju dhe ishte zbathur. Ajo punonte në heshtje, duke sjellë në mend ngjarjet e atyre ditëve dhe përpiquej të imagjinonte të ardhmen.

Atë dikush e qëllloi me një copëz dheu. Kur ktheu kokën nga ata të brigadës «Qemal Stafa», pa se Shqiponja po qeshte dhe e kuptoi se ajo e kishte qëlluar. Kjo qeshi dhe i tha se do t'ja paguante gjakun. Hana pa se si Shqiponja i pështynte shuplakat e duarve që të mos i rrëshqiste bishti i lopatës në lëkurën e bërë kallo. Kjo e kishte zët atë fërkimin e bishtit të lëmuar të lopatës me kallot e thara të duarve. Po tani e kishte punën mirë, se nuk i dhembnin më shuplakët e duarve. Po dhëmbjet në bel nuk po i largoheshin akoma dhe ato e pengonin të punonte aq sa dëshironte. Ajo ju ankua Hanës për belin.

— Me djersitë ma shumë — i tha Hana me të qeshur.

— Asgjë nuk kursej, moj Hanë, po kaq jap unë në punë fizike.

— Po t'i biesh ma me gjak të nxehtë, nep ma shumë. E di unë. Për këtë punë ma mirë se unë nuk di askush — qeshi ajo.

Shpatit të kodrës u derdhën rrezet e diellit. Retë u fshinë nga tavani qiellor dhe u bënë grumbuj-grumbuj anash horizontit. Dielli i ngrohtë po e avullonte tokën e qullët. Arat e misrit merrnin frymë të gëzuara. Atyre u pëlqente lagështira dhe nuk donin të dinin fare se traseja nuk donte shi. Tani puna ishte bërë e vështirë jashtë masës. Duke u shkelur, dheu bëhej gjithnjë e më i ngjeshur, më i vështirë për t'u punuar. Hana i tha komandantit se nuk e kishte bërë mirë ndarjen e forcave të punës, sepse ishin futur shumë në tezga e pak në mbushje, ku kishte aq nevojë. Ato që ishin me tezga mund të merrnin lopatat dhe ta bënëin vetë mbushjen.

— Fjala e Hanës asht me vend — tha xha Nika. — Pa kapni lopata nji herë! Hopa! Ashtu de!

— Brigada juaj ka shumë tezga — tha Zana, që po

vinte me një lopatë në sup. — Sokoli na ka lënë pa gjë ne brigadave të tjera. Ne kemi dy herë më pak nga ju.

— Kam edhe një vërejtje, shoku komandant i kompanisë — tha Hana.

— Moj, po nuk na le rahat me ato vërejtjet e tua, — i tha Sokoli serioz, por me një të qeshur të brendshëm. — Hë, bane atë vërejtje!

— Shokëve të «Qemal Stafës» mendoj me u dhanë do tezga.

— Dakord, ke ma?

— Mos u tall! — i tha xha Nika, Sokolit. — Kjo po thotë mirë boll.

Grumbujt e reve që kishin qëndruar anëve të horizontit, prapë nisën të mblidheshin.

Hana i hodhi një sy territorit të punës rreth trasesë. Sa shumë ngjeshje dheu nga këmbët e vullnetarëve! Përmes baltës dhe ujit, përmes llokoçitjeve të këmbëve, traseja zgjatej drejt kodrës. Hana po mendonte për punën e madhe që do të duhej për të hapur kodrën dhe, për një çast, sikur ju duk e pamundshme, po pastaj, kur kujtonte se sa gjëra ishin bërë ato ditë, që asaj në fillim i qenë dukur të pamundshme, ndërronte mendim. Sa tonelata dhe duheshin të përmbyseshin në luginë nga krahët e vullnetarëve! Por Hana nuk kishte pse të dyshonte. Ajo rini që kishte bërë ato punë, do të bënte atë dhe shumë të tjera më të mëdha.

Papritmas një kamxhik zjarri rrahu retë dhe mbësh-teti kokën në arën me misër kundruall tyre. Pas saj shpërtheu edhe një gjëmim dhe Shqiponja kërceu lart si ta therte diçka në brinjë. Asaj nuk i kujtohej të kishte qenë asnjëherë kaq afër bubullimave, ashtu siç nuk i kujtohej të kishte ndenjtur ndonjëherë në shi ashtu pa ombrellë. Majat e flokëve ja përcillnin ujin në qafë dhe ajo ndjente një rrëqethje të padurueshme. Për drejt e kishte lënë edhe kapelën e kashtës në kapanon atë ditë. Ajo mbase do t'ja priste ca shiun. Kështu si që lagur, Shqiponja nuk mund të mos kujtonte shqetësimet e thella

të babait për shëndetin e saj. Sa herë e kishte porositur ai që të mos lagej në shi, qoftë edhe në gusht.

Një turr shiu i dendur zuri ta rrihte tokën. Pikat ishin aq të mëdha e të rrëmbyeshme, sa vullnetarët mbetën si të ngrirë. Shqiponja u tmerrua. Pastaj vullnetarët ja dhanë vrapit me lopatat e plaçkat, që i kishin lënë në breg. Shiu shtohet dhe e rrihte tokën me tërbim. Horizonti u bë tym. Vullnetarët vraponin më kot për t'ju larguar shiut. Disa qeshnin me të madhe e këpusnin qyfyre. Befas shpërtheu edhe një erë e vrullshme dhe gjendja u bë vërtet shqetësuese. Shqiponja ishte e bindur se kjo e lagur do t'u kushton-te shumë rëndë atyre që qeshnin. «Shumë nga ata do t'i bartte pas pak autoambulanca», mendonte ajo. Hana shikoi se si i qenë varur dhe ngjitur pas koke Shqiponjës flokët dhe si i rridhnin currila nga të gjitha anët e trupit. Ju duk si ajo vajza në filmin, që kishte parë para pak ditësh. Hana u mundua ta qetësonte Shqiponjën, duke i treguar se ç'kishte hequr ajo dikur malit, sa herë ishte lagur edhe në janar ashtu.

Pas pak shiu pushoi dhe vullnetarët arritën në sektor. Shqiponjës i kërcente trupi përpjetë nga të dridhurat dhe filloi të mendonte se me të vërtetë mund të plevitosej. U zhvesh shpejt, u fshi mirë e mirë dhe u vesh me rroba të thata. Pastaj u fut nën batanije duke mbuluar edhe kokën. Trupi i dridhej si në ethe dhe dhëmbët i kërcisnin. Po nuk vonoi shumë që të ngrohej. Vajzat e tjera ndërronin rrobat dhe qeshnin me të madhe. Secila tregonte nga një episod për furtunën; njëra hiperbolizonte, tjetra dramatizonte në mënyrën e të treguarit; njëra i kishte hipur maqinës me zor, tjetra ishte hutuar nga shiu në mes të rrugës dhe për pak e kishte shtypur maqina; një tjetër kishte vënë gazeta mbi kokë për t'u mbrojtur nga rrebeshi i shiut. Për të tëra këto gjëra ato qeshnin e gajaseshin.

Jashtë kishte rënë dielli dhe toka po avullonte me shpejtësi.

Pasdite vullnetarët vendosën të shkonin në trase për të plotësuar punën e paradrekes, por Fredi po kundërshtonte.

— Nuk u bë qameti se na mbeti akoma norma pa rea-

lizuar një ditë — thoshte ai. — Shokët e shtabit thonë të rrimë, kurse ju dilni më të krishterë se papa.

— Ti, Fredi, edhe mund të kthehesh.

— Të kthehem e të më vini ju fletërrufe! Të bëni pastaj edhe një mbledhje për mua! Jo, ore, jo, këtë nuk e ha unë!

Kur arritën në trase, panë se gropat anash saj ishin mbushur me ujë. Një copë herë ata vështruan se ç'mund të punonin, po pastaj tekniku u tha të merrnin veglat e punës dhe t'i vërsuleshin kodrës, ta çanin atë sipas disa piketave që ishin vënë më parë. Vullnetarët u pajisën me kazma, lopata, karro, qysqi, baromina e vare dhe pastaj u rrafshuan rreth kodrës. Rrebeshit të madh të natyrës, që kishte provuar ajo kodër paradite, ja zuri vendin një rrebesh më i tmerrshëm akoma. Rrebeshet e mëparshme e kishin gërryer dalëngadalë dhe pa u kuptuar, kurse ky do të bënte diçka më shumë.

Edhe pse kishte rënë tërë ai shi, dheu i kodrës nuk ngjeshej aq shumë pas gjuhës së lopatës. Kjo punë i pëlqeu ca më shumë Fredit dhe ai nuk e ndjeu atë mërzinë që priste të ndjente, kur u nis nga kapanoni. Me goditjet e para kazma nisi ta ngrohte dhe filluan t'i buçisnin djersët. Atëhere u kujtua të hiqte xhupin e hollë.

Shqiponja po shikonte Fredin tek hiqte xhupin dhe sesi i erdhi, kur kujtoi skenën e paraditës. Ajo kishte qenë një provë, që e kishte bërë qesharake. Shokët do të qeshnin për ditë me radhë, duke kujtuar Shqiponjën e trembur nga furtuna. Vetëm tani ajo u bind se asnjëri nuk ishte në rrezik për t'u ftohur dhe se njeriu në përgjithësi nuk ishte aq delikat sa ç'i kishte thënë i ati.

— Pa-paaa! — i bërtiste kazmës xha Nika.

Shqiponjës i kishte qëlluar të gërmonte dhe të ngjeshur e nuk i ngulej kazma mirë në tokë. Ajo i mëshoi disa herë me mundim dhe u djersit. Pastaj u kujtua se duhej të kruhej tehu i kazmës. Ngriti kokën e saj lart dhe e kroi me një copë dru.

— Pse qesh? — e pyeti Zana.

— Po qesh me mendimet e mia.

— Mirë e ke. Më mirë të qeshësh me mendt e tua se të të tjerëve.

— Unë nuk qesh ndonjëherë me mendimet e të tjerëve.

Pas pak, në mënyrë të papritur, maja e kazmës i ndeshi në një gur. Kazma lëshoi një krismë rrëqethëse dhe i ra asaj në shpinë të këmbës. Shqiponja ndjeu një të therur të fortë dhe u tërhoq mënjanë duke rrudhur fytyrën. Përnjëherësh gjaku i vërshoi nga shpina e këmbës si ta kishin prerë me thikë dhe ajo zuri të kafshonte buzën e të rrudhej në fytyrë. Vullnetarët u alarmuan. Ata ishin larg dhe atje nuk vinte as autoambulanca, edhe sikur ta kërkonin urgjent. Dikush tha ta vinin në tezgë.

Ata gjetën një tezgë të madhe, e vunë mbi të dhe u nisën drejt sektorit, ku ishte qendra shëndetësore.

KAPITULLI I DHJETË

Çështja e Sanijes nuk i linte të qetë vullnetarët. Ata punonin, korrnin suksese, ecnin përpara duke ua dalë të gjitha punëve, sado të vështira që të ishin, por çështja e Sanijes mbetej e pazgjidhur akoma.

— Gjithkush e di se ti e ke nda gruen pa të drejtë — i tha xha Nika një ditë, ndërsa ishin duke punuar në trase. Myftar, a i ke pa cilët ke dëshmitarë. A ja u di qëllimet atyne?

— Mirë, mor Nikë, se po rrejtkan të tanë, po nana e baba?

— Nana e baba? Hë, nana e baba! — ai shtriu fort gishtin tregues. — Nana e baba n'ashtu si unë dikur, ç'i nuk dojshe me e pranue vajzën allafranga. U detyrue bija eme me vu rubën e me veshë çorapët, sa neji në shpi pushimeve të verës aso here. Kështu bajnë edhe prind e tu. Sanija ka kenë e zonja me të tana punët dhe atyne u ka ardhë plasje.

— Që kur kam ardhur në fshatin tuaj — u hodh Teuta — ti Myftar dhe Sanija më keni rënë në sy si një çift që keni patur harmoni. Është për t'u çuditur se si pikërisht ju ratë në këto pozita! Kur gruaja rrëshqet kaq sa thua ti, patjetër do të shihet prej të tjerëve. E Sanija ka rënë vetëm në sy të ca pleqve. Ti e ke parë vetë se si koha i hodhi poshtë shpifjet dhe shpifësit e po i hedh gjithnjë. A nuk po e sheh fytyrën e Mehmet Ramës? Atij vërtet i është hequr titulli i kulakut, por, po t'i gjejë ditën, i vë thikën partisë. Di të gjuajë ai gjarpër! Po nuk do ta lëmë ashtu shumë. Punën e tij do ta shohësh më vonë dhe do të të vijë turp që e ke shkruar dëshmitar.

Myftari kishte rënë në mendime. Kur ja kishte hyrë punës në fillim, nuk ja kishte marrë mendja se çështja e tij do të arrinte të diskutohej në atë mënyrë nga të gjithë. Shumë nga këto fytyra nuk i kishte njohur para ca ditësh dhe tani e këshillonin se ç'duhej të bënte me gruan! Më mirë e donin këta se sa nëna e babai apo shokët e afërm? Ai i shikonte ato fytyra dhe nuk dinte ç'të thoshte, se, ashtu si e këshillonin ato, nuk mund të vepronte. Ai e kishte ndarë gruan dhe nuk kishte si ta merrte më, sidoqë të ishte ajo.

Xha Nika e shikonte Myftarin pandërprerje dhe picërronte sytë në mënyrë kërcënuese. Tani po mendonte se si duhej t'ja thoshte fjalët atij njeriu. E ndjente mirë dramën e Myftarit, se e dinte ç'do të thoshte sedër malësori. Ai i kishte provuar vetë këto gjëra. Ndryshe flisnin ato vajzat, që kujtonin se Myftari, kur të merrte vesh të vërtetën, s'kishte pse të mos bënte autokritikë. Jo, jo, Myftari e kishte kryer aktin dhe mirë apo keq do t'i përmbahej, se kështu e donte namuzi, kështu e donte opinioni prapanik, brenda të cilit jetonte ai. Xha Nika e dinte mirë këtë, ndaj edhe nuk e shante Myftarin.

— Mendohu edhe një herë!.. — i tha Teuta.

— Unë kam kenë ma i vjetër se ti, unë kam qitë edhe pushkë, jam vra për gjaqe dhe, kur ka ardhë puna, e kam thye namuzin — tha Nika. — Vështirë e kam pasë, por e kam thye. Ti je i ri dhe e ke ma rahat.

Myftari nuk bëzante. Shikonte fushën e madhe të misrit, që gjelbëronte në tokën e ngopur me ujë. Një tufë zogjsh u trembën dhe ai e largoi vështrimin nga ata dhe e ndaloi mbi trase.

Shokët u shpërndanë në punë dhe ai i mëshoi lopatës më me forcë. Po dheu ishte shumë i lagur dhe i ngjishej asaj. Ai e kruante dhe vetëm një herë e ngulte me atë të kruar që i bënte. Tërë vullnetarët ankoheshin për këtë gjë, po nuk kishin ç'të bënin. Duhej patjetër të bëhej ajo punë dhe ata nuk mund të prisnin ditët me diell, kur dheu do të thahej, do të shkrifej e do të binte copë nga lopata pa ju ngjitur asgjë tehut të saj të ndritshëm. Fredi po an-

kohej më tej për këtë punë të vështirë dhe bënte propozim të dilnin, se nuk bëhej qameti, pasi toka do të kullonte shpejt, siç thoshte ai. Po nuk ja vinte kush veshin. Bile Zana i tha që, po të mos i pëlqente puna, mund edhe të dilte. Myftari kruante lopatën dhe ja përcillte Hanës atë kruese që e kishte bërë me një copë teneqeje.

Atë e shqetësonte tani vetëm një mendim që s'i shqitej nga koka: «Të pajtohem a të mos pajtohem me gruen», mendoi me vete dhe i mëshoi lopatës.

* * *

Atë të djelë ata po punonin në ndihmë të fshatit fqinjë në prashitje misri. Shqiponja akoma nuk ishte në gjendje për punë, por kishte ardhur me shokët në arë nga dëshira për të mos qëndruar larg tyre. Edhe pse nuk ishte në gjendje pune, ajo rrallonte bimët e misrit dhe mendonte. Ajo kujtoi se si, kur u plagos, para pak ditësh, Hana u kujdesua për të aq shumë. Pastaj ajo kujtoi të tëra përkujdesjet e vullnetarëve: si shqetësoheshin, si vinin dhe e takonin e i sillnin peshqeshe nga më të ndryshmet. Për pak ditë asaj ju bënë aq fruta e ëmbëlsira, sa nuk dinte ç't'i bënte. Edhe vajzat e brigadave të tjera, bile edhe ato, me të cilat nuk kishte folur ndonjëherë, i vinin te koka e krevatit me peshqeshe. Kurse djemtë vinin ca më të drojtur dhe më pak hynin në kaponon. Ata pyesnin zakonisht nga dera dhe largoheshin.

— Sot do të këndojmë shumë — i tha Hana, kur ju afrua duke prashitur. Shqiponja pyeti pse do të këndonin shumë atë ditë dhe Hana i spjegoi se si në korrje e në prashitje mund të këndohej shumë, se këto lloj punësh nuk i pengonte kënga. Ajo i tregoi se në malësi kishte këngë të posaçme, që këndohehin në korrje e prashitje.

— Ti, Shqipe, më duket nuk ke ba këso punësh kurrë — tha Hana.

— Kam punuar vetëm në mbledhje kallinjsh, kur shkoni me shkollën në ndihmë të fshatit, po kjo ka qenë

fare pak dhe për kaq nuk mund të them se kam bërë punë fizike.

Hana qeshi me të madhe. Ajo e kishte të zorshme ta perceptonte njeriun jashtë punës në arë. Ngriti kokën dhe pa si prashisnin studentët. Nuk i pëlqeu rrallimi që bënin ata dhe u spjegoi se si duhej rralluar në të vërtetë misri. Studentët përpiqeshin ta imitonin, po prapë nuk ja arrinin ta rrallonin si Hana.

— A po na e merr një këngë, o Nikë Shkreli! — ja bëri Teuta nga një lehë tjetër.

— Ç'ka me kënuë, thue ti? — pyeti Nika.

— Çfarë të duash.

Sakaq xha Nika filloi:

*Korr e herr zyzeza në arë
me dy drapëna për nën dorë*

Pastaj ndërpreu këngën dhe bërtiti:

— Hej, ku je drapën, he u bafsh gjarpën! U bafsh ku-
laç e hangsh kë daç! Pa-pa-pa! Ç'po e ka, more, ç'po e ka!
— Pastaj e ndreqi, sepse kjo nuk ishte korrje — Eej, ku
je shato, he të raftë çeliku!

Studentët qeshën sa oshëtiu lugina. Xha Nika me zërin e tij të çjerrë vazhdoi të këndonte dhe me të u bashkuan shumë zëra vullnetarësh, që e dinin këngën. Ishte një këngë e bukur, një melodi e shtruar dhe e zgjatur, që nuk cënohej aspak nga lëvizjet, që bënin këngëtarët gjatë punës.

Kur mbaroi këngën, xha Nika u kujtua të pyeste për Fredin, që nuk po ja kapte syri askund në atë arë të madhe. Studentët i thanë se ai kishte ikur s'dihej se ku.

— Pastë faqen e zezë! — ja bëri i zemëruar xha Nika.

Rrezet e diellit ishin përvëluese. Afshi i tyre dridhej mbi sipërfaqen e arës me misër. Djersët e vullnetarëve i përpinte toka me etje edhe pse kishte rënë shi dy ditë më parë. Tani toka nuk kishte të ngopur kurrë me ujë. Dielli ja shtrydhte poret tokës dhe ajo nuk e mbante dot lagësh-

tirën për vete. Aty-këtu bima e misrit ishte rritur jashtë masës dhe ishte e pamundur të mos i priste keq edhe dora më e stërvitur. Kooperativa kishte shumë misër dhe nuk i qe dhënë mundësi ta prashiste atë në kohën e duhur. Ndaj edhe kishin thirrur në ndihmë vullnetarët e hekurudhës.

Xha Nika filloi edhe një këngë të re, po u ndoq nga pak zëra. Tani ishin lodhur dhe nuk këndonin ashtu lehtë si në fillim.

— A ju kujtohet dita e parë e punës këtu? — pyeti shoqet Violeta Çukeli. A ju kujtohet si na ishin bërë duart të kuqe me fshikëza të bardha?

— Ua, ç'po na thua ti Violeta numër një! — ja bëri Lulëzimi. — Është zor t'ju kujtohet dita e parë, se kanë kaluar tërë këto vite.

— Ti ke dëshirë t'ja shposh bisedën gjithkujt — tha ajo dhe uli kurrizin.

Tani ata e kishin përfunduar rreshtin e madh të misrit dhe dolën në bregun tjetër.

— Nuk shkon puna pa Fredin — tha njëra nga vajzat me të tallur.

— Sonte unë do t'i këput një fletërrufe të madhe — tha Lulëzimi serioz. — Ai na njollosoi dhe nuk do ta përkëdhelim më kështu.

— Ti që e ke shok?!

— Kjo nuk më pengon aspak. Do ta vë me shpatulla për muri.

— I kemi vënë edhe të tjera herë fletërrufe.

— Por nuk e kemi kapur seriozisht. Nuk e kemi futur në derë tamam.

— Kur i thamë se do të shkonim në punë vullnetarë, më tha: «Në punë vullnetare kam qenë për ditë. Vullnetar kam ardhur në hekurudhë. Më thoni më mirë «eja në punë ultravullnetare»

Disa studentë qeshën:

— Kjo nuk është për të qeshur.

Deri në atë çast kishte fryrë një fllad shumë i lehtë, që i kishte freskuar ca, kurse tani edhe ai fllad kishte pushuar dhe ara ishte bërë kazan i valë.

— Po tani ka ardhur koha të mbajmë qëndrim ndaj Fredit — tha Zana.

Ata diskutuan një copë herë rreth atij problemi dhe të gjithë ishin të mendimit se duhej mbajtur qëndrim ndaj Fredit.

— A ju kujtohet ajo vajza e brigadës «Muho Selmani»? — tha Violeta Çukeli.

— Pusho, Violeta! Na mërzite me ato kujtimet e tua!

— Vazhdo, vazhdo, Leta, si ishte puna me atë vajzën?

— E kisha fjalën për atë vajzën që deshte të mos i priste rrugën xha Nikës, në mënyrë që atij të mos i bëhej dita ters.

— Gjëra të tilla nuk harrohen lehtë — tha Zana.

— Kjo është shumë interesante — tha Shqiponja. — Në malësi femra quhet ters, prandaj nuk bën t'ja presë rrugën mashkullit.

— A e thotë kanuni që femra të mos ja presë rrugën mashkullit?

— S'ka rëndësi. Mjafton që zbatohet me fanatizëm. Ka shumë zakone që nuk janë shkruar, po...

— E tmerrshme është edhe puna e asaj vajzës që thotë se e do plakun, që i kanë dhënë prindërit për burrë. Kjo më duket shprehja më e koncentruar e inferioritetit të femrës ndaj psikologjisë shtypëse të kanunit për gruan malësore — tha Violeta Çukeli duke zgjatur grushtin për të treguar më shumë zemërimin e saj.

— Sakrifikimi i jetës për hir të dëshirave të prindërve. Kjo është e tmerrshme vërtet.

— Ne nuk duhet të pranojmë që ajo vajza të thotë «e dua burrin». Po nuk bëmë që të prishet ajo fejesë, nuk kemi bërë asgjë — tha Zana me një ton eprorjeje.

— U kthye ara e misrit në mbledhje — tha me të qeshur njëra nga vajzat e tjera.

— S'ka gjë. Pse të bëjmë një mbledhje, kur edhe këtu mund të diskutojmë për këtë problem? Duhet të punojmë më shumë për emancipimin e këtyre malësoreve — tha Zana dhe ngriti shatin lart.

— Ç'mund të bëjmë ne, kur vajza vetë nuk do të prishë fejesën, Zana?

— Ne duhet të bëjmë që asaj t'i largohet frika. Duhet të bëjmë që edhe ajo të ketë ëndrrat e veta dhe të mos presë vendimin e prindërve për jetën e saj.

— Ajo vajzë është e shëmtuar dhe ka frikë se nuk e merr kush më.

— Kjo është lojë fjalësh.

— Kjo është komedi.

— A ju kujtohet Shqiponja ditët e para të aksionit si nuk e realizonte normën asnjëherë? — ndërroi bisedë papritmas Violeta Çukeli.

— Barku të preftë me gjithë këto kujtimet e tua!

— Kur të shkojë Shqiponja në shtëpi, nuk ka për të gjetur gjallë babain e saj — vazhdoi «gjigantja e trasesë».

— Mos u tall me baballarët. Ti edhe për Tafën thua se i përngjet atij plakut të filmit «Përse bie kjo daulle?»

— Eee, ku je shato, he të raftë çeliku! — ja bëri xha Nika.

— Ky është plak simpatik — ja bëri Violeta Çukeli.

— Mos ke rënë në dashuri me të?

— Ai i kishte në qejf vajzat e shëndosha. Në malësi një nga kushtet për t'u konsideruar femra e bukur, është të jesh e shëndoshë. Prandaj ti do t'i pëlqesh xha Nikës. Ti i përgjigjesh gustos së tij.

— Mund edhe ta dashuroj, po mos ma prishni ju dashurinë duke thënë se është plak. Nuk më lëni të martohem me të.

Studentët qeshën. Tani rrezet e diellit digjnin më shumë dhe djersët i thithte më me afsh dheu i zhuritur.

KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Atë mbrëmje ata ishin lodhur shumë, sa nga puna e madhe në trase, aq edhe nga mbledhja e gjatë, ku Fredi kishte bërë një autokritikë të singertë pas fletërrufesë dhe kritikave të shokëve, po ku edhe Tafë Brahimi, më në fund, kishte treguar hapur qëllimin e mbrapësht që e kishin shtyrë të vinte «vullnetar» pas së bijës. Tani ata po rrinin të lirë nëpër territorin e sektorit dhe po diskutonin herë për Fredin, herë për Tafë Brahimin. Po papritmas, midis diskutimeve, hyri lajmi i padëshiruar i difektit të betonierës. Ky lajm u hap me një shpejtësi të rrufeshme si një lajm sulmi në një fushim ushtarak dhe vullnetarët u mblodhën kokë më kokë që të bisedonin se ç'duhej bërë. Të mos funksiononte betoniera, do të thoshte të mbetej në vend ura. Duhej zëvendësuar puna e betonierës. Dhe kjo punë tani s'mund të bëhej ndryshe, veçse me krahë. Të gjithë vullnetarët ishin të atij mendimi, pa u bërë akoma thirrje ndokush. Ylli që kishte ardhur në sektor për të marrë pjesë në mbledhjen e kolektivit, e pyeti xha Nikën se ç'mendonte dhe atij i erdhi mirë që po i merrej mendimi.

— Ç'ka thonë këta të ri, more shoku Ylli, se unë e kam rahat — tha ai. — Punë e mirë kishte me kenë mos me u pezullue puna në atë urë, thom unë, se inxhinierët po thonë ç'i ajo urë ka shumë randësi.

— Po shkojmë! — tha Tafa, të cilit tani po i dukej vetja i çliruar ngaqë kishte bërë autokritikën.

Edhe një pjesë e vullnetarëve të turnit të parë, që sa-

po e kishin mbaruar punën, me këngë në gojë, u nisën për të punuar sërishmi. Difekti i betonierës nuk pyeste se kush kishte punuar e kush jo.

Kur arritën tek ura, ata gjetën teknikun me dy shokë të tjerë, që po bisedonin rreth punës që duhej bërë. Vullnetarët pinë edhe një herë ujë me pagure si për të marrë forca të reja dhe ju vërsulën betonit. Kjo punë që do të bënin atë natë do të ishte krejt e ndryshme nga ato që bënin zakonisht në trase. Ata u shpërndanë ashtu siç u tregoi tekniku. Shqiponja po rrinte para ca thasëve me çimento dhe po qahej se nuk dinte ç'të bënte. Hana i tha që të mos bëhej merak, se ajo do t'i tregonte. Ato kapën së bashku dy thasë me çimento dhe i derdhën sipër një pirlu me zhavor të matur për aq çimento. U ngrit një pluhur i hollë që, kur i ndeshi Shqiponjës në mukozën e hundës, e bëri të teshtinte me të madhe. Ajo u rrudh në fytyrë dhe i dolën lot.

Ato e kthyen dhe e përzien këtë zhavor disa herë dhe pastaj bënë një gropë në mes të pirlut të zhavorit ku hodhën ujë. Me to u bashkuan shumë të tjerë që filluan të ngrinin këso pirlgresh prej betoni. Riportablata sillnin pandërprerje zhavor e çimento. Hana u ankua se nuk mundnin dot të këndonin, pasi procesi i punës nuk i lejonte.

— Mjafton me e pasë kangën në zemër — tha Sokoli.

— Ti po ja ban si ai hoxha — tha xha Nika.

Violeta Çukeli i ra në qafë xha Nikës t'i tregonte si kishte qenë puna e hoxhës.

— Ishte një hoxhë ç'i thotë: «si me e ba gjynahin, si me e pasë në mend.» Mirëpo, kur shkoi një herë për darkë diku, i zien pilafin dhe nuk i qitën tëlyen. Kur nisi hoxha me e hangër, çka me hangër! S'mujti me e futë në gojë. «Na nuk i kena qitë tëlyn, hoxhë efendi, se menueme ç'i ti ke thanë njisoj si me i qitë, si me e pasë në mend. Tash na tëlyenin e kena në mend e nuk kena nevojë për te».

Edhe tekniku që ishte aq i zyrtë e i dëshpëruar nga difekti i betonierës, qeshi me zë, duke tundur kokën.

Sakaq betoni u bë gati për t'u hedhur në armaturë, po kjo u arrit me mund të madh. Shqiponja e kishte vënë ko-

vën në sup dhe ishte deformuar në fytyrë. Megjithatë e bëri buzën në gaz dhe i tha Hanës:

— Kjo kovë po më duket më e rëndë se Veleçiku yt. Ha-ha-ha!

— Mos na bëni të qeshim, se na derdhen kovat — i tha një studente, që po vinte duke u përdredhur nga pesha e rëndë. Ato nuk ja dinin betonit dhe të tëra i kishin ngarkuar kovat shumë, ndaj mezi i lëviznin.

Hana shikonte me interesim të madh armaturën e urës. Sa shufra të hekurta ishin kryqëzuar e lidhur me njëra-tjetrën! Sa të gjata ishin sajuar këmbët e urës! Shumë e gjatë dhe e lartë ishte ura, po ajo tani sollti ndër mend trenin që do të kalonte mbi të dhe ju duk e pabesueshme të kishte mundësi të kalonte ai gjigant mbi atë urë të ngushtë. E përfytyroi trenin mbi atë urë dhe ju dridhën qepallat nga frika se mos rrëzohej ajo bina e madhe, duke kaluar nëpër një rryp të ngushtë ure. Hodhi kovën e vet në armaturë dhe ju duk se nuk shtoi asgjë. Ajo kovë ishte si një pikë uji në det.

Vajzave nisën t'u skuqeshin supet nga pesha e kova-ve. Shqiponja ndjente zor më shumë se të tjerat. Çdo punë e re i vinte e zorshme asaj. Komandanti i tha të rrinte në pregatitjen e betonit, se lopatën e kishte mësuar ta përdorte me mjeshtëri.

— Ti je betonierë vetë, moj Shqype — i tha xha Nika me të qeshur. — Ti me kyt trup munesh me çue edhe urën mas krahit, more për besë të burrave!

— Ti po tallesh me mua, xha Nikë, po unë kam me u hakmarrë kundër teje.

— Ha-ha-ha! Si ke me u hakmarrë kundër mejet, more!

— Do të të rrotulloj në vallëzim tërë natën që të thuash: «Aman lëshomë!», po unë nuk kam për të të lënë derisa të të lëshojnë këmbët.

— Au, më mori dreqi tash! Jo, moj Shqype, besa! Nuk kam luejtë mensh me këcye me ty unë, jo! — tha një herë, pastaj ndryshoi tonin: — More, këqyr se jam plak me të vërtetë, po llogarinë nuk e lëshoj për të gjallë jo, pa u

pa gjaku deri në gju. Edhe në vallëzim kam me ju nxjerrë djersët e kuqe. A e di se edhe unë kam qenë në gjak dikur?

— Do të shihni, do të shihni — tha Shqiponja.

— Unë i vij hakut xha Nikës — tha Teuta.

— Aa, pse më ke fitue garën atëhere, thue ti? Ëhë, nuk do me thanë gja. Vallëzimin e kam ba zanat tash.

— Armaturat duan ushqim! — bërtiti tekniku.

Bisedat u zëvendësuan nga zhurma e lopatave, kovave dhe riportablave. Gjëja më e vështirë tani ishte transportimi. Betoni ishte i rëndë dhe kova të ngulej në sup.

«Po të më shohë babai kështu, nuk do të më njohë, tha me vete Shqiponja. Ai nuk mund ta marrë me mend se unë mund të bëj këso punësh kaq të rënda. Ai bile nuk di akoma si përgatitet betoni. Po t'i thuash babit se betoni përgatitet me gëlqere, nuk të kundërshton. Babai zakonisht vetëm rrugën shtëpi spital apo poliklinikë ka bërë. Ai ka parë ndonjëherë punonjës të NSHN-së në qytet, po as që ua ka vënë veshin. Ku mund ta kuptonte ai se betoni përgatitet jo me gëlqere, po me çimento? Edhe unë mund ta pranoja se betoni përgatitet me gëlqere, ashtu siç mund të pranoja se fasulja mbillet në vjeshtë. Eh, mor babai im!»

Pas pak Shqiponjën dhe disa të tjerë, midis tyre edhe Fredin, komandanti i caktoi të punonin me riportabël. Ata hipën menjëherë në maqinë dhe ja morën këngës. Fredi kundronte natyrën: para tij tutje shtriheshin male të rrudhosura palë-palë, pastaj kodrat, që vinin duke u ulur deri tek ato fare të ulëtat, përbri të cilave po kalonte maqina. Ai herë shikonte pejsazhin, herë kujtonte mbledhjen që qe zhvilluar atë ditë, vullnetarët që ngriheshin njëri pas tjetrit e flisnin pa pushim, pa e zbutur kritikën, pa ja fshehur asnjë të metë as shoqet e shokët më të ngushtë, shihte veten duke u tkurrur në qoshen e tij nga dëshpërimi. Atë ditë ai e pa mirë se pehllivanllëqet e tij nuk shkolin më, se tani ishte bërë i padurueshëm. Pra tani ai ose duhej të bëhej një tjetër Fredi Begaj, ose të qërohej nga instituti.

Edhe pasi ngarkuan riportablin dhe u nisën në drejtim të urës, Fredi vazhdonte të ngatërronte në përfytyri-

min e tij pejsazhet me mbledhjen e kolektivit në kinoklubin e sektorit. Ndërsa shokët këndonin.

Kur arritën tek ura, vullnetarët e tjerë ngritën lopatat përpjetë për t'i përshëndetur dhe Fredit ju duk sikur ja bënë me ironi. Po tani ai nuk bënte zë.

Shqiponja nxitoi t'u fliste shoqeve për bukuritë e natyrës.

— Sa pejsazh të bukur kishte andej! A t'u duk bukur ty, Hanë? — tha ajo.

— Hana asht rritë midis nj'aso sepazhesh e nuk e kënaqin fort kishe me thanë, haje dreq. Sepazhe kena të mjellluna edhe na anej boll, haji dreq!

— Ti, Nikë Shkreli, më ke ra në qafë, po ta dish se kam me të ardhë hakut edhe unë në mbramje të vallëzimit. Mos të të duket vetja i fortë.

— Mana nuk jam i butë ma, se i fortë jam sa të dësh tash. Nuk më ngulet as thoni ma, haje dreq! Koc e lëkurë jam. Shkoni tash e më bini zhavor.

Puna vazhdoi me ritmin e mëparshëm. Lodhja tani ishte rënduar mbi shpatullat e vullnetarëve. Shqiponja ndjente dhembje, dora e djathtë i dridhej dhe nuk kishte fuqi ta ngrinte lopatën me të. Ajo shikonte rreth e rrotull shoqet e shokët që punonin po ashtu si ajo dhe nuk ankoreshin (As Fredi nuk ankohej e as nuk fliste). Pra edhe ajo duhej të mos ankohej, se do të bëhej qesharake. Ja, po mbaronte koha e punës dhe do të vinin të tjerë vullnetarë për t'i zëvendësuar. Ajo ngrihej herë pas here dhe kapte belin me dorë, pastaj tendoste muskujt dhe i jepte lopatës se i dukej sikur i vinte puna më lehtë ashtu. Pastaj kapte kovën e betonit dhe vendosi ta mbante deri në fund.

Riportablat bartnin zhavor, vullnetarët beton, kovat transportoheshin në armatura, lumi gurgullonte, këngët oshëtinin, muzgu vinte i trembur avash-avash... U mbushën dy armatura dhe... befas lajmi i gëzueshëm: «betoniera filloi punën!» Vullnetarët brohoritën me të madhe. Zëri i tyre u ngrit mbi zhurmën e maqinave, mbi gurgullimën e lumit, mbi jehonën e minave përtej dhe u ngjit drejt qiellit.

Në të rënë të muzgut ata u nisën për në sektor.
Kënga mblodhi në rrethin e saj të gjithë vullnetarët.
Teuta këndonte pa e patur mendjen te kënga. Asaj i kishte lënë shumë mbresë puna e asaj dite. Ajo nuk e kishte marrë me mend se të rinjtë e brigadës së saj mund të bënin një punë kaq të madhe. E ç'nuk bënin tani ata!

* * *

Edhe për Myftar Alinë ajo natë nuk ishte e zakonshme. Tërë ato ditë ai kishte luftuar me sedrën e tij dhe ishte bindur tashmë se e kishte akuzuar të shoqen pa asnjë bazë. Po si të kthehej më tek ajo? Si ta mposhte sedrën? Si të mposhte mendimet e familjes së tij? Shumë ditë ai nuk e kishte shikuar në sy gruan, po tani nuk kishte nga t'ja mbante. Ajo gjendej kurdoherë afër tij në trase, në sektor, në shfaqje, në mbremje e kudo. A mund të ikte gjithnjë nga ajo dhe të bëhej kaq qesharak? Sanija kishte kërkuar të bisedonte me të. Atë mbremje ata patën punuar fare pranë dhe ajo i kishte hedhur mjaft fjalë si fshehurazi. Kur u dha lajmi i vënjes në gatishmëri të betonierës në atë entuziazëm të madh që kishte pushtuar të gjithë vullnetarët, Sanija i kapi dorën Myftarit dhe ja shtrëngoi fort. Ai në fillim nuk kundërshtoi, dhe pastaj ju përgjegj shtrëngimit të dorës së saj. Sa u gëzua Sanija. Tani nuk kishte dyshim se Myftari do të kthehej në familjen e tij, se ai do t'i mposhte të gjitha presionet e prindërve dhe të gojëkëqijve si Mehmet Rama. Ai po pranonte të bisedonte me të para të tjerëve!

Myftari po rrëmihte në dhe, pa mundur të shikonte Sanijen në sy. Atje larg në horizont vuri re lëvizje resh dhe në atë çast dëgjoji jehonën e një bubullime, që vinte nga majat e maleve. Ndoshta atje binte breshër. Atij nuk i pëlqeu që moti po prishej.

Hodhi edhe një herë sytë andej dhe pastaj shikoi Sanijen.

— S'kisha faj edhe unë... — tha, duke vazhduar të rrëmihte në dhe. — Kur të flasin keq të gjithë ata njerëz, kur të shtyjnë të tanë kundër grues... Kur edhe nana e baba... Dihet që nana e baba nuk ja duen të keqen djalit... Por e di që kam ba gabim të madh... Bile nuk meritoj me më falë... Unë meritoj me u dënue për jetë. — Tani atij po i zgjidhej gjuha dhe nuk e pengonte më sedra të bënte autokritikë.

Ata po rrinin pranë dhe nuk shqetësoheshin më se i shikonin të tjerët duke biseduar. Më parë Myftari nuk donte të dinte kush as për shikimet që i hidhte ai asaj vjedhurazi.

— Ban si të dësh, Sanije... — përfundoi Myftari.

— Unë nuk të kam largue prej zemrës asnjëherë, Myftar. Ti këte e di. Me gjithë poshtërimet që më ke ba, unë nuk të kam largue... Unë të dojsha... Unë e kuptojsha se nuk ishe ti, që veprojshe kundër meje, po prapanikët, feja, kanuni... Unë e dijshe mirë...

KAPITULLI I DYMBËDHJETË

Ata ose kishin dalë rrallë ose nuk kishin dalë fare nga fshati i tyre dhe kishin mall për shtëpitë, prandaj një ditë u erdhën të afërmit në takim. Sapo ishin kthyer nga puna vullnetarët, kur maqina e kooperativës bujqësore frenoi para sektorit. Ardhja e prindërve ishte bërë tashmë një ngjarje e zakonshme që do të ndodhte medoemos në çdo turn të brigadave fshatare dhe askujt nuk ju duk çudi kur një «ZIS» kooperative, i mbushur jashtë rregullores me pasagjerë, u ndal atë ditë te porta e sektorit. Shumë nga vullnetarët vërshuan me vrap nga porta e sektorit.

Hana nuk kishte pritur t'i vinte kush, po, megjithatë, i shikoi një për një vizitorët tek përqafoheshin me bijtë e bijat e tyre. Ky takim e mallëngjeu atë dhe ju mbushën sytë me lot. Që tani ajo e pa veten të veçuar nga të tjerët. Përse asaj nuk duhej t'i vinte kush? Ç'të keqe kishte bërë vallë që të ndëshkohej kështu? Zefi nuk kishte njeri nga shtëpia e tij në hekurudhë kësaj here dhe i tha Hanës që kishte ardhur si prind i saj. Kjo e kënaqi dhe e mallëngjeu vajzën, por sidoqoftë mallin për të afërmit e ndjeu thellë në zemër.

Hana po shikonte grumbullin e madh të vullnetarëve, që ishte mbledhur te porta, ku po bëhej takimi. Disa vajza nuk kishin ardhur akoma dhe ajo shkoi me vrap te kapanonet për të parë pse nuk vinin. Vajzat po nguronin të dilnin në takim pa shami dhe me pantallona veshur, ashtu si u thoshte Teuta. Bile edhe Sanija u kishte thënë atyre që nuk mund të dilej para prindërve me pantallona, se ishte turp. Hana ju zemërua Sanijes.

— Ti, Sanije, në katund ke qenë përparimtare, po tuta nuk i ke veshë, as shaminë nuk e ke heqë asnjherë. Edhe flokët nuk i ke lanë të verdhë, po i ke ngjye të zes. Këto i ke pasë të meta, prandaj nuk duhet me të ndigjue ty.

— Na do të shkojmë edhe në fshat kështu e të bajmë edhe të tjerët si veten — thoshte Teuta. — Prandaj ashtu siç jeni, me rrobat e aksionit, do të shkoni në takim.

Vajzat e panë që ishte e kotë të nguronin dhe ashtu me kokë ulur, me një barrë turp mbi shpatulla shkuan në takim. Ato dëgjuan që nga larg se si përshëndeteshin Zefi me Nikë Shkrelin.

— Mirë se të gjetëm, Nikë Shkreli! — ja bënte Zefi.

— Mirë se ju pruni kjo ditë e bardhë!

Pastaj Hana pa se si Bajram Gjetja, njëri nga miqtë e të atit, u takua ftohtë me Zyranë, të bijën, dhe qysh në fjalët e para i tha se kishte bërë gabim që kishte deklaruar fejesën të prishur.

— Pse me e ba këtë punë? — thoshte ai. — Na e patëm prishë një herë atë fejesë. A nuk u besove fjalëve të mia, a? Fejesën e patëm prishë qysh atëhere që patëm ba mbledhjen e fshatit!

— Ashtu vërtet ke pasë deklaruar atëhere, po në këtë vjeshtë ke pasë në mend ta martosh po me atë burrë, o Bajram Gjetja! — i tha Teuta, duke u munduar të fshihet zemërimin.

Pastaj Bajramit i folën shumë njerëz dhe e detyruan të mos i fliste më vajzës për atë punë. Teuta u tha prindërve që për punë të fejesave të mos kapeshin me vajzat pa u marrë vesh më parë me shokët e rinisë dhe të partisë në sektor.

— Kjo është një çështje e madhe parimore — thoshte Teuta. Ju lutem të keni kujdes! Keni ardhë të çmalleni këtu e jo...

— Ky Bajrami gjithmonë asht kenë budallë — tha Nikë Shkreli — Trimëria nuk bahet në kallëballëk.

Në atë grup kooperativistësh, që kishin ardhur në takim, bënte pjesë edhe Shaban Smajli, babai i Sokolit, të cilin nuk e prisnin të vinte. Kur e pa babain, Sokoli mbeti

i shtangur. Ç'nevojë kishte ai t'i vinin prindërit për takim aq shpejt? Kur kishte qenë ushtar, kishte ndenjur njëherë gjashtëmbëdhjetë muaj pa ardhur me leje në shtëpi dhe nuk ishte mërzhitur shumë, kurse tani për pak ditë kishte ardhur i ati ta takonte, si të ishte çunak. Ndryshe ishte puna e vajzave, që nuk kishin dalë kurrë nga shtëpia. Pastaj, pse të mos vinte i vëllai, po baba Shabani? Dhe pse ishte kaq i zemëruar? Sokoli e vërejti këtë gjë edhe nga mënyra e ftohtë e takimit, edhe nga ajo sesi ja hidhte vështrimin Shabani. Hana i shikonte me vëmendje lëvizjet e tyre dhe e merrte me mend pse Shabani ishte aq i ngrysur.

Pastaj një kushëri i largët, që kishte ardhur për të takuar të bijën, ju afrua më në fund edhe Hanës për të biseduar diçka. Ajo e pyeti me padurim për nënë Dilën dhe Gjokën.

— Ata me shëndet nuk janë keq, por... janë prishaqejf për punën tande... — tha ai duke nguruar, si të thosh-te diçka të kobshme.

— Po nana? — pyeti ajo me padurim.

— Kush e pyet nanën, bre Hanë? Shoku Zef ju lut Gjokës të vinte. Bisedoi me të edhe kryetari i kooperativës, kryetari i këshillit, bisedova edhe unë, po të tanëve na shkoi fjala kot... Asht helmue krejt. Po ti mos u ban merak. Kjo punë ka me u rregullue... Por ty mos të të vijë keq, ë? Na kena marrë vesh si nëpër mjegull se... — ai bëri një pauzë dhe Hana ja priti duke e pyetur edhe një herë se ç'kishin marrë vesh.

— Më vjen randë me ta thanë, Hanë... po unë, me ta thanë të drejtën... ma shumë kam ardhë për atë punë, se për punë të vajzës seme.... Gjoka e ka marrë vesh...

— Thueje, se mue nuk më vjen keq hiç!

— Thonë sikur... me njo fjalë don me marrë burrë tjetër... asht vështirë me e thanë këtë gja të keqe, por hallku thonë se ti, lum kushërina, je tuj ba dashni me Sokol Shabanin!.. me njabatë ç'i asht kenë sekretar riniet... Mos me të ardhë keq se po të thom kështu, ë! Unë nuk po thom se asht e vërtetë.

Frani mendoi se kushedi ç'presion të fuqishëm do t'i bënte Hanës me ato fjalë, po ajo tashmë ishte mësuar dhe s'i bëhej vonë për gjëra të tilla. Atë e zemëroi më shumë qëndrimi i atij kushëririt, me të cilin s'kishte diskutuar kurrë me këtë gjuhë.

— Më kishte marrë malli për ty dhe kur të pashë, u kënaqa, po edhe ti në një palë mend me të tjerët. Ç'ka u kam ba ju, qi po më lëshoheni në shpinë të tanë?

— Unë nuk po thom gja....

— Ti nuk po thue, se asht vendi që nuk mundesh me thanë, por po të ishim në katundin tonë...

— Unë të thaçë mos me u zemëru... Kjo gja asht hall i madh për zotin. Unë jam ai ç'i pse ke ikë prej shpijet, të pështoj dhe pse merr një burrë me vullnet, prapë të pështoj prej Gjokës, por, për me marrë ti musliman, unë nuk jam dakord... Ma mirë me ta thanë kështu!... Jo, Hanë, këte mos e ban! Për këte më ke kundërshtar mue e gjithë njerëzit!

U grindën një copë herë dhe më në fund ai shfaqti arësytën e vërtetë që e kishte shtyrë të hynte në këtë diskutim me Hanën.

— Kam pa të birin e Gjeloš Ujkës. Ishte djalë i mirë. Nuk e beson çfarë djali që ishte. Shumë i bukur, i pashëm. Asht pak i ri, po edhe ma mirë. Ç'po të duhet burri i vjetër? Këna mendue me u takue ti njëherë me të, se asht e pamujtun mos me të pëlqye. Kaq djalë i bukur asht.

Hana qeshi me zë të lartë në mënyrë therëse.

— Më thuej kush të ka nisë për këtë punë!

— Pasha zotin, more Hanë, kurrkush, po, tue pa rrezikun e madh ç'i po të vjen, thaçë ma mirë kështu. Se jam i bindun që besa e zotit, se ti e merr një at djalë sa ta shohësh me sy.

— Jo, jo, nuk do ta marr sido që të jetë! Le të jetë edhe yll.

Hana nuk mundi të dëgjonte më dhe u largua me pretekstin se po bënin edhe pregatitje për të dhënë shfaqje para prindërve mysafirë. Duke kaluar grupet e vogla të prindërve e vullnetarëve, në një qoshk, Hana pa përsëri

Shaban Smajlin të ngrysur tek bisedonte diçka me të birin.

— Pse u prish kjo fejesa e vajzës së Gjokës? — thoshte Shabani. — Mue nuk ma ka ndije zemra për mirë! Hallku kanë nisë me folë... Më ka hi kasavet e vesvese e madhe, ç'i o perëndi! Pse e prishi fejesën ajo?

Sokoli i tregoi se ajo fejesë ishte bërë pa dëshirën e saj dhe, sado që djali i Gjelosh Ujkës ishte i pashëm, ajo nuk e donte dhe nuk mund të fejohej me të.

Por plaku s'i besoi fjalët e të birit.

Pastaj Shabanit i thanë se duhej të shkonte për të bërë vizita nëpër kapononet e fjetjes dhe ai, sado që s'kishte dëshirë të shikonte asgjë, nuk kundërshtoi.

Prindërit hynë më parë në kapononin e vajzave, u kënaqën duke parë si i kishin rregulluar krevatet të tëra njëjloj, si i kishin vendosur peshqirët mbi kokët e krevateve, panë se te kokët e krevateve zakonisht kishte edhe libra, revista e gazeta. Një prind po fliste me habi. Ishte babai i Gjystes, vajzës me vetulla të trasha.

— Qyre, qyre! Për zotin edhe Gjystja ime lexoka libra! Hajde drejt! Kur ka kenë në shkollë, që kishte vaktin, mezi i merrte në dorë.

— Pse tash nuk e ka kohën? — u hodh Nikë Shkreli.

Tjetri u mundua të ndreqte mendimin që shfaqti pa ndonjë qëllim të keq. Pastaj Nikë Shkreli erdhi në humor dhe qeshi me të madhe:

— Ha-ha-ha! Këqyrni mue, burra! — dhe nxori nga xhepi një broshurë. — Ja edhe unë me libra në dorë! Qysh se kam ardhë këtu, vazhdimisht lexoj. S'ka përralla këtu, Nikë Pali! — i tha babait të Gjystes.

— Për të shën Noun, more Nikë Shkreli, edhe mue ma ke mbushë mendën me ardhë në aksion! Por nuk kam as takat unë i shkreti!

— Të vjen takati, o Nikë Pali. Ashtu thashë edhe unë, po, qysh se kam ardhë këtu, e kam tejkalue normën gjithnjë.

Ata bënë ca shaka një copë herë dhe pastaj dolën nga barakat e popullitit, panë çesmat e ujit, banjot dhe lulish-

ten që sapo ishte ngritur dhe më në fund u drejtuan për në kinoteatër, ku do të shikonin shfaqjen e bijve të tyre.

— Paaah, sa e madhe kenka kjo sallë! — tha Nikë Pali, kur hyri në kinoteatër. — Për zotin mue nuk ka burrë ç'i më ndalon ma pa ardhë në aksion.

— Nuk duem me ba azil pleqsh këtu, Nikë Pali — tha Nikë Shkreli. Mos këqyr mue, se unë jam i ri në krye. Baj tana punët ç'i ban rinia.

— Ta shohësh në shfaqje xha Nikën! — tha Ylli.

Në sallë po hynin përveç prindërve edhe shumë vullnetarë. Shaban Smajli shikonte anash dhe nuk i bëhej as të rrinte brenda as të dilte jashtë. Gumëzhima e sallës ishte një torturë e vërtetë për të. Atij i vinte kjo zhurmë ashtu siç vjen gjëmimi i motit në malin me pisha, ku zakonisht rrufeja shkrepëtin më shumë.

Pas pak zhurma e stolave dhe zhurma që bënin veglat muzikore diku thellë në skenë, u shuan dhe para tyre doli Hana. Shabani u ngrysa akoma më shumë, kurse të tjerët pritën me kureshtje ç'do të thoshte ajo. Nikë Pali nuk ju durua pa folë edhe një herë për të shprehur habinë e tij se si e bija e Gjokë Martinit, që nuk e kishte parë kurrë as duke kënduar, as duke folur para shumë njerëzish, tani kishte dalë dhe po recitonte. Bile atij nuk ju duk si i saj zëri, sepse nuk e kishte dëgjuar duke folur kurrë me zërin plot.

— Paaah, sa bukur! — ja bëri Nikë Pali.

— Na lë të dëgjojmë një herë, Nikë! — i tha dikush.

Po pastaj çudia më e madhe për Nikë Palin që kur e bija doli në skenë në një valle. Ai tha se Gjysten nuk e kishte parë kurrë njeri duke kërcyer, po sakaq atij ju shkreh Nikë Shkreli:

— Ty të raftë pika mas kreje, more Nikë! Si ka pasë me këcye kjo, kur ti nuk e ke lanë me ba gëk as mëk!

Secila skenë bëhej edhe më interesante se tjetra për të ardhurit nga malësia, po Bajram Gjeton e goditi më shumë se asgjë dalja e së bijës me një këngë. Ai lëvizi dy-tri herë nga vendi si ta pickonte diçka, shikoi prapa dhe pa

se s'kishte ku të hidhej bërthama e kumbullës në atë sallë të madhe. Kaq shumë spektatorë ishin atje. Nga të dilte ai? Ç'të bënte në atë mizëri njerëzish? Ai nisi të djersinte jo nga të nxehtit.

Kur mbaroi shfaqja dhe trupa doli të përshëndeste, Zefi u tha prindërve të shkonin pas tij dhe të uronin «artistët» e tyre. Kështu që edhe Bajrami u detyrua të shkonte pas shokëve dhe t'i jepte dorën së bijës. Edhe Shaban Smajli e bëri këtë me të birin, ndonëse e kishte parë (dhe këtë s'kishte për ta harruar kurrë) duke luajtur burrë e grua me të bijën e Gjokë Martinit! Frani e uroi Hanën dhe nuk i tha asgjë. Ai tani e pa se sa gjë e kotë kishte qenë përpjekja e tij, e pa se Hana e kishte marrë veten dhe nuk çante kokën ç'mendonin ata për të.

Dielli që varur mbi det dhe natyra ishte ngjyer në purpur. Zefi u foli vullnetarëve të fshatit dhe u zotua se do të ishte gjithnjë përkrahës i tyre, kur të ktheheshin në fshat. Kurse Shaban Smajli i thoshte Sokolit:

— Këtë ç'i bane sot, nuk kam me e harrue kurrë.

— Ajo ishte lojë, mor babë. Ishim në skenë.

— Lojë me u ba ti burrë i vajzës së Gjokë Martinit?! Lojë asht kjo?! Tfy, jazëk! Të tanë kanë me qeshë tash!

— Ata nuk kanë pse të qeshin, se e kuptojnë lojën.

— Po, po, gjithkush e kupton pse lot ti burrë e grue me të bijën e Gjokë Martinit! Ashtu si asht thanë në katund, e pamë sot me sytë tanë. E, mue më mëloftë dheu i zi ma mirë. Ke me ardhë atje! Tash ta nreqim na ty dhe asaj zagare!

Mbas shfaqjes, bashkë me të tjerët, hipi në maqinën e kooperativës edhe Tafë Brahimi që po e linte të bijën në aksion, i bindur më në fund se asaj s'do t'i ndodhte asgjë e keqe.

KAPITULLI I TREMBËDHJETË

Ai po bisedonte me shokun e tij, po veten e shihte gjithnjë duke lëvizur si i shastisur nëpër trena, maqina, stacione, rrugë, hotele, restorante; shihte si e shikonin njerëzit dhe i dukej se po e vërenin nën xhaketë, ku kishte futur pistoletën. Ai i tregoi shokut të tëra vuajtjet e udhëtimit të tij dhe e përfundoi tregimin me një psherëtimë të thellë.

— Eeeh, në hatër të zotit, çka kam heqë!

— Çka po kuven, bre Gjokë Martini! — tha Mehmet Rama, ndërsa po ndizte një cigare. Sado me më pasë thanë në kush, unë nuk kisha besue!

— Për zotin pra gjithçka të thaçë unë për hekurudhën besoje! Të tjerat janë rrena! Kija inat e foli hakun!

— More ç'i shëtisin djemtë e vajzat bashkë, asht e vërtetë. Mue më kanë thanë njerëz ç'i kanë pa me sytë e tyne. E thotë tanë dynjaja këte gja.

Gjoka u mundua ca. Ju kujtua se një herë kishte parë tri vajza me një djalë në mes tek bënin xhiro në rrugën automobilistike paralel me trasenë. Djali diç fliste dhe vajzat qeshnin. Njëherë tjetër kishte parë vetëm një vajzë e një djalë, që rrinin bashkë në një stol rrëzë një barake brenda në sektor dhe kënaqeshin duke qeshur. Njëherë tjetër kishte parë dy vajza me një djalë, që kishin marrë për-pjetë pyllit përmbi sektor. Kishte parë edhe të tjerë dhe të gjithë ata mbanin shalle aksioni. Gjoka tundi kokën.

— Ndoshta, ndoshta — tha pastaj i menduar.

— Po, mor Gjokë, se ku asht za, nuk asht pa gja. Pse

i thërret qeveria atje, thue ti — pyeti Mehmet Rama dhe u përgjegj: — Me u tretë turpi, more! S'ka tjetër. Mue më kanë thanë që ajo hekurudhë kishte me u nertue shpejt me makineri, por bahet ashtu për me u tretë turpin vajzave. Se hyqymetit nuk i duhen gja vajzat kështu si tonat të turpënueshme.

— Ti, Mehmet, nuk durohesh pa kalue! — tha Gjoka dhe lëvizi me nervozizëm me cigaren në gishta.

— Pse po ma thue atë fjalë?

— Ti, Mehmet, punën e qeverisë mos na e fut këtu. Mue nuk më ka faj qeveria, po vajza eme. Pat mjaft shokë të mijtë, ç'i nuk nigjuen me i çue vajzat në aksion dhe qeveria nuk u bani gja e vajzat sot i kanë në shpi me ner e me erz.

«Nuk i flitet hapun Gjokës kundër partisë e pushtetit, mendoi Mehmet Rama, këtij nuk i besohet, sado besnik i fjalës që asht. Dreqi ja marrtë lëkurën e tij! Duhet me ja pru punën me marifet, se ky, e don pushtetin.»

— Nuk po dal kunër qeverisë, bre Gjokë. Po dal kunër atyne gjanave, që kjo qeveri i ka të këqia. Rri shtremët e folë drejt. Dy gjana i ka të këqia fort: ç'i nuk don fenë një dhe ç'i i nep liri femnës dy. Folë si burrat, a t'i ka ana këto dy gjana?..

— Paj...

— Jo «paj», po thuej ç'i janë të këqia.

— Sidoqoftë unë jam me partinë.

— Me partinë jena të tanë, por këto gjana nuk na pëlqejnë.

— Ty nuk të pëlqen edhe ç'i të kanë marrë pasuninë, ç'i ke pasë. Ajo të ban me folë ashtu e jo puna e femnave, prandej puna jote nuk më gëzon aq fort. Unë e di...

— Pasunia ka shkue e me njimijë dreqën. Mirë boll po jetojmë, por këto gjana nuk po durohen.

— Gjithkush e ka rahat me durue, Mehmet Rama. Vetëm unë e kam vështirë. Se vetëm mue në kyt katund më ka ikë vajza.

— Sot ka ikë jotja, nesër ikin edhe tonat, Gjokë-ej! Duhet me i dalë para kësaj punë, o Gjokë! Edhe mos me

të pasë ikë; po me të prishë fejesën, keq se keq asht — tha Mehmeti.

— Mos me pasë ikë, nuk kishte mujtë me e prishë fejesën, se ja kisha rregullue prapë atë fejesë. E kisha goditë unë ashtu siç po i godisin edhe shumë shokë tanët. Ajo e kishte prishë dhe unë e kisha martue sapo të ishte kthye prej aksionit. Po tashti nuk mund të lahem. E ka marrë vesh tanë Shqypnia se më ka ikë vajza. Unë nuk e kam besue se mund ta merrte vesh gjithkush punën e vajzës seme.

— Au, shpejt bile! Gjinja e qeverisë e kanë ba këte punë. Thuej si të dësh se ni këtu qeveria nuk e ka aspak me vend. «Tashti me ngulë kamë. Me e nxitë me e vra të bijën. Me ja majtë gjakun e nxehun, derisa të kthehet e bija. Po e vrau ky vajzën, do të jetë një fitore e madhe. Punë e madhe se po e vritkan këte atëhere! Ky asht plak tash, dreqi. Po u vritka një kryqali e punë e madhe fort! Mjafton ç'i të tjerëve u bahet tetë me dy».

— Çka thonë hallku për mue, Mehmet-a?

— Të kjajnë hallin. Nuk thonë ndonji gja të keqe. Ti e ke kallëzue veten, kur ka qenë koha. Të tanë thonë: «I shkreti Gjokë, si ja nxiu fytyrën ajo rruspije atij farë burri, ç'i e ka nerue vendin gjithmonë». Gjithkush ka gaze-pin e vet, more Gjokë. Kanë frikë se ndjekin edhe vajzat e tyne shembullin e vajzës tande.

— Me vajzën teme do t'i qëroj hesapet, xhanëm. Atë punë do ta vë në vend... Mos kujto se ndigjoj me dekë i koritun. Nuk i çoj vorrit marre, Mehmet Rama!.. — tha dhe heshti për një çast.

«Ja ka qitë cekën me e vra, më duket. Nuk nalohet Gjokë Martini, jo».

Pastaj ndenjën një copë herë pa folur të dy. Tymi i duhanit dredhonte fjolla-fjolla.

— A e more vesh punën e Myftar Alisë? — e pyeti Mehmeti, kur Gjoka po mendonte se do të shihej të nesërmen me Gjelosh Ujkën.

— Që ka marrë gruen prapë — a?

— Po, pra, pastë faqen e zezë!..

— Aman ku e shtime vedin unë e ti!

— Na asht nxi fytyra krejt. Pastë faqen e zezë!
— Nuk ka faj ai, po na që e ndigjueme. I besuem atij dhe bame batall vedin.

— Jo, more, na jena burra. Batall asht ai që lëpin pështymën, që ka qitë një herë për goje.

— Na shkoi dëshmia kot.

— Na bame punën tonë. U munuem për nerën e një shoqit tonë.

— Kena rrejtë në gjyq. Kushedi ç'kanë me na thanë...

— Asgja s'na thonë. E kam pa, more! Ti e ke ndigjue vetë dom Lazrin kur thotë: «Kur asht puna me mrojtë nerin, s'ka gja edhe me rrejtë». Na rrejtëm e mbrojtëm nerin, po ai pastë faqen e zezë! Kanë ardhë prej atje në hekurudhë e këtu krah për krah me atë rruspije pa rubë hiç në krye dhe u kanë thanë atyne të gjyqit: «Shkyeni ata tefterë, se nuk dahena kurrë për të gjallë. Mue më kanë rrejtë të tjerët, ka thanë ai gomari. Vetë nuk kam pa gja». Ka kujtue se duhet me pa patjetër. Sa gra janë ashtu e na nuk kena pa gja. Kush më ka pa mue keq me gruen teme?

Gjoka nuk e mbajti dot të qeshurit. Tha me zë të lartë:

— Ka ditë nuk kam qeshë.

— S'del gazi kështu, more burrë. Sa shkon një ngjarje e keqe prej katunit, vjen një tjetër. Një herë vuejtme me kolektivizimin. Sa u rregullueme pak me atë, krisi pushka e rrënimt të kishave dhe të xhamive. Sa kaloi kjo, aksionet e vazave e prishjet e fejesave e kuku për ne ma mirë! Po desim pa dekë!

— Sidoqoftë ti bane gabim që na the me dalë dëshmitarë në rrenë për Myftar Alinë — tha Gjoka.

Ata biseduan gjatë për çështjen e Sanijes e të Myf-tarit, duke sharë e duke mallëkuar.

— Unë e di — thoshe Mehmeti — se ai i ka thanë asaj: «Hajde në aksion se atje të marr. Do të thomi ç'i na detyruen aksionistët, na kapi edhe qeveria e na nuk patëm hall pa u bashkue.» Manej një ditë kanë marrë leje atje e kanë ardhë në gjykatë, këte ma tha dikush ç'i dinte mirë këtë

punë, kanë marrë edhe aksionistë të tjerë si dëshmitarë...

E vërteta nuk ishte ashtu. Myftari nuk kishte kërkuar të vinte në gjykatë. Atij i kishte ardhë fletëthirrja. Atij dhe Sanijes. Dhe ishin nisur një ditë me trenin e pasdites. Me ta kishin qenë Teuta, Lulëzimi, Zana dhe Shqiponja.

Dhe ishin paraqitur në gjykatë, ku zyrtarisht kishin shpallur ribashkimin e tyre.

Mehmeti u largua i kënaqur nga Gjoka, se e pa që ai ishte i vendosur për të vrarë të bijën. «Do të vij shpesh, do të munohem me ja majtë këto mendime përgjithmonë», mendoi Mehmeti, duke u ndarë nga Gjokë Martini.

KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË

Ndërsa po punonin në trase si çdo ditë, Hanës i thanë se e kërkonte dikush. Asaj i rrahu zemra ethshëm dhe menjëherë i shkoi mendja te babai. Po shpejt e sqaruan se ai që e kërkonte, ishte një djalë shumë i ri, i veshur me një kostum që i rrinte shumë i madh. I thanë se djali vinte nga malësia dhe kishte një porosi nga e ëma e Hanës.

— Thoni të presë, derisa të la punën — tha ajo.

— Jo, jo, dil — i tha komandanti.

Hana, duke i rrahur zemra, kapërceu atë pjesë të kodrës, ku po punonte dhe u gjend para një djali të ri, që ju duk shumë simpatik.

— Kë kërkon, djalë? — e pyeti Hana për provokim.

— Hanë Gjokën — u përgjegj djali me një zë, në të cilin ndiheshin nota drojtjeje dhe turpi.

— Unë jam Hanë Gjoka. — Ajo u afrua dhe i dha dorën atij, që nga trupi vinte më i shkurtër dhe ishte shumë më i ri se ajo.

— Nga vini, more djalë? Unë nuk po ju njoh fare.

Djali shikoi përpara se mos shihte njeri, duke menduar se do të ishin edhe të tjerë, sepse Hana i foli si të qenkëshin shumë vetë.

— Vetëm unë jam — tha ai.

Hana e mbajti gazin me zor. Pastaj e pyeti se mos ishte aksionist. Ai u përgjegj me një «jo» të shkurtër dhe ajo u bë nervoze me atë njeri, që po fliste aq me drojtje dhe që rrëmihte në dhe me majën e këpucës.

— Po mirë, ç'punë ke me mua pra, a ban me ditë? Unë nuk po të njoh fare.

— Unë... unë... jam Uci i Gjelosh Ujkës...

Hana bëri një gjysmë hapi prapa dhe shikoi si e trembur njeriun, që kishte përballë. Ajo sikur po përpiquej të mbante zemrën që të mos i dilte nga krahërori. Shikoi anash. Ndjeu nevojën për të pasur shokë atje afër. Gjithfarë mendimesh ju vërtitën në kokë në atë çast. Mendoi se mos ishte ngritur ndonjë kurth, mendoi se me atë djalë do të ishte ndonjë grup tjetër dhe kushedi ç'plane kishin endur. Ç'të bënte tani?

— Ç'punë ke me mua?! — i foli ajo me një ton të rëndë.

— Pse po më flet kështu, kaq egër? — filloi të merrte veten djaloshi.

— Si të duesh po të flas, po unë jam në punë e nuk mundem me u vonue — ajo shikoi kostumin e tij të madh terital dhe mendoi se kushedi ku e kishte marrë për t'u dukur simpatik, po në të vërtetë ishte bërë si dordolec. — Pse më kërkove, djalë?

— Unë kam ardhë me bisedue... Ti ke thanë... Na nuk jena takue kurrë, ti ke thanë se... — ai fliste me pauza, po ajo e humbi durimin.

— Çka kam thanë?

— Ke thanë ç'i nuk më do për burrë — foli ai kësaj here më trimërisht.

— Kam thanë e thom prapë.

— Po na nuk kena bisedue kurrë bashkë, he burrë-neshë..

— Unë të due... — tha ai pa e shikuar Hanën në sy. — Meqë na fejuen me zakone të vjetra, mendova me bisedue dhe me u njoftë bashkë...

— Mendove ti apo të ka nisë kush?

— Për zotin nuk më ka nisë kush!

— Ti je fëmijë, mor djalë. Nuk duhet me u marrë me këto punë ti kaq i ri. Prit një herë, se ke kohë.

— Për ate mos më anko!.. Unë nuk jam fort i ri... Hana u bë nervoze dhe ju shkreh atij si rrufeja:

— Shiko këtu pra! Të jetë hera e fundit që ti më

sillesh mue! A more vesh? Me ty nuk martohem e pikël! Ç' do ma ti! Tash nisu e thuej Gjelosh Ujkës se nuk ka gjetë kishë, ku me u falë, se janë rrënuë prej kohësh. Ikë, djalë! — tha ajo dhe u kthye drejt kodrës.

— Mos, he burrëneshë! Unë të due! — mori zemër ai tani, ndonëse zëri i tij tingëllonte si i përvajshëm.

Hana ecte dhe ai fliste. Kur ajo u largua ca, ai i tha me ton të ashpër.

— Nuk ke me marrë tjetër burrë pra, veç se hjek zi kot! Ka kush i rregullon ato punë. Ke me e njoftë Gjelosh Ujkën!

Hana shikoi një herë prapa njeriun si dordolec, që rrinte po atje ku e la ajo pak më parë dhe vazhdoi rrugën për te shokët. Zogjtë cicëronin nëpërmes zhurmave mbytëse të traktorëve dhe gurgullimës së fuqishme të lumit. Në rrugë kalonin «Skodat» me krom. Një grup vullnetarësh ishin mbledhur në një grykë tuneli atje përtej dhe po shikonin maqinën, që zbironte malin me turinj. Ajo maqinë sapo kishte ardhur dhe Hana nuk e kishte parë ndonjëherë. Ajo shikoi pastaj njeriun si dordolec që po largohej nëpër rrugën e automobilin.

* * *

Mbi fushën e përthyer kishin rënë rrezet e para të diellit, kurse lart, mbi kokët e maleve qëndronin tufa resh si feste të bardha. Rrezet e diellit herë digjnin me afsh, herë fshiheshin pas perdes së reve, që lëvrinin shtëllungashtëllunga nëpër horizont. Hana shikonte atë grykë tuneli, që më parë i qe dukur gjithnjë si një zgavër. Ajo pa rreshtin e vagonave të vegjël, që bartnin dhe e gurë nga thellësitë e tunelit dhe e flaknin jashtë nën trase. Edhe pse i qe mësuar syri me ta, prapëseprapë ajo i shikonte me kureshtje. Ajo kishte punuar shumë ditë në tunel dhe tani e shihte atë me mburrje. Puna në tunel do t'i mbetej në kujtesë, sepse atje ajo kishte filluar të punonte më pa drojtje bashkë me Sokolin. Sa biseda kishte bërë me So-

kolin në atë tunel! Oh, sa kënaqësi i kishte dhënë asaj ai tunel!

Vajza shikoi trasenë që ishte ngritur qysh se kishin ardhur ata, dhe vetëm tani e kuptoi punën e madhe që kishte bërë ajo me shokët e shoqet e saj. Ju duk sikur të kishin punuar vite të tëra për të ngritur atë rryp gjigant. Tani ajo po provonte një farë mallëngjimi dhe sytë ju mbushën me lot. Për pak ditë ajo do të ikte dhe t'i linte ato vende, ku i kishte shkelur këmba përditë, ku kishte pikuar djersa e saj dhe ku kishte aq kujtime të bukura. Kujtimet e një dite të këtushme nuk mund të krahasoeshin me ato të të gjithë jetës së saj të fshatit.

— Hajde, Hanë, se do ta shpiem dyqind për qind — i tha Teuta, po Hana nuk e provoi tani atë kënaqësinë, që ndjente më parë, kur i flisnin shoqet kështu. Dikush tha se duhej të mos e lëshonin deri në fund flamurin e KQ të BRPSH, të cilin e kishin fituar me aq sakrifica, po prapë Hana nuk u entuziazhua si zakonisht. Teuta e vërejti këtë gjë dhe ju afrua pranë.

— Pse po rri sikur të janë mbytur gjemitë, Hanë?

— Po maron aksioni...

— Dihej që do të mbaronte. Ne do të vijmë prapë. Tani duhet të vijmë ata që nuk kanë qenë.

Teuta i foli shumë, po ajo nuk e kishte mendjen. I kishte dëgjuar ato gjëra sa e sa herë, po ajo donte që aksioni të mos mbaronte kurrë për të.

Ato po shkonin drejt grumbullit të traversave. Hana e kapi një traversë të rëndë dhe e shpuri në trase, ashtu siç bënin të gjitha shoqet, po edhe në këtë punë nuk e ndjeu kënaqësinë e mëparshme. Vajzat merrnin frymë thellë se traversat i kishin lodhur shumë.

Vullnetarët vërshuan mbi leva, morën të gjithë nga një dhe ju afruan shinës së rëndë. Ata e kishin pandehur si punë të lehtë këtë dhe tani po habiteshin se si u rridhnin djersët. Ku ta dinin ata se ç'ishte kjo punë?

— Kjo thellë e dashka pirunin të madh e me ja ngulë fort — ja bënte xha Nika, kurse tekniku u jepte hov duke bërtitur: «Hooo-hop! Hooo-hop!»

— Mos na bëj të qeshim, xha Nika, për kokën tënde! — i tha Teuta.

— Jo besa, për kokën teme hiç, po për tanen! A po ke pak kokë ti-a? Pastaj drejtoi trupin dhe u tha të gjithëve: — Shikoni këtu! Mos më thoni ma «xha Nika!», se ai ç'i vjen në hekurudhë, s'ka si me kenë «xha». Në hekurudhë vinë vullnetarë të rinj dhe jo «xhajtat». Unë kam ardhë si i ri dhe po punoj si i ri. Pse me u quejtë «xha Nika»? Thonë se qeni plak bahet gjuetar! Po, more, për ner unë u bana gjuetar e migjuetar!

Vullnetarët qeshën dhe Teuta i tha përsëri atij: — Mos na bëj të qeshim për kokën tënde!

Po sakaq lokomotiva e vogël turfulloi atje matanë, ku udha e hekurt kishte marrë formën e saj. Një tufë zogjsh të trembur u ngritën me vërtik për të parën herë nga një vërshëllimë lokomotive. Hana i hapi sytë për të mos lënë t'i shpëtonte asgjë nga ajo skenë. Brohoritjet e vullnetarëve e sollën në humor dhe, duke shikuar trumcakët, që, si dukej, nuk gjenin vend, i tha xha Nikës:

— Këta trumcakët gjithkund njëlloj qenkan. Edhe atje te na një kështu.

— Aq shumë të duket se je largue, moj bijë! — tha ai. — Nuk je në Çinimaçin, po në Shqypëni je, he burrëneshë! S'kanë si me ndryshue trumcakët prej atje e këtu në hekurudhë bre!

Hana u skuq në fytyrë dhe të tjerët qeshën.

— **Erdhi riportabli me zhavor! — bërtitën vullnetarët.**

Ata u ngritën me lopata. **Batipali rrihte tokën me zemërim.** Xha Nika hyri prapë në mes të brigadës së tij dhe dëgjoji Sokolin që po grindej me kompaninë e tij, se nuk e kishin mbaruar akoma togun e zhavorit.

— **Po këta nuk asht sheqer, more bylbyl!** Edhe me kenë sheqer tanë këta, kishte me e neveritë krejt sektorin. Po ty të lëshosha në shpinë Shaban Smajlin e Gjakë Martinin!

Maqina gumëzhiu dhe e tërhoqi Sokolin me vete. Ai ja mori këngës. Hana e ndoqi me sy, derisa u zhduk në berrylin e kodrës, pastaj u përkul mbi lopatë dhe i mëshoi

me vrull. Hijet e kodrave nisën të zgjateshin e të mbulo-
nin luginat, fushat e trasenë e hekurudhës. Tani koha
freskohej dhe aksionistëve u shtoej fuqia.

Hana ju afrua Shqiponjës, që po rrinte në heshtje, dhe
e pyeti se ç'mendonte.

— Gjëra të mira po mendoj — tha ajo.

— Ti më duket mendon si me ardhë mësuese te na.

— Nuk është për të mos u menduar edhe ajo.

— Aty ku po kalojmë na të tanë jetën, hajde edhe ti
një herë, he burrëneshë! Të paktën një vit.

Shqiponja qeshte me pyetjet që i bënte ajo.

— Të mërzita me pyetje sot, Shqipe. Më thonë se unë
baj shumë pyetje. Unë pra nuk baj shumë pyetje. Pse më
thonë kështu?

— Vazhdo, vazhdo...

Hana i bëri prapë pyetje. Tani ato bisedonin dhe pu-
nonin njëherësh. Pastaj dita e punës mbaroi për turnin e
dytë dhe vullnetarët nisën të mblidhnin veglat. Kurse bati-
pali i madh e rrihte trasenë akoma më rrëmbyeshëm. Bimp!
Bimp! Po papritmas ai heshti. Mbi trase ra qetësi e thellë.
Dikush tha se batipali ishte prishur. Rreshti i vullnetarëve
që ishte zgjatur në drejtim të sektorit, ngriu në vend. Di-
fekt! Ç'mysafir i keq i papritur që ishte ai difekti i djallit
në maqineri! Difektet nuk ndodhnin shpesh, po ja që ndo-
njëherë ndodhnin dhe kjo ishte mjaft e hidhur. Tani ish-
te fundi dhe nuk duhej të ndërpritej shtruarja e traversa-
ve në trase. Batipali heshtte dhe rreshtat e vullnetarëve
u prishën. Ata heshtnin me lopatat mbi supë drejt qiellit
e me paguret e ujit në duar. Kjo zgjati vetëm një çast, pas-
taj të gjithë vullnetarët u lëshuan prapë mbi trase me
tokmakë për të zëvendësuar batipalin. Vrapuan andej e
këtej për të mblodhur sa më shumë tokmakë. Pastaj buçiti
një këngë e fuqishme e përzierë me rrahjen e tokmakëve
në trase, një shtypje me gulç e me ritme të shpeshta.

Dhe tokmakët rrihnin me tërbim mbi trase. Po kjo
shtypje ishte krejt e ndryshme nga ajo e batipalit. Tokma-
ku duhej të rrihte disa herë në një pikë, derisa dheu të mos
shtypej më. Tekniku i prapësonte herë pas here vullneta-
rët, sepse nuk kënaqej lehtë me punën.

Xha Nika ishte lodhur jashtë masës. Tërë muskujt duhej t'i tendoste për t'i rënë një herë trasesë me tokmak. Kështu ndodhte edhe me vullnetarët e tjerë.

— Edhe një kujtim interesant — tha Shqiponja. — Punë natën. Ne nuk kemi punuar kurrë natën.

Ata ishin kaq të lodhur sa nuk patën dëshirë ta ndiqnin bisedën e saj. Nuk reagueshan dhe ajo i mëshoi tokmakut. Shqiponja e ndjente veten më pak të lodhur se të tjerët. Nuk ndjente tani, si në fillim, asnjë dhembje as në bel as në krahë, as të therura në shuplakat e duarve. Kur ngrihej në mëngjez, e ndjente veten të lehtë e të shkathtë dhe i dukej vetja krejt ndryshe. Ajo kishte arritur të hante edhe tërë racionin e ushqimit edhe sikur të mos qe i gatuar mirë. Kurse në shtëpinë e saj ajo rrinte ditë të tëra pa ngrënë bukë. Hante vetëm byrekë ose vezë të ziera. As ëmbëlsirat nuk i hante kurrë.

Vullnetarët, ndërsa punonin, i luteshin xha Nikës t'u tregonte si ua kishte hedhur ca bajraktarëve në Mirditë. Kur ju lutën shumë dhe ai erdhi në humor, filloi të tregonte:

— Na vunë pijen para atje në Mirditë e njerëzit po pritshin me fillue bajraktari. Mirëpo bajraktari po kishte muhabet shumë me ba me një shoq të tijin, e na rrijsim harru. Unë besa kapa gotën e «me ner e mirë se ju gjeta» u thaçë atyne dhe ja ktheva tiktik rakisë. Bajraktari e shokët e tij më këqyrën si dreqin. Unë pijshe raki e hajshe meze e të tjerët pritshin kur të fillonte bajraktari. Mandej na erdhi aty edhe komandanti i vendit, një bullafiq me grada dhe u çuen të tanë në kamë. Unë nuk luejta hiç. Bajraktarit i ra hija e dekës. «A ka shumë si ty Malësia e Madhe?» më pyeti bajraktari me inat. Besa edhe unë i ndenja gati me përgjegje. «Paj more burra në Malësi të Madhe unë jam ma i keqi i të tanëve e nuk ka të tjerë si unë atje, kurse këtu tanë bajraktarët kenkan si unë». Edhe t'u rakshe pushkë ballit me kaq nuk pata me ja u ba se me ato fjalë. Nji kështu pat kenë ajo punë. Kena kenë të pashkollë, po nuk kena pranue me na e hedhë kush kurrë-e përfundoi tregimin xha Nika.— Kena pasë edhe në

Shkrel njerëz të trashë si Gjokë Martinin, ç'i don me ba edhe sot çka ka thanë dom Lazri qysh para tridhetë vjetësh.

— Shumë po ma shan babën, mor shoku Nikë — tha Hana.

— Ai nuk fyhet edhe me i ra tokmak turinje.

— Tani që po i shkon e bija nga aksioni, do ta sqarojë.

— Besa ai nuk ka me e pranue mrenë, edhe në mos i vraftë. Po kjo ka me ndenjë në shpinë teme me plakën nj'aty.

— Në shtëpinë tënde do të vimë ne — tha Zana.

— Shpia eme asht sa 'nji stallë kuaqsh e ju zen boll. Le ç'i kur të vini atje qe besa nuk ju lanë ata harmoçat e mi. Shpejt kishim me i hangër dasmat tueja, se atje asht uji ç'i ju ban për vedi. Ashtu si uji janë edhe djemtë.

— Atje ka edhe 'nji zakon që nuk po ua tregon xha Nika. Atje martohen pleqtë nga dy herë, prandaj rueni se mos ja ka vumë synin ndonjenës — tha Lula, që fliste rrallë asaj dite.

— Atë punë e bajnë pleqtë myslimanë, moj kopuke! Ata bajnë si Muhamet Mustafaja. Kurse unë kam atë plakën teme ç'i nuk e nërroj me askën.

Vullnetarët ishin lodhur dhe tokmakët rrihnin tokën me ngathtësi. Tup! Tup! Turututuj! Kjo ishte melodia që asaj nate nuk po këputej. Kjo melodi zgjati deri në orën një pas mesnate, kur u ndreq difekti i batipalit.

KAPITULLI I PESËMBËDHJETË

(Epilogu)

Afshi i diellit valëzonte në territorin e sektorit dhe vullnetarët lëviznin me valixhe e çanta nëpër duar. Një grumbull vajzash përqafoheshin mu aty para zyrave të shtabit dhe ndonjëra fshinte lotët. Xha Nika përpiquej t'i qetësonte ato, po edhe vetë me zorr i mbante lotët.

— Po mjaft de, se prapë keni me u pa. Aksionet nuk po marrin fun me sot. Ne kena me ardhë prapë ishalla. Hajdeni tash, se nuk ka kohë maqina me pritë na.

Megjithatë ato prapë po vonoheshin. Shoferi i binte borisë. Pastaj te maqina ku po hipnin vullnetarët e brigadës «Muho Selmani» erdhën edhe mysafirët studentë: Lulëzimi, Zana, Lula, Shqiponja dhe Fredi. Ata e kishin planifikuar prej kohësh për të shkuar në fshat me shokët e tyre. Kishin bërë ç'kishin bërë dhe kishin mundur të tërhiqnin me vete edhe Fredin. Në fillim atij i qe dukur si një shaka e shokëve, po ja tani ai hipi në maqinë dhe po nisej për në malësi.

— Kjoftë e bardhë dita ç'i po ju sjell në malësinë tonë i uronte xha Nika dhe u shtrëngonte duart.

Maqinat gumëzhinin dhe vullnetarët tundnin shamitë e aksionit.

— Udha e mbarë, vullnetarë! Udha e mbarë. Nikë Shkreli! — ndiheshin zëra.

— Mirë u pafshim, shokë! Prapë do të shihemi në aksion.

Maqina filloi ecjen. Ajo po kalonte mbi pircun e madh të përshëndetjeve, që e rrethonin nga të gjitha anët,

15
ecte mbi tingujt jehues të këngëve joshëse të aksionit, mbi përqaqimët së largu dhe mallëngjimët e çastit.

Mbaroi një aksion. Por sektori dhe traseja nuk u boshatisën. Maqina tani ecte me ngadalë paralel me trasenë. Në atë trase ku u derdhën djersët në ato ditë të ngrohta, ku u bë aq punë, aq biseda e shaka, ku puna njohu tërë ata të rinj djem a vajza, ku lindën dhe u rritën aq shumë dashuri, ku u shkelmuan aq shumë zakone prapanike dhe iluzione mikroborgjeze. Ja goja e tunelit, ja kodra e çarë mes për mes, ja vendi ku një ditë u lagën aq shumë vullnetarët në luftë për të shpëtuar trasenë, ja kanali që kish-te patur aq shumë baltë dhe më në fund ja rruga e hekurt me traversat e shinat të vendosura nga duart e tyre. Gjithkund kishin vënë dorë ata. Vullnetarët e rinj po përshëndesnin, duke ngritur lopatat përpjetë. Hana u mallëngjye, ca bulëza lotësh ju shkoqën dhe ju varën poshtë faqeve. Ajo nxori shaminë e duarve dhe fshiu lotët. Nuk donte ta shih-te kush të përlotur. Nuk ishte kohë lotësh.

Maqina vraponte e vraponte. Priste fusha, kodra, fshatra, lumenj, qytete. Vraponte maqina; vraponin këngët, bisedat, entuziazmi, bota e madhe e projekteve, ëndrrat, dashuritë... Përsëri metingje në qytet, fjalime, popull. Përsëri hipje në maqina.

Dhe ja më në fund para studentëve mysafirët shpalosen pejsazhe të panjohura.

— Kjo, pra, asht malësia jonë — tha Nikë Shkreli.

Studentët shikonin sa në një krah në tjetrin sikur përpiqeshin të mos u shpëtonte asnjë detajë nga ajo tablo e madhe. Pyesnin për çdo gjë dhe xha Nika u përgjigjej me qejf, duke u treguar edhe nga një ngjarje për çdo mal apo fshat.

— A janë të dobishme këto male? — pyeti Shqiponja.

— Në këto male na kena gjysmën e jetës — sqaroi xha Nika.

Maqina, duke gulçuar dhe duke u tundur nga gropëzat e rrugëve, hynte thellë e më thellë në zemër të malësisë. Pas pak, xha Nika tregoi me dorë një copë fushë të rrethu-

ar me male, ku ngriheshin ca shtëpi të bardha e të shpërdara në mënyrë të çrregullt dhe tha:

— Nj'aj asht katuni ynë pra. Tashti me knue e me brohoritë fort! Forca, rini! Ta marrin vesh të tanë se u kthyen vullnetarët!

Kënga që deri atëhere shpesh ishte mbytur nga zhurma e maqinës, tani doli mbi të gjitha. Në qendër të fshatit qenë mbledhur shumë kooperativistë dhe shoku Zef me kryetarin e kooperativës rrinin në krye. Ata kishin dalë posaçërisht për të pritur vullnetarët.

Edhe Gjokë Martini që ndodhur atje afër, duke punuar, po, kur pa ato fytyra (të bijën nuk e njohu) dhe dëgjoi tërë ato brohoritje të fuqishme, nisi të dridhej dhe të mos e ndjente veten mirë. Mbajti vesh atje në mes pjergullash ku ishte, dhe, në mes të tjerash, dëgjoi të thoshte dikush:

— Paah, këqyre të bijën e Gjokë Martinit! Pasha të madhin zot, nuk u njihka hiç! Pah, çfarë vajze! Ma e mira nër të tana kenka kjo!

Atëhere Gjoka ndjeu një goditje të fortë në ndërgjegje. Ju duk se edhe në zemër e goditi diçka e fortë me fuqi mpirëse dhe shikimi ju vagëllua për një çast. Ai bëri kryq disa herë dhe u lut me zë. Pastaj dëgjoi zërin e xha Nikës t'i thoshte një vajze të vogël:

— Vera, shko e thueji plakës të presin një qingj të mirë, se kena miq për darkë. Hajt ta marrsha! Njitash po vijnë!

Sa afër e kishte Nikë Shkrelin tani Gjokë Martini! Prej atje mund edhe ta vriste. Eh, sa shumë telashe i kishte nxjerrë ai Nikë Shkreli!

Gjoka kishte ëndërruar shumë për ta patur Nikën kaq afër me qëllim që t'i qëronte hesapet me të dhe ja tani sa afër e kish! Gjoka po bënte kryq. Bënte kryq edhe në shenjë habie, që nuk po kishte më fuqi ta urrente Nikë Shkrelin, ashtu siç e kishte urrejtur më parë. Ai kishte qënë dikur shok i ngushtë me Nikë Shkrelin, po që ftohur ca nga ai, kur çoi vajzën në shkollën e mesme. Nika ishte i pari që e qiti atë «bidat» të ri në katund të vjetër dhe Gjoka nuk kishte si të mos ftohej prej tij. Pastaj ftohja dhe

urrejtja e Gjokës për Nikën ishin rritur, kur ai nisi të mos shkonte më në kishë. Por kjo urrejtje kishte qenë e fshehur. Gjoka kishte hyrë e dalë vazhdimisht te Nikë Shkreli. Por më në fund Nika kishte bërë atë, që Gjokës as nuk ja kishte prerë mendja: kish ndihmuar Hanën për të ikur nga shtëpia! Tani urrejtja e Gjokës kishte arritur kulmin dhe, po ta takonte ato ditë Nikë Shkrelin, do ta vriste ose së paku do të tentonte ta vriste. Por tani që e kishte aq afër, nuk kishte më dëshirë ta vriste dhe bile nuk po kishte as fuqi ta urrente si zakonisht. Ç'po ndodhte kështu me të? Ai shkoi nëpër mend tërë përpjekjet që kishte bërë gjatë asaj kohe dhe kush i kishte folur kundër së bijës, kujtoi nxitjet e Mehmet Ramës dhe ju dukën fare pak ata që ishin në një mendje me të. Me Hanën ishin shumë njerëz, ishte e tërë shoqëria.

Ai lëvizi nga vendi dhe shikoi prapë andej nga grumbulli i njerëzve. Çfarë duhej të bënte tani Gjokë Martini? Të rrinte i koritun apo të nderohej? T'u bënte qejfin atyre pak njerëzve me Mehmet Ramën në krye, apo shumë të tjerëve me partinë në krye? Ai u drodh dhe bëri kryq prapë. U kujtua se Mehmet Rama nuk do ta kishte shpëtuar kurrë nga skamja dhe gjaqet. Këtë e bëri vetëm partia. Por ajo kërkonte një gjë të madhe prej tij, kërkonte të falte të bijën! Në fund të fundit ai mund ta falte të bijën për ikjen nga shtëpia, por nuk mund ta falte për atë që donte të martohej me një të fesë tjetër në fshat. Këtë nuk mund ta honepste Gjoka. Po ç'duhej të bënte Gjokë Martini? Ta vriste apo jo vajzën? Mund t'i duronte vallë ai tërë ato turpe? Mund ta mbante vajzën në shtëpi ashtu siç thoshte shoku Zef! Kishte ardhur rasti për të vepruar para se njerëzit t'i vinin në shtëpi për ta pajtuar me vajzën. Tani duhej të vendoste në se do të bënte si thoshte Mehmet Rama apo si thoshte shoku Zef, si thoshte e tërë shoqëria me partinë.

Ai bëri kryq disa herë me rrëmbim e gulç, saqë, në vend që të takonte lehtë ballin me dorë për të shënuar skajin e sipërm të kryqit, i ra një gemi të thatë pjergulle, i cili ju ngul Gjokës mu në sy.

— Oooh! — bërtiti një herë, duke mbuluar syrin me shuplakën e tij si putër ariu dhe u nis pa ditur nga t'ja mbante. Doli nga pjergulla dhe, duke mbajtur në njërën dorë cfurkun e me tjetrën syrin e vrarë, u nis për nga shtëpia, kurse në qendër të fshatit gëzimi vazhdonte të rritej. Shoku Zef u thoshte shokëve që atë natë të organizonin një mbrëmje të madhe dëfrimi për ardhjen e aksionistëve. Kurse Nikë Shkreli ngulte këmbë që të shkonin në shtëpinë e tij, se kishte bërë edhe pregatitje, kishte therur qingjin për miqtë.

— Nji tjetër natë te ti, Nikë Shkreli — ja bënte Zefi. — Sonte do të bëjmë mbrëmje vallëzimi. Të shohim nji herë si ke mësue me vallëzue ti atje në hekurudhë.

— Sonte për besë të burrave do me e djegë plaka ume! A nuk e sheh se i ka ardhë djali prej aksionit, a? Ha-ha-ha!

* * *

Gjokë Martini u tërhoq zvarrë nëpër misërishte me njërën dorë te syri, derisa arriti në shtëpi.

— Ç'asht ai dyzeni i madh atje, o ti? — i tha Dila, kur e pa që po vinte.

— Të kjoftë dyzeni i zi, po a nuk e sheh si jam ba, a!

— Çka të ka gjetë kështu, bre ti?

— Jam qorrue, more, t'u qorroshin trutë, se sy nuk ke pasë kurrë! Unë jam në gazep e kjo shakë më sheh dyzen! Mos më daltë shpirti pa të përdredhë kryet si shakës, se ti m'i ke të tana faqet e zeza! Ti ç'i më bane vetëm vajza!

— Çka me ba unë e shkreta!

— Me të ra pika kresë! Futu mbrenë, nuk po ka kush çka me shti në dhe në ty, në bafsha me të kapë në dorë! — Ai u mat ta qëllonte me cfurk, po ajo ja kishte mësuar marifetin dhe ju shmang. Po t'i shmangeshe së goditurës së tij të parë, nuk të qëllonte më pastaj, se besonte që ashtu kish të urdhëruar Jezui.

Pa mbaruar mirë kjo grindje, në fund të arës u dukën

disa njerëz, që e tërhoqën vështrimin e Dilës dhe ajo harroi për një çast zemërimin e Gjokës.

— Shtatë... — tha ajo duke vënë dorën strehë mbi ballë. Desh të thoshte shtatë vajza, po i pa se ishin të gjitha me pantallona dhe tha: — Shtatë vetë po vinë prej funit të arës!

Gjoka shikoi me njërin sy dhe i pa tamam siç i kishte parë në qendër të fshatit. Bëri kryq edhe një herë dhe i tha Dilës.

— Po shkoj te Rushja e Memë Pshurranit për me m'ra synit me gjuhë, se thonë ç'i ajo asht shortare e mirë e i shnosh.

— Poo, ajo ta hjek dhimbjen si me ta hjekë zoti me dorë, — tha Dila pa e larguar shikimin nga vullnetarët, që po vinin drejt shtëpisë së tyre.

Gjoka u largua duke mbajtur syrin me dorë, kurse Dila nxitoi ta pyeste.

— Me ba me çue zot Hanën, çka me ba unë?

— Me vra vedin! — tha ai dhe u zhduk pa dhënë ndonjë urdhër të përcaktuar.

Të huajt po i afroreshin shtëpisë dhe Dila i shikonte tani më qartë. Ishin pesë vajza e dy djem. Po ato vajza me pantallona!? Ajo u kujtue shpejt se kishte parë edhe herë të tjera vajza me pantallona mësuese aksioniste, që kishin ardhur edhe në shtëpinë e saj. Po cilat ishin ato vajza dhe pse nuk dukej Hana?

— Nanë!

Si?! Zëri i Hanës?! Hana e veshur si djalë dhe pa shami në kokë?!

Ajo bëri një kryq shpejt e shpejt, tha me mend një herë «O shenjt, O Mri! dhe nuk pat kohë të thoshte gjë tjetër.

— Kush je ti, moj?

— A nuk po më njeh, moj nanë?

— Ç'ke ba ashtu, shpirt i nanës! Si kishe me të njof-të unë e shkreta! Qyqja unë si kenka ba!

— Është bërë djalë! — tha Teuta.

Nënë Dila së bashku me tmerrin që e kishte pushtuar

në atë çast, ndjeu edhe kënaqësin e takimit me të bijën, që e donte aq shumë, ndjeu mallin për vajzën, që nuk e kish-te parë prej aq kohësh. U përqaftua me vullnetarët, u përqaftua me të bijën, duke i rrjedhur lotë të ngrohtë dhe duke mos mundur të jepte të gjitha urimet, që kishte dëshirë t'i jepte në atë çast. Sapo ata u ulën në stolat, Dila, duke ju dridhur zemra se mos shfaqej në çdo minutë Gjoka, i tha Hanës:

— Hanë, të pastë nana, mos rri hiç, po shko e hiq ata pantallur e ven rubën, se po vjen e të gjen ai!

Hana qeshi me zë të lartë, që të davariste atë hije të rëndë që lëshuan fjalët e Dilës.

— Nuk do t'i ndërroj këto tesha, nanë! — tha Hana dhe nënë Dilën e goditën këto fjalë ashtu siç e godiste ndonjëherë Gjoka kur e qëllonte me stol ose me urë të zjarrit në kokë ose në shpinë.

— Mos e folë atë fjalë, se pasha zotin me të ndigjue yt atë, të ban për vorr!

— Kjo nuk ka shkue në aksion vetëm për të punuar dy muaj, moj nënë Dilë — tha Teuta. — Atë çka ka fitue atje, do ta mbajë e ta zhvillojë më tej këtu me shoqet e veta.

— Aman, mësuese! Ti i di zakonet tona. Nuk durohet vajza me kyt veshë!

— Kështu do të bëhen të gjitha vajzat e fshatit.

— Kur të bahen të tana, hajde de, po jo tash para gjithkujt. Këtë turp nuk e ha me bukë askush, përveç horave!

Hana e përqafoi nënën dhe i puthi ngrohtësisht faqet e vyshkura.

— Mos u habit, moj nanë, se na kanë ardhë mysafirë!

Si e pa që ajo punë nuk do të bëhej, dalëngadalë Dila u qetësua, i erdhi ca edhe çehrja dhe nisi të pyeste për shëndetin e vullnetarëve dhe t'u urronte mirëseardhjen. I tha Hanës t'u mbushte nga një gotë qumësht lope dhe vullnetarët e pinë me kënaqësi.

Pas pak ata u ngritën. I thanë Dilës që atë natë do të shkonin të gjithë te Nikë Shkreli, se i kishte ftuar për darkë. Ajo, duke menduar furtunën që do të ndodhte, po të

vinte Gjoka, u gëzua që vajzat po largoheshin. Të paktën atë natë të shpëtonin, mendoi ajo pa e ditur se Gjoka nuk kishte shkuar fare te Rushja e Memë Pshurranit, por ishte larguar, sa të mos gjendej në shtëpi, kur të vinte e bija.

— Kuku, moj Hanë, ç'ka tash po nodh! Yt atë nuk ka hall pa të vra! Ka ba bé njiqin herë. Kur bante bé përpara, gjithmonë e vritte hallkun.

— Edhe në më vraftë mue, të paktën nuk bie në gjak me kë.

— Bie në gjak me partinë — tha Teuta.

— Ju e bani si lojë atë punë, po unë e kam pa me sy dikur tue e vra nierin si bagëtinë.

Shqiponja u drodh. Ajo habitej si njerëzit flisnin aq lehtë për vrasjet, për gjakun e njerëzve si të ishte kjo një gjë e rëndomtë në jetën e tyre. Sa të vërteta po i dukeshin tani tregimet e xha Nikës për gjaqet!

Pas pak vullnetarët dhe disa shokë të tjerë të fshatit qenë grumbulluar në shtëpinë e Nikë Shkrelit dhe e shoqja po i uronte:

— Ardhëshi të bardha! Ma bekuet këte shtëpi, ju bekoftë zoti! Shumë ma kuveni plaku fjalën e mirë për ju. Ju u dhashtë perënia të marën!

— Lene perëninë, plakeee! — ja bëri xha Nika. — Nuk ka punë në kyt shpi perënia. Ajo të shkojë te Gjokë Martini, se ka merak në perëni e shejtën.

— Unë zotin nuk e hjek prej zemret, o plak, veçse hjek zi kot ti. Kam majtë kreshmë qysh dhetë vjeç.

— Po ne të tjerëve a do me na lanë noj qoshk në parriz, o plakë!

— As nuk kam me ju lanë me u afrue.

— Dreqi ta rritët nerën, plakee! Majeni parrizin ti me dom Lazrin!

— Nuk ke xhelozit t'i lësh bashkë? — i tha Teuta.

— Për uratën e bekuem s'kam si me pasë xhelozit.

— Si, si thatë?! — ndërhyri në bisedë një fshatar. — Dom Lazri në parajsë! Kur të shkojë dom Lazri në parajsë, shkon edhe gomarica eme me tanë çurrat ç'i ka pjellë deri tash! Ai e ka zemrën ma pleh se baglat e lopëve. Hë,

ç'asht ai qen, he mos ja pasha ma bojën, shumë më ka rrej-
të për të gjallë!

Studentët kishin frikë të qeshnin me zë të lartë se
mos fyenin fshatin, me të cilin sapo ishin prezantuar, ndaj
mbanin gazin me zor.

* * *

Kur arriti te shtëpia, Sokoli i gjeti babanë, nanën e
xhaxhanë duke ndenjor në shkallë dhe, sapo deshte t'u
thoshte «Mirë mbrëma!», i mbeti fjala në gojë, sepse Sha-
bani ja priti përpara si i çakërdisur:

— A e solle kryet, bir, a?

— Mirë se ju gjeta, babë!

— Mos të shoh se më shkel në shpi, se po baj kërëdinë!
— dhe e mësyu djalin me shkopin e drurit, që mbante za-
konisht.

— Aaa, babë, nuk të lejoj me më rrahë! — tha Soko-
li dhe me shkathtësi ja rrëmbeu shkopin, të cilin e vërviti
përtej gardhit.

Nëna bërtiti dhe xhaxhai u ngrit nga vendi me ngath-
tësi.

— Ma gjej shkopin, se pasha nerin e hazreti Muhame-
tit, po të vras! Më ke nxi fytyrën tash në pleqëni!

— E, o bir i nanës, si kujtove me na e ba atë turp! —
ja bënte e ëma. — Me na u martue si qytetarët me vullnet!
E me kë se? Me vajzën e një kaurri prej katunit! Ti ke
qenë djalë i mbarë fort, more bir! Mos kështu, pash
hatrin e zotit!

— Lëshomë, vëlla, se due me e mytë! — thoshte Sha-
bani.

Sokoli bëri të hynte brenda, po Shabani u ndez ako-
ma më keq.

— Mos më hin në shpi! Ti nuk je ma biri em! Jashtë,
dinsëz!

Sokoli vendosi të sprapsej. Shtrëngoi fort dorezën e
valixhes, që mbante në dorë dhe tha:

— Edhe në u bafshin toka e qielli bashkë, unë nuk heq dorë prej Hanës. Ajo asht grueja ime dhe nuk marr tjetër. Meqë qenkeni të tanë të një mendjeje, unë po iki. Mirë u pafshim! — dhe nisi rrugën në drejtim të kundërt.

* * *

Studentët admironin mëngjezin malor që ishte larë nga një shkëlqim i argjendtë.

— Sa shumë më pëlqejnë këto mëngjeze! — tha Shqiponja.

— Ti si duket ke ndonjë damar poetik — i tha Lula.

— Gjatë këtyre ditëve unë ngrihem herët, dal në shkallën e lartë të xha Nikës dhe shikoj vërshimin e mëngjezit — vazhdoi Shqiponja.

— Po t'u vesh rima këtyre fjalëve, tamam poezi janë — u tall Lula.

Ndërkohë erdhi Teuta e ngrysur në fytyrë dhe njoftoi se edhe tri vajza të tjera e kishin hequr uniformën e aksi-onit dhe ishin veshur me rrobat e tyre prej shajaku, me çorape të trasha e shami deri te hunda.

— Janë bërë si gogole — tha ajo.

— Ç'djall është kështu! — ja bëri Fredi, — Tërë nderi qenka në ato shami, mo! Tërë kjo rezistencë për shamitë e pantallonat! Pse nuk i detyrojmë këta fanatikë të heqin dorë nga kalbësirat?

— **Ama, edhe ti, Fredi! Puna është t'i bindim — tha Lulëzimi.**

— E ç'të bindim ore! Unë po të isha mësues këtu, do të rrihesha me ndonjërin patjetër. Me shami e me çorape u matka nderi! Unë e di ç'është prapanizmi, po këta duket sikur e bëjnë me qëllim. Nostalgji e madhe për zakonet, për kanunet, për fenë! Djalli ta marrë!

— Mbahu, shoku Fredi! — ja bëri Teuta. — Po të jesh ti këtu, dashka të çmendesh!

— Unë jam i mendimit që shamitë duhen hequr me zor. T'u japësh urdhër: O ndërro veshjen, o nuk prano-hesh në punë!

Në ara vilej duhan dhe kooperativistët këndonin. Në-

për pemë gumëzhinin këngët e gjinkallave dhe cicërimat e zogjve. Vullnetarët me xha Nikën, që po u printe për në ara, po bisedonin gjallërisht. Po humori u prish menjëherë, se, në mes njerëzve që po punonin vluan thashethe-met, që xha Nika nuk i duronte.

— S'po merret vesh kush asht femën e kush asht mashkull tash. A e patë vajzën e Gjokë Martinit? Nuk i rru-dhej ashkja e synit ma se shakës, po i bite rrugës e veshun me pantallona si mashkull. Tfy! — tha një grua e moshu-ar dhe xha Nika i ndenji gati:

— A ke ra keq për këso punësh, moj Terezë!

— Jo kështu, xha Nika! — ju lëshua Teuta.

— Nuk munem me u majtë ma prej inatit! Duro sot e duro nesër! Sikur nuk e di unë si e ka luejtë bishtin kjo lushë! Tfy, shaka!

— Kështu e duan këto — tha Fredi.

— Të mos e fyejmë brezin e vjetër — tha Lula.

— Ka me pa ajo në mbledhje të popullit!

Pastaj xha Nika u qetësua disi dhe ata kaluan nëpër parcela të tjera. Shkuan te skuadra ku punonte Diella, vullnetare dhe kjo që ishte veshur tamam si e ëma me të tëra rrobat e rënda prej shajaku ose me dok të zi si dordolec. Xha Nika u dha vetëm një «puna e mbarë» kooperativistëve dhe shkoi drejt te Diella. Vajza herë skuqej, herë zverdhej dhe më në fund ju mbushën sytë me lot. Ajo kish-te thënë se nuk do ta flakte uniformën e aksionit, edhe sikur ta bënëin copa-copa, po ja që shokët e gjetën të veshur si të ëmën. Xha Nika i foli diçka Diellës, po papritur ju lëshua e ëma e i tha Nikës që nuk kishte fjalë me vajzën, sepse ajo e kishte bërë atë punë me urdhër të prindëve.

— Vajza eme nuk ka me u veshë si shkollëtares, se asht vajzë oxhakut — tha nëna e Diellës.— Nuk kam vakt me më metë vajza pa martue manej!

— A nuk i mori kush vajzat e mia, more llapazane ti, a? Rrudhe gojën e mos ban dërr — dërr!

— Lëre tani, xha Nika!

— Pse, moj shoqe, kaq e shtrenjtë qenka kjo djall veshjeje xhanëm! — tha Fredi.

— E ke rahat to, more djalë, se je në qytet! Edhe ne na ka anda me u veshë ashtu, po kush na le se! Diella ka babë — tha nana.

— Pse nuk thue nj'ashtu, pra? Pse merr barashkën e burrit? — ju hakërrua xha Nika. — Unë e di se ti nuk ke faj, po mos i folë ato fjalë të këqia!

Nika pyeti ku punonte babai i Diellës dhe pastaj u nisën të shkonin te stallat, ku u thanë se punonte ai. Duke kaptuar nëpër ara, pas një gardhi ata dëgjuan një të qeshur grashë. Xha Nika u tha shokëve të mbanin vesh se ato ditë ai «blente» vazhdimisht. Po bisedonin ca plaka:

— Mos na e merr, zot, erzin!

— Hajde drejt! Gjokë Martini nuk po i ban asgja së bijës! A e patë kurvën?

— Po he mos e paftë Shenepremten!

— Hiç nuk i rrudhej eshkja e synit për turpin ç'i ka ba!

— Na e qiti kyt bidat të ri në katun të vjetër! Hajde çfarë dasmash!

— Nuk e dimë a dasma a drekë.

— Jo mana, Gjoka nuk po asht i zoti me e luejtë!

— Besa Hanës ja lumsha krahin! Pse mos me u martue katolik e myslimanë tash ç'i u prishën edhe kishat?

— Mos e folë atë fjalë, he burrëneshë, se je gjashtë-dhetë vjeç! A menon me dekë? Ajo shaka, duhet vra, se tash po mësojnë edhe vajzat tona prej saj! Kuku për ne!

— Pah si tash po na dalin vajzat tona rrugëve e gar-dheve!

— Mos na shit mend, he burrëneshë, se nj'ashtu kishe dashtë edhe ti, kur ke qenë e re!

— Tash nuk ka as burra as ner! Kur pashë Myftar Alinë me të shoqen, m'u duk se më zuni toka! Një herë e ndau e u bin dheu e tash e mori prapë! Kuku, o zot!

— Alia nuk i ka lanë mrenë aspak.

— Po ku rrinë?

— U ka gjetë një dhomë kryesia. Kuku!

Xha Nika nuk mundi të duronte më. U munduan ta

ndalnin, po nuk ja arritën. U ngrit dhe u lëshoi një breshëri të sharash.

— Kështu e duan! — tha Fredi.

— Nuk duhet kështu, xha Nika — thoshte Teura.

— Tash po shohin në mbledhje këto! Na i merr snënim emnat e tyne!



U suell nga u suell Gjokë Martini, po më në fund shkoi në mbledhje, se s'gjeti tjetër rrugëdalje. Ai kish-te provuar një torturë të tmerrshme gjatë këtyre dy muajve. Ai bëri kryq disa herë dhe i tha Dilës të shkonin në mbledhje.

— Hajde, se nuk më pranojnë pa ty në mbledhje. more, të raftë pika ballit!

— Nuk po të baj gja, more nier!

— Mylle gojën, se po të vras! Ke nije erën e mbledhjes e don Mancipim! Ty të kjoftë Mancipimi i zi! I mjeri unë si tash po më shajnë tanë ai hallk! Nuk munet nieri sot me ba ç'të dojë me euladin e tij e hajt tokës.

— Ti e hodhe vajzën jashtë — mori zemër të fliste për të parën herë në jetën e saj me një ton të tillë Dila.

— Unë nuk e kam pa me sy! — tha ai i hutuar dhe i çarmatosur nga forca, me të cilën ju përgjegj e shoqja pas tërë atyre viteve.

— Ti më kishe thanë mue mos ta gjej në shpi, se e vras!

— Kujtove se do t'i thom «të lumtë krahi!» Kujtove se kisha me i fërkue kryet! Se ka ba trimni të madhe, ç'i ka ikë prej shtëpie! Tfy, jazëk!

— Priti pra fjalët ç'i tash po të thonë! — tha Dila më trimërisht se kurrë. Kaq trimërisht i tha këto fjalë, sa Gjoka mbeti shtang dhe nuk dha përgjigje.

Nën hijen e arrës së madhe ishte mbledhur i gjithë populli. Gjokës ju duk sikur të ishte populli i një qyteti të madh dhe jo i fshatit të tij. Si nuk e kishte ditur ai se fshati i tij kishte kaq shumë njerëz? Gjoka u ul në një qo-

she pa përshëndetur njeri. Si u ul në vend, gjeti rastin të shikonte të bijën që po rrinte në presidium.

Nga veriu frynte një erë e fortë dhe retë e zeza ishin bërë tavan mbi majat e bjeshkëve. Mbledhja u hap dhe Gjoka po dëgjonte me kujdes ç'do të thuhej. Po fliste Zefi. Gjoka priste kur t'i delte emri. Ai vuri re edhe aksionistët jabanxhinj, që rrinin në anë të majtë të arrës dhe diç pëshpërisnin kokë më kokë, duke shikuar Gjokën.

—... Ne i patëm shkruar një letër shokut Enver, ku patëm marrë angazhim me i djegë me zjarr këto zakone e prapë sot ka burra, që nuk janë bindë e po na prishin osullet e vendosuna nga kuvendi i popullit, si për shembull Gjokë Martini, Mehmet Rama, Bajram Gjetja e të tjerë, të cilët do t'i kritikojë vetë populli...

Gjoka kishte menduar se kushedi si do të shante ai në atë fjalim, kishte menduar se si duhej të qëndronte, si të reagonte ndaj asaj kritike, po ja që shoku Zef nuk e preku fort.

Pas referatit Gjoka pa se u ngrit Nikë Shkreli i pakënaqur dhe tha:

— Unë nuk jam dakord me raportin e shokut Zef. Pse nuk asht kritikue edhe Kolë Prela, ç'i ka heqë vajzës fët e fët rrobat e aksionit dhe e ka rrahë si mushkën për prishjen e fejesës. Bile i ka thanë që nj'atë burrë do të marri prapë. Pse mos me u kritikue edhe Terezja, Bicja, Zadja e plaka të tjera që kanë folë kundër Hanës arave qysh se kena ardhë prej hekurudhe. Ose pse mos me u kritikue Shaban Smajli, që e ka qitë djalin jashtë.

«Ku je, paç faqen e zezë, he matuf! tha me vete Gjoka. Pasha zotin asht ba Nikë Shkreli si me kenë pesëmdhetë vjeç me mend të kresë! Ja, tash po flet edhe një matuf tjetër.»

— Jo vetëm me kritikë — tha Teuta. — Tani duhen masa. Kemi kaq kohë që merremi me këto gjëra. Si mund të falen ata intrigantë, që shkatërruan një herë një familje, pavarësisht se nuk ja arritën dot. Kjo duhet dënuar rëndë. Duhet dënuar të gjithë këta prapanikë, që pengojnë ecjen përpara të shoqërisë sonë.

«Kjo më ka inat, mendoi Gjoka. Kjo tash nuk po më le gja pa thanë në fytyrë. Jepi, mësuere, jepi! Ti më ke hangër edhe bukën, more mësuere! Bile ty ta pashë sherrin! Ti ma bane vajzën me ikë prej shpijet. E tash po më kritikon! Filloi për zotin! Filloi me më kritikue keq! Si the?! Gjoka prapanik?! Jepi, jepi! Po kritikon edhe Shabanin.»

U ngrit Shabani me kunërshtue!

— Mos ma thuej nj'atë, shoqja mësuere!

Atëhere ndërhyri Nikë Shkreli.

— Kjo të tha pak, o Shaban Smajli! A nuk je ti që ke nxjerrë djalin shpijet? E ke dëbue, se asht fejuere me vajzën e Gjokë Martinit? Ë? Na u shtrëngojmë dorën këtyne e ti me dalë si mahlukat e me i dëbue prej shpijet! Ose Gjokë Martinit që i ka çue fjalë vajzës mos me i dalë nër sy! Turp për ner! Tash unë meno që këta burra e këta gra me na dhanë fjalën këtu që qysh nesër Gjoka me ba shyqyrin e fejesës së vajzës me Sokol Shabanin e Shabani t'i shkojë në shyqyr me të tanë robt e mos me i thanë asnji fjalë ma djalit! Përndryshe sikter prej katunit! — xha Nika fshiu djersët. — Kjo asht puna e parë që duhet me ba Gjoka e Shabani! Duhet me pasë pak respekt edhe për shokët e partisë që po merren me kyt punë tash sa kohë, se hajde këta studentë që po rrinë këtu tash një javë prej marakut të shoqeve të tyne. Kjo një. E dyta: me u çue këto plakat e ata llapazanët tjerë e me marrë angazhim që nuk do të lehin ma kundër Hanës e Sokolit, as kundër Myftar Alisë me të shoqen...

Tani Gjoka u ngrit një njërin gju dhe po dëgjonte thuaj se pa marrë frymë.

«Ja po flet tash edhe ajo vajza jabanxhi, që po i fthashkan Zanë! mendoi ai. Kjo po folka bukur. Po sado bukur me folë; kundër mejet ka me folë.»

— ...Xha Nika u foli pak rëndë këtyre. Gjokën e Shabanin nuk mund t'i quajnë armiq. Ata janë viktima të prapanizmit dhe të mbeturinave të fesë. E kanë vështirë të shkëputen nga bota e tyre. Ne u bëjmë thirrje të gjykojnë vetë ata a është e drejtë të rrimë të përçarë katolikë e muslimanë, në kohën kur njerëzit arritën në hënë? A

s'është turp? A i sjell dobi nderit tonë përçarja fetare?

«Kot e kam, mendonte Gjoka. A delet mbi të gjithë këta, xhanëm?! Pah! Bukur besa. Edhe kjo po e kritikon Mehmetin! Kaq shumë kenka ba pus Mehmeti Ja paskan vu menen edhe Mehmetit. Shumë e ka lëshue gojën ai dreq. Me çdo kusht don me më ba me vra vajzën. Ka hall me djegë edhe vajzat e veta. Thonë se vajzat e tij po bahen të pahajre. Ky dreq na bani me dalë edhe dëshmitarë në gjyq rrejshëm. Unë nuk kam pa asgja me këta sy të ballit... Ky Nikë Shkreli paska luejtë mesh krejt. Prapë po flet!»

— Në daçin Gjoka e Shabani të m'i lanë mue djalin e vajzën t'i kem djalin e renë teme — tha xha Nika.

«Hë, matuf! Pse i thom matuf, xhanëm? Ma matuf tash po dal unë, ç'i po më diskutohet puna e vajzës teme para tanë këtij njeriut. Paaah, ç'po flasin, he për hatër të zotit!

— Çohu, Mehmet Rama, e na thuej ç'ke ba me Gjokën e me Shabanin, se ti je nana e të zezave! Ti ban punën e hoxhës dhe të priftit.

— A ka nonji Mehmet Rama tjetër këtu a me ke po flitni? — tha Mehmeti.

— Jo, ishalla, nuk kemi tjetër si ty, por ngreu e na folë para popullit.

— Si, si? Më mue e kini?

— Po, po, me ty! — u hodh xha Nika.

— Ma gojën, Nikë Shkreli!

— Tashti nuk ke fuqi me ma myllë gojën! Po të ishte koha e Zogut, po.

«Paaah, ç'ja kanë vu Mehmet Ramës! Mos rrej edhe ti, he dreq! Folë, në paç njonji hile, se nuk po hanë! Kaq jam unë, ç'i më ka ikë vajza prej shpijet. Ty nuk të ka ikë kush hala. Unë po rri me turp gjithmonë. Punën teme nuk e lan as ujët e detit... Si?! Grueja eme u çue me folë?! Pa-pa-pa!»

— Ti, Mehmet Rama, po rren si qen, se të tana të zezat tuat janë. Hë, gjarpën ti, sa herë i ke gërگا burrin tem e Shabanin! Ti kujton se kena harrue? Si kam me

harrue unë, që për fjalët tua kam nejtë sa net pa gjumë e kam qe si fëmijë kushedi sa herë? Ja lumsha kësaj parti, ç'i po t'i nxjerr horrlëqet në shesh! Ti ja ke marrë mendtë burrit tem! Ti e ke ba me i dalë dëshmitar Myftar Alisë! Ti!.. Hë, çka je ti!

Gjokë Martini tash nuk dinte si të mendonte. Ky do të ishte një turp shumë i madh për të, por, meqë tash-ti po e gjenin shumë turpe, nuk dinte ç'të bënte. E folura e Dilës nuk mund të ishte më turp se ikja e vajzës nga shtëpia dhe martesë me katolikun.

— Qepe, Mehmet!

— Nuk ka të drejtë me folë pa leje Mehmet Rama!

— Të ulet në vend!

— E njohim kush asht e sa i ban lëkura.

«O zot, çka po bahet kështu? Ti o shenjti shën Koll! Po unë si kam me folë, kur të më thonë? Unë, ç'i më foli grueja para tanë këtij nierit! Si e ka marrë guximin, xhanëm? Ajo nuk ka guxue me ba sus kurrë... Po flet edhe Shabani! Po ti, more i zi, çka do me thanë?

— Me të vërtet jena njerëz pa shkollë e padije e nuk i kuptojmë aq thellë punët. Manej, more shoqni, unë djalit tem i kam thanë me dalë jashtë noshta në një frymë të keqe, por nuk e kam dëbue, brë burrat e dheut.

— Edhe unë po flas një herë. Nuk po munem me durue...

Gjoka bëri kryq me mend. Po fliste edhe gruaja e Shaban Smajlit. Ç'po ndodhte ashtu? Tana gratë do të flisnin? Ja, ajo po kritikonte burrin pa pikë drojtje...

— E ke dëbue djalin ti, s'ke çka thue. Me pasë qenë sikur po thue pate me shkue e me marrë, po të erdhi namuz. Deshta me ua thanë edhe shokëve të partisë ç'i ti nuk je në rregull. Mirë e tha ajo vajza se na fenë e kena ma tepër zakon se për shpirt...

— Hej dreq! — ja bëri Shabani. — Nuk të lanë gratë me folë! Nejtë... E, moj shoqni, ju me më falë për këto gabime, se nuk jam anmik, siç më tha Nikë Shkreli. Unë jam me partinë. Mehmet Ramës unë nuk ja njëkë fjalën edhe në qoftë se ka folë, si po thoni ju. Kurse djalin po e

pranoj me gjithë nusen e tij, të bijën e Gjokë Martinit.

Gjoka hapi sytë fort. Ç'po thoshte Shabani? U mundua aty për aty të riprodhonte ato fjalë, që tha Shabani, se mos kishin tjetër kuptim. Por jo, Shabani e tha qartë: e pranonte Hanën në shtëpi! Po atëhere pse bëhej merak Gjokë Martini? Përderisa kjo pranohej gati nga të gjithë, domethënë nuk ishte turp. Ç'turp donte të lante pra Gjokë Martini? Përse kishte dashtë ta vriste të bijën? Për nder, për të vënë në vend namin e oxhakut të tij. Mirëpo a nuk po e konsideronin të tërë turp atë që quante ai nder? Tani ai po bindej se, po ta vriste vajzën, shumë pak njerëz do të thoshin se Gjoka kishte bërë mirë. Gati të gjithë do të thoshin se Gjoka ishte budalla. Po atëhere pse luftonte Gjokë Martini, xhanëm? Që të ruante «nderin» e vajzave të Mehmet Ramës? Kishte ca kohë që ai e kishte kuptuar se Mehmet Rama donte ta shtynte Gjokën në krim me qëllim që ta përdorte aktin e Gjokës për të trembur të bijat. Gjoka po thithte fort cigaret. Shuante njërën dhe ndizte tjetrën shpejt e shpejt. Ai tani nuk dinte ç'qëndrim duhej të mbante. Kurse radha për të folur po i trokiste pas dere. «Mehmet Rama qenka burrë i poshtëm, mendoi ai. Pse rrejtji? Unë e di ç'i rrejtji. Burrat nuk rrejnë».

Gjoka zuri të dridhej. I ra një herë cigarja nga dora dhe e mori shpejt. Retë e zeza qëndronin si tavan mbi kokë dhe në çdo çast priteshin vetëtima e bubullima, që do të dridhnin tokën.

Ai u ngrit në gjurin tjetër dhe ndezi prapë një cigare. Nga bjeshkët shpërtheu një bubullimë e shurdhër.

— Ç'ka po na thue ti, Gjokë Martini? — dëgjoi ai papritmas.

— Paj foli grueja për mue...

— Je dakord me gruen?

— Nikë Shkreli më ka ranue shumë... Unë nuk i kam ba kujt gja. Më ka ardhë keq, që më ka ikë vajza prej shpijet, sigurisht... Më ka nejë hatri, po vajza eme asht ajo, e nieri me vajzën herë shahet e herë goditet... Nika më ka sulmue jo vetëm sot...

— Na e mbush mendjen se ti ke të drejtë dhe jo Nika — i tha Zefi.

— Gjithkujt kishte me i ardhë keq me i ikë vajza pa leje.

— Thuej, more Gjokë, a kam unë dorë në punët tua?
— tha Mehmeti. — Folë vetë ti, Gjokë, se a e sheh çka po më bajnë gjindja?

(«Mos më ban me folë, Mehmet Rama! Unë nuk di me rrejhtë, për besë të zotit! Mos më ban me folë, more pleh, se ti paske kenë i poshtëm.»)

— Folë, Gjokë, e mos i le me më metë në qafë!

— Mos më ban me folë, Mehmet Rama, se do gjana nuk i thotë burri! Nuk na ka hije ne me u hangër nër vedi tash në pleqëni. Rri ma mirë! Nuk jena gra të këqia me u hangër ashtu. Kena kenë shokë e dashmirë. Më len rahat ma mirë!

— Jo, Gjokë! Folë! — i tha Zefi.

— Pse asht ky rrenaxhi e burrë i poshtëm, unë nuk bahem. — Gjoka po dridhej nga inati dhe u ul në vend. Të tjerët nuk i folën.

— Kushedi sa herë ka ardhë në shpi ky katil dhe i ka thanë këtij me vra vajzën, he e vraftë zoti qenin! Ky e rrejti me i dalë edhe dëshimtar në rrenë Myftar Alisë pa i pa, pa i ditë asgja të keqe bijës së dheut... — tha me lot nëpër faqe nënë Dila.

«Interesant! — po thoshte me vete Fredi. — Kjo është për të venë kujën».

U ngrit Sanija dhe foli e emocionuar.

— Unë due që Mehmet Rama të japë llogari para këtij populli... Mehmeti dhe të tjerët që më prishën familjen e nuk lanë gja pa vjellë kundër meje. Edhe tash që jena bashkue me burrin, vjehrrin e vjehrra nuk bashkëjetojnë me ne për këtë arsye. Ata janë të bindun që nuk jam e panershme. Të thonë njerëzit ç'të dinë për mue dhe ta marrin vesh pleqtë e mi — tha ajo dhe nuk mundi t'i mbante lotët.

— Mos u mërzit, Sanije, se do t'i marrim një nga një problemet — tha Zefi, që i kishte hipur zemërimi.

Myftari u ngrit i skuqur në fytyrë.

— ...Unë, për të nda gruen, jam pështetë vetëm në fjalët e Mehmet Ramës, Gjokë Martinit, Bajram Gjetos, Terezës, Zades dhe nanës e babës... Unë nuk kam pasë asnji fakt. Kam qenë tue jetue në kulmin e lumtunisë me të, por, kur më thojshin këta njerëz vazhdimisht që grueja po bante dashni me njanin e me tjetrin, unë u hutova. Kur e shihshe manej tue folë e tue qeshë me djem të rinj, menojshe se ajo ka vetëm qëllime dashunie... Më dukej se kish diçka në ato të qeshuna... Dhe një ditë vendosa t'i qëroja hesapet me të... Të mos vlejsha ma prej xhelozie... Unë nuk kisha si mos me i marrë parasysh fjalët e burrit me mustaqe, kur më thosh: «Ta kam gjetë gruen me filanin tue ba zina»... Ja, këto gjana më shtynë... Unë jam fajtor...

Gjoka tani i kishte hapur sytë më shumë se kurrë. Sa shumë po e ndjente brejtjen e ndërgegjes në këto çaste! Ai kishte dalë dëshmitar i gënjeshtër, i trembur se mos Sanija po i mësonte keq vajzën, i shtyrë kryesisht nga Mehmet Rama, nga ai që tani po përpiquej të mohonte çdo gjë dhe t'ua hidhte fajin të tjerëve.

«Me një fjalë Sanija kenka ashtu siç e kam ditë unë, ç'i nuk i kam pa asnji sen në faqe të dheut. Të tanë po flasin dhe po pranojnë gabimet. Edhe Terezja. Tash duhet me u çue unë. Unë nuk di me rrejtë. Po, po, duhet me folë, u pa kjo punë. Mue nuk më met asgja tash. Unë nuk jam ma Gjokë Martini».

— Edhe unë jam kenë dëshmitar në rrenë për fjalët e Mehmet Ramës! — tha Gjoka.

— Ç'po thue kështu, Gjokë? — u hodh Mehmeti. — Ti më ke thanë vetë. Ti më ke thanë se e kishe pa keq Sanijen. Unë prej teje e kam nije.

— Mehmet Rama, burri lidhet për fjalet e kau për brinash. Unë nuk rrej edhe me më vu para mitralozit. Çka asht, asht. Ti më ke thanë me i dalë Myftar Alisë dëshmitar për me da gruen dhe unë i kam dalë. I kam dalë se atë grue e kisha frikë për vajzën. Kisha frikë se po ma çonte në mramje vallëzimi a ja rrente menen për nonji gja tjetër. Unë nuk dijsa asgja. Asgja nuk kisha pa te Sanija, por kah më dukej e lëshueme, menojshe se do të ishte e pa-

nershme. Kur e dau i shoqi, menova se nuk e kishte da kot, pranej i thashë vetes: «Ta nimoj me e heqë kyt ferrë». Për këte kam dalë dëshmitar. Pasha të madhin zot, nuk kini rrenë prej mejet!

— Ti po rren! — tha Mehmeti. — Doni me m'i lanë të tana fajet mue!

— Mos më thuej nj'ashtu, Mehmet Rama, se kem me dalë prapë prej kësaj mbledhje!

— Pusho, Mehmet Rama!

— Po për të vra vajzën a të ka nxitur vërtet?

— Aman mos më ban me folë ma gjatë, shoku sekretar!

— Ju dashkeni me më sulmue të gjithë. Na nuk jena mbledhë këtu për punën teme. Ju doni me më qitë anmik ... Unë i paskam pasë fajet për të gjitha gjanat! — tha Mehmeti.

«Tash nuk po munem me durue ma prej këtij plehit», mendoj Gjoka dhe shpërtheu:

— Ti kenke burrë i lig, Mehmet Rama! Tfy, paç faqen e zezë! Kështu ban burri? U treme? Tfy! Unë nuk tremem! Unë flas të vërtetën! Ajo ç'i asht, nuk munet me u mohue. Çi kam dashtë me vra vajzën, kjo asht e vërtetë... Po, po, mos u çudit! Unë kam shkue në hekurudhë fill për me vra vajzën. Ja, kështu. Edhe tash vonë kam bisedue me Mehmet Ramën e më ka thanë: «Vetëm plumi e lan njollën që të asht vu në ball!»! Dhe unë, me kuvenë hakun, kam dashtë me e vra vajzën... Me rrejtë nuk di. Keq a mirë, unë kam dashtë me e ba atë punë. Nuk rren burri si ti, Mehmet Rama! Ti kenke i lig e hajt tokës! Pse jena para këtij populli me rrejtë tash, a? Me thanë unë, se nuk kam dashtë me e vra vajzën? Burrëni asht kjo? Unë nuk jam në një mende me vajzën, se kështu e kena pasë nerën deri tash, po tash nuk asht turp. Kanë nryshue punët tash. Megjithatë unë nuk e pranoj ç'i vajza eme ka ba mirë. A doni me ju rrejtë apo me ju thanë të vërtetën?

— Të vërtetën, të vërtetën — thanë fshatarët.

— Unë kam dashtë me vra vajzën, por tash po ja u nap fjalën se nuk do t'i thom as syzezë as sybardhë për

kyt punë. Tash, burra, nuk kam me folë ma e për Mehmet Ramën sot po e di tamam se kenka kësi nierit. A rren burri me ata alamet mustakësh, pse asht para frike?.. Unë e di se për mue asht bá fanë kjo mbledhje, por me ma falë, burra, se na jena edhe gjin e padijshme.

— Nuk e kena ba mbledhjen vetëm për ty, Gjokë. Na kishim nevojë për të diskutue me popullin, me pa ku jemi me vendimet e kuvendit të popullit... Duhej që Mehmet Ramës t'i jepej ai dush që ju dha nga populli — tha Zefi. — Kur ky nuk na dogoniste ne, nuk e dogonisëm as ne. Ne ja patëm heqë titullin e kulakut dhe e pranuem në kooperativën bujqësore. Tash që ky desh të zgjaste duert kundër revolucionit tonë, nuk e duroi ma populli. Ti e pe, Mehmet Rama, se populli të demaskoi ma mirë...

Gjoka ishte ulur në vend dhe ndizte e shuante cigare. Ai qe çliruar nga ankthi në një farë mënyre, por prapë tavani i zi i reve dhe bubullimat nuk po e lenin të merrte frymë lehtë.

— Unë e due partinë... — Po thoshte Mehmet Rama. — Ju po doni me më ranue kot... Unë nuk kam ba asgjë... Unë... Me më falë edhe për nonji gabim...

Por malësorët propozuan të arrestohej, dhe Gjokë Martini u bashkue me ta, pa i ardhur keq.
